



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3315 · e martë 13 mars, 2018

8°C | 18°C

15 DEN



KOHA për
kulturë

Fq.12-15

FORUM

Cigarja epike!



Unë fillova të pi cigaren diku në vitin '98-'99 dhe ia bënj vetëm paf puf (thoshte gyshja ime lua-neshë), se aspak nuk ia dinja lezetin! Do kisha harru se e kam pirë biles pafpufshëm sikur mos ndodhte Darka e Madhe (...e quaj unë). Hmmm, kam memorje selektive për më keq, prandaj dhe nuk i rrendis dot kronologjikisht datat e ndodhive kyçe të saj, as mund' nuk i jap t'a kujdesi historinë e datave në... **Fq.10**

AKTUALE

Vetëm një ofertë për "Mercedesin"

Fq.6

RAJON

Shqipëria, Evropa dhe droga

Fq.16

GLOBI

Si mund t'i hakmerret Britania Ruisë?

Fq.17



LSDM DHE VMRO ME QËNDRIME TË KUNDËRTA PËR LIGJIN

JAVA VENDIMTARE PËR SHQIPEN



"Ligji përfundimisht duhet të miratohet konform Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë do të mbyllet aspekti i fundit legal nga Marrëveshja e Ohrit. Ta lëmë le të realizohet, le të ketë implementim të vetin dhe do të shohim se nuk është diçka që është e dhimbshme, e vështirë apo tragjike, por është diçka që do të mundësojë më lehtë të kuptohemi me njëri-tjetrin", tha Zaev **Fq.3**

Notimi i nxënësve pa standarde

Shkup, 12 mars - Largimi i eksternes nga shkollat fillore dhe të mesme vërtetë që ka shpëtuar shkollat nga tollovia e padobishme që shkaktonin testimet e qindra mijëra nxënësve në periudhën e përfundimit të vitit shkollor (për nxënësit nga klasa e katërt e arsimit fillor deri vitin e parafundit të arsimit të mesëm) dhe në përfundim të gjysmë vjetorit të parë (për nxënësit maturantë), mirëpo nuk do të thotë se

shkollat nuk kanë nevojë për kontroll në mënyrën e vlerësimit (notimit) të nxënësve. Sipas shumë ekspertëve të fushës, shkollat duhet të punojnë në gjetjen e mekanizmave dhe standardeve të tjera të vlerësimit të nxënësve, sidomos për lëndët e matematikës dhe shkencave natyrore. Mekanizmat e rinj mund të mos jenë me kontroll të jashtëm, si në rastin e vlerësimit ekstern të nxënësve, i cili... **Fq.7**



EDITORIAL

HOLOKAUSTI
DHE KANUNI I
SHQIPTARËVE

Emin AZEMI

Holokausti mbetet një ndër aktet më tragjike të historisë njerëzore, që fsheh në vetvete miliona histori personale të secilit prej viktimave. Brenda kësaj tragjedie fshihen edhe histori të mrekullueshme guximi, dhe sakrifice. Është një akt që i kapërcen kufijtë e dallimeve fetare, etnike apo kulturore dhe përfaqëson tiparet më të mira të shpirtit njerëzor.

Në faqen zyrtare të ambasadës amerikane në Tiranë shkruhet: "Në vitin 1934, Herman Bernstein, ambasadori Amerikan në Shqipëri shkruante: "Nuk ka asnjë gjurmë diskriminimi të hebrenjve në Shqipëri, sepse Shqipëria është një nga vendet e rralla në Europë sot ku paragjykimi fetar dhe urrejtja nuk ekzistojnë, edhe pse vetë shqiptarët janë të ndarë në tre besime fetare."

Në nderim të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, ishte i përfshirë edhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni, në krye me drejtorin Skënder Asani. Ai u ka thënë gazetarëve se mungesa e shqiptarëve të Maqedonisë në institucione, ka bërë që, siç e quan ai, dora e vetme e shpëtimit për familjet hebraike, ajo e esnafëve shqiptarë kur bëhet fjalë për këtë pjesë të historisë, për disa dekada të mbetet në harresë.

Dëshmitarët e gjallë sot rrëfejné se si pjesëtarë të komunitetit hebre për një kohë ishin të strehuar në familjet shqiptare në Shkup dhe më pas, në emër të besës së dhënë, janë dërguar në Shqipëri.

Ndërkaq drejtori i Qendrës Memoriale të Holokaustit në Shkup, Goran Sadikario, konsideron se fati tragjik i hebrenjve, mund të shërbejë si leksion për të tashmen dhe të ardhmen, që t'i thuhet ndal së keqes. Asgjësimi fizik i 98 për qind të hebrenjve në Maqedoni, filloi më 11 mars të vitit 1943, datë fatale kjo për të gjithë hebrenjtë në Maqedoni. Në këtë datë, nga Shkupi u nisën 7,144 hebrenj në Treblinkë.

Dëshmitë e fundit, përmes dokumenteve të ekspozuara në Qendrën Memoriale të Holokaustit në Shkup, nxjerrin në pah se ajo pjesë e popullatës prej 2 për qind, është shpëtuar falë guximit kryesisht të familjeve shqiptare, të cilat i kanë strehuar dhe njëkohësisht kanë ndihmuar në transferimin e tyre në Shqipëri.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit një i ardhur që troket në derë trajtohej si mysafir, e jo si i huaj. Edhe hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin trajtuar si mysafirë nga shqiptarët dhe si të tillë ata u përcollën deri në vendet e sigurta. Rrëfimet e mëvonshme të të mbijetuarve nxjerrin në pah këtë zemërgjerësi të shqiptarëve.

Por, në krejt këtë heroizëm njerëzor, një shije të hidhur lë indifferenca e shtetit ndaj kontributit të shqiptarëve në shpëtimin e jetëve njerëzore. Fundja, shqiptarët nuk janë mësuar të marrin meritë për aktet e humanizmit, sepse një vepër që ka pas kosto të lartë, nuk është bërë për ndonjë meritë të mëvonshme. Të edukuar në shkollën e vjetër të mikëpritjes e humanizmit, shqiptarët e kishin të kristalizuar edhe në kodin e tyre zakonor qëndrimin tyre ndaj mysafirrit, për të cilin ishin në gjendje të jepnin edhe jetën nëse paraqitej nevoja.

Me qëndrimin e tyre ndaj Holokaustit i bën shqiptarët racën më imune ndaj çdo lloj paragjykimi që vjen nga Perëndimi e Lindja, por një kapital i madhe moral që është sprovuar me akte të larta humanizmi po mbetet disi vetëm në suaza të përkujtimeve. Aktet e tilla meritojnë më shumë se kaq.

POLICINË E KEMI SHNDËRRUAR NË NJË
ESKORTË PARTIE

"Një raport ndërkombëtar mbi policinë e shtetit ka një shifër shokuese: në Shqipëri mesatarisht një oficer policie qëndron në funksion vetëm 8 muaj. Çdo 8 muaj ai kalon për ndjekje ose shkarkohet. Në Britani mesatarja është 11 vjet, në Gjermani 10 vjet, në Itali 9 vjet. Kaq mjafton për të kuptuar se çfarë i kemi bërë policisë së shtetit në tranzicion: e kemi shndërruar në një eskortë partie, pa status, pa garanci, pa kriter, pa ligj dhe pa dinjitet", shkruan në profilin e tij në FB, studiuesi nga Tirana, Afrim Krasniqi.

UNË DHE DREJTORI ME KOMPJUTERIN PLOT
VIRUSE

"Suedisë zyrtarisht iu shtua edhe një shtetas ndërsa mua edhe një pasaportë. Kjo ndodhi pas 11 vite e 2 muaj vendqëndrim. Në janar të vitit 2007 erdha këtu për të vazhduar studimet e Masterit. Magjistrova në tetor 2008. Më pas punova në një kompani si programer deri në shkurt 2010 kur fillova studimet e doktoraturës në Universitetin e Örebros. Doktorova më shkurt 2014 dhe prej atëherë punoj si asistent profesor. Përgjegjësitë janë të ndryshme duke filluar prej ligjërimit në nivelet Bachelor, Master dhe doktoraturë e deri në publikimin e punimeve shkencore dhe menaxhimin e projekteve shkencore. Ky lajm ka edhe anën tragjike! Para se të vij në Suedi dhe pasi diplomova në UEJL në Tetovë, u mundova të gjejë punë në vendlindje. Gjithçka provova duke filluar intervista nëpër ministri e deri duke i lutur njerëzit e thjeshtë për të intervenuar nëpër shkolla fillore e të mesme në Kumanovë. Bile në një rast, një drejtor i shkollës fillore u tall me mua pasi shkova në zyrën e tij duke më ofruar që t'ja rregulloj kompjuterin, të cilin në fakt e kishte të mbushur me viruse. Për fat të keq, situata tash është më e vështirë se në vitin 2006. Niveli i partizimit të institucioneve është më i lart se atëherë. Posaçërisht, kur na udhëheqin të "mençurit", "integristat"... Dashtë Zotit të vetëdijeshohemi e në të ardhmen të zgjedhim njerëz më të afte se sa këta që i kemi tash. Tash kemi alternativa tjera. Tek e fundit, nuk mundemi të zgjidhim më keq se kaq, apo jo?", shkruan në profilin e tij në Facebook, dr.Mevludin Memedi nga fshati Sllupçan, por që jeton dhe punon si profesor në Universitetin e Örebros në Suedi.



PARALELIZËM I DETYRUAR

"A mund ta imagjinoni se çfarë do të kishin bërë qeveria greke dhe diplomacia greke në Tiranë, në Bruksel dhe në OKB, po t'i kishte ndodhur një minoritari grek në Shqipëri ajo që i ndodhi Branislav Sinadinovskit, akademikut shqiptar ortodoks në Maqedoni, i cili në 5 mars u dhunua brutalisht në Shkup, sepse kërkon njohjen e Bashkësisë së Shqiptarëve Ortodoksë dhe të Kishës Ortodokse Shqiptare në Maqedoni?", shkruan në profilin e tij në FB, diplomati Shaban Murati.



MEDIACitate

MODELI I DY
GJERMANIVE,
ZGJIDHJA MË
EMUNDSHME
PËR KOSOVËN

Serbia dhe Kosova me siguri se marrëdhëniet do t'i rregullojnë sipas modelit të dy Gjermanive, ka deklaruar drejtori i Forumit për marrëdhënie etnike Dushan Janjiq. Ai ka thënë se Serbia duhet ta nënshkruajë marrëveshjen juridikisht detyruese në procesin e integritimit të BE-së, por nuk detyrohet që ta njohë Kosovën. Janjiq, siç përcjell N1, ka thënë se dialogu i brendshëm serb me ringjalljen e tregimit për kufizim e ndarje ia ka vështirësuar punën kryetarit të Serbisë Aleksandar Vuçiqit në gjetjen e zgjidhjes për normalizimin e marrëdhënieve.

Ai ka shtuar se Vuçiq me siguri gjatë prillit do ta paraqesë platformën për Kosovën, ndërsa, sipas tij, dialogu i brendshëm që e inicioi nuk i ndihmoi shumë. "Ai s'e krijoi përkrahjen e opinionit publik dhe kështu ia vështirësoi vetes punën. Ia vështirësoi vetes punën duke ringjallur fjalët e Qosiqit e të tjerëve për kufizim, për ndarje territori. Pra, përnjëherë anëtarët e qeverisë dhe partnerët e koalicionit, Aleksandar Vulin dhe Ivica Dačić, u paraqitën pengesa serioze, sepse krijuan opinionin publik që thotë se kjo është e mundshme", ka thënë Janjiq. Ai ka vlerësuar se zgjedhjet në Beograd i kanë mundësuar Vuçiqit që pa dilema të vazhdojë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Ai ka theksuar se rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Beogradit e Prishtinës është i mundur sipas modelit të dy Gjermanive. Duke treguar se aktualisht, derisa po vazhdon dialogu i brendshëm, spekulohet të jenë grupe propozimesh, ai ka thënë se nëse synohet BE-ja, atëherë është vetëm një opsion.

(TVN1, 12 mars)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË DIHET PËR DETIN ADRIATIK?

Deti Adriatik është pjesë e detit Mesdhe, në jug të Europës, midis Gadishullit Ballkanik në lindje e Gadishullit të Apenineve në perëndim. Në jug nëpërmjet kanalit të Otrantos lidhet me detin Jon e detin Mesdhe.

Sipërfaqja e detit Adriatik është 130.000 km², gjatësia maksimale 850 km dhe gjerësia 203 km. Thellësia më e madhe është 1590 m, në vijën Shëngjin (Shqipëri)-Monopol (Itali). Bregdeti shqiptar i Adriatikut në përgjithësi është i ulët dhe i sheshtë.

Gjiret më kryesore në brigjet shqiptare të detit Adriatik janë gjiri i Vlorës, i Durrësit, i Rodonit



dhe i Drinit, ndërsa kepet më kryesore janë kepi i Treporteve, i Semanit, i Selitës, i Rodonit etj.

LSDM DHE VMRO QËNDRIME TË KUNDËRTA PËR SHQIPEN

JAVA VENDIMTARE PËR SHQIPEN

"Ligji përfundimisht duhet të miratohet konform Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë do të mbyllet aspekti i fundit legal nga Marrëveshja e Ohrit. Ta lëmë le të realizohet, le të ketë implementim të vetin dhe do të shohim se nuk është diçka që është e dhimbshme, e vështirë apo tragjike, por është diçka që do të mundësojë më lehtë të kuptohemi me njëri-tjetrin", tha Zaev

Koha

Fatos RUSHTIT

Shkup, 12 mars - Kryeministri Zoran Zaev premtoi votimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve deri në fund të kësaj jave. Gjatë një konference e përbashkët për shtyp në Qeveri me kryesuesin e Këshillit të Ministrave të BeH-së, Denis Zvizdiq, Zaev tha se më Ligjin për gjuhët do të mbyllet aspekti i fundit legal i zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit. "Të gjithë thanë gjithçka që patën, ndërsa pati edhe kohë të mjaftueshme për dialog. Ligji përfundimisht duhet të miratohet konform Kushtetutës dhe ligjeve. Me këtë do të mbyllet aspekti i fundit legal nga Marrëveshja e Ohrit. Ta lëmë le të realizohet, le të ketë implementim të vetin dhe do të shohim se nuk është diçka që është e dhimbshme, e vështirë apo tragjike, por është diçka që do të mundësojë më lehtë të kuptohemi me njëri-tjetrin", tha Zaev.

PATRIOTIZËM I RREMË I GRUEVSKIT DHE MICKOVSKIT

Ndërkaq për porosinë e liderit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski, se partia e këtij të fundit do të japë mbështetje për planet reformuese të LSDM-së nëse Ligji për gjuhët tërhiqet nga procedura parlamentare, Zaev vlerësoi se bëhet fjalë për "kopi pejst" nga deklaratat e ish-liderit të partisë Nikolla Gruevski. Reagime ndaj kryetarit të VMRO-së, Hristian Mickovski, kishte dhe nga partia e Zoran Zaevit, LSDM. "VMRO-DPMNE vazhdon me patriotizmin e rremë të Gruevskit. Në vend të veprimeve të dëmshme, Mickovski duhet të largohet nga politikat e ndarjeve dhe urrejtjes. VMRO-DPMNE vazhdon me patriotizmin e rremë. Duke bllokuar Ligjin që ata e pranuan me shpresën se do

të formojnë Qeverinë, në fakt bllokojnë reformat me çka pengohet zhvillimi i Maqedonisë. Me këto veprime, ata po u shkaktajnë dëm qytetarëve dhe shtetit. Hristian Mickovski vazhdon të udhëheq me politikën e njëjtë sikur ka udhëhequr paraardhësi i tij, Nikolla Gruevski, politika të cilat sjellin dëme ndaj interesave të qytetarëve dhe shtetit. Mickovski duhet të gjejë forcën, të reformojë me të vërtetë VMRO-në dhe t'i tejkalojë politikat e ndarjes dhe urrejtjes së paraardhësit të tij në interes të Republikës së Maqedonisë dhe qytetarëve të saj. VMRO-DPMNE dhe Mickovski të pranojnë konceptin e një shoqërie, e jo kot ta përmendin në publik dhe media. Pavarësisht veprimeve të dëmshme të VMRO-DPMNE-së, Maqedonia po bëhet shtet demokratik modern dhe një shoqëri për të gjithë qytetarët", thuhet në kumtesën e LSDM-së. Në ndërkohë, ka reaguar edhe zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane, Bujar Osmani. Duke i reaguar Mickovskit, Osmani ka thënë të hënën se Qeveria ka paralajmërim se opozita do të pengojë reformat në gjyqësor dhe në administratën publike nëse miratohet Ligji për gjuhët.

MUNDËSI TË BARABARTA PËR TË CJITË

"Oferta e udhëheqësit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski, se partia e tij do të mbështesë planet e reformës së LSDM-së, nëse ligji për gjuhët tërhiqet nga procedura parlamentare është kulmi i papërgjegjshmërisë së një partie politike. Të thoni se unë do ta djeg shtëpinë, sepse nuk më plotësohet një nevojë momentale, është kulmi i mungesës së seriozitetit të një partie politike që pretendon të jetë udhëheqëse e shtetit" deklaroi Osmani. Sipas tij, deklarata për bashkim monoetnik për të parandaluar mundësinë e ofruar nga Marrëveshja e Ohrit, është anakronike dhe e rrezikshme.

"Nuk kam menduar se dikush mund të thoshte një gjë të tillë në vitin 2018", tha Osmani. Ai theksoi se kjo është një deklaratë serioze dhe shpreson të demantohet. Zëvendëskryeministri theksoi se Qeveria ka një vizion të qartë nga marrja e pushtetit që dëshiron ta arrijë deri në fund të mandatit. "Ne duam që Maqedonia të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë, dëshirojmë që Maqedonia të jetë anëtare e NATO-s dhe të jetë anëtare e Bashkimit Evropian dhe nuk

do të bëjmë kompromis me këto qëllime, as me planet që i kemi bërë për t'i arritur ato këto synime, të cilat janë marrëdhënie ndëretnike, ndërfaqinësore dhe reforma të brendshme", thekson Osmani. Ai siguron që të tilla, siç i quan ai, pikëpamje anakronike nuk do t'i dekurajojnë, por përkundrazi do t'i inkurajojnë ata të vazhdojnë dhe të tregojnë se koha e këtyre deklaratave ka kaluar. "Nëse udhëheqja e re e VMRO-DPMNE-së vazhdon me këtë retorikë dhe këtë fjalor, mendoj se partia nuk ka të ardhme të mirë", theksoi Osmani.

Qëndrimet e kryeministrit Zaev dhe zëvendësit të tij, Bujar Osmani erdhën pasi kryetari i VMRO-së dy ditë më parë tha se i jep mbështetje kryeministrit për ligjet reformuese vetëm më kushtin që Zaevi të tërhiqet nga Ligji për gjuhën shqipe. "Kryetari i VMRO-DPMNE, Hristian Mickovski, i ka ofruar mbështetje kryeministrit Zoran Zaev nëse ai dhe LSDM-ja vendosin ta tërheqin nga procedurat parlamentare Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Së pari, nëse mendon sinqerisht për të mirën e Maqedonisë dhe nëse deklarohet si politikan reformues, atëherë të vazhdojmë me proce-

LIGJIN PËR GJUHËT VMRO NJËHERË E KISHTE PRANUAR

"Është e qartë hipokrizia dhe përpjekja e partisë opozitare. Qytetarët e dinë mirë se VMRO-DPMNE-ja ka pranuar propozim ligjin për përdorimin e gjuhëve, me shpresë se do të formojnë Qeveri. Sot, Ligjin për përdorimin e gjuhëve VMRO-DPMNE e përdor vetëm si alibi për të vazhduar me bllokimin e reformave dhe me atë të bllokojnë zhvillimin dhe përparimin e Maqedonisë", thuhet në njoftimin e fundit të LSDM-së. Sipas kësaj partie, debati për përdorimin e Ligjit për gjuhët është i hapur 9 muaj dhe nëse VMRO-DPMNE dëshiron, deri tani kishte mundësi të marrë pjesë në procesin e sjelljes të Ligjit. "Në vend të kësaj partie opozitare vendosi

të bllokojë procesin dhe me atë të veprojë kundër vlerave evropiane dhe kundër ndërtimit të një shoqërie, koncepti i cili fitoi përkrahje të madhe nga qytetarët në zgjedhjet e fundit", thuhet në njoftimin e LSDM-së. Sipas LSDM-së, Ligji për përdorimin e gjuhëve është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe amendamentin 5 i cili është sjellë në vitin 2001. "Duket se Hristian Mickovski i mbështet politikën e paraardhësit të tij Nikolla Gruevskit, me çka VMRO-DPMNE përsëri punon kundër interesave të qytetarëve dhe shtetit", përfundon njoftimin partia në pozitë, LSDM.



BUJAR OSMANI

Oferta e udhëheqësit të VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski, se partia e tij do të mbështesë planet e reformës së LSDM-së, nëse ligji për gjuhët tërhiqet nga procedura parlamentare është kulmi i papërgjegjshmërisë së një partie politike. Të thoni se unë do ta djeg shtëpinë, sepse nuk më plotësohet një nevojë momentale, është kulmi i mungesës së seriozitetit të një partie politike që pretendon të jetë udhëheqëse e shtetit

sin e reformave, pasi ato janë prioritet i lartë për zhvillimin e vendit. Së dyti VMRO-DPMNE-ja i garanton Zoran Zaevit mbështetje në gjitha reformat, ligjet vetëm nën një kusht: Të tërheq nga procedura parlamentare Ligjin për përdorimin e gjuhëve", deklaroi Mickovski. Nga partia e tij po ashtu u reaguua ashpër ndaj avancimit të gjuhës shqipe në nivel zyrtar edhe në nivel vendi krahas gjuhës maqedonase. VMRO e quajti dëm të madh dhe të pariparueshëm miratimin, siç thanë nga kjo parti, "të dhunshëm" të Ligjit për gjuhët. "Miratimi i dhunshëm i Ligjit për gjuhët mund ta shtyjë vendin në krizë edhe më të madhe. Do të dërgohet një mesazh se procedura dhe ligjet nuk vlejnjë kur ekziston fuqia. E drejta për të propozuar ndryshime për të përmirësuar ligjet nëse shkelet njëherë do të shkelet dhe në të ardhmen, ndërsa kështu më nuk ka demokraci", citohet në njoftimin e VMRO-DPMNE-së.



Bashkëpunim zhvillimor me Suedinë

Shkup, 12 shkurt - Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani dhe drejtoresha e përgjithshme e agjencisë për Bashkëpunim Zhvillimor Ndërkombëtar të Suedisë (SIDA), Kerin Jamtin, të hënën në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane i nënshkruan Marrëveshje për Bashkëpunim Zhvillimor mes Republikës së Maqedonisë dhe Suedisë dhe Marrëveshje për kushtet e përgjithshme të Bashkëpunimit Zhvillimor mes Republikës së Maqedonisë dhe Suedisë. "Pas një pauze prej gjashtë vitesh, Republika e Maqedonisë sërish është në agjendën zhvillimore të Suedisë dhe sërish mes partnerëve prioritarë - shtetet për ndihmë zhvillimore nga Suedia", theksoi Osmani, duke potencuar se me nënshkrimin e këtyre Marrëveshjeve sigurohet një bazë formale - ligjore për realizimin e bashkëpunimit zhvillimor mes Republikës së Maqedonisë dhe Suedisë me të cilën Suedia qartë tregon se është partner i Republikës së Maqedonisë, si në kuptim zhvillimor, ashtu edhe atë politik dhe ekonomik. Jatmin theksoi mbështetjen e qartë për revitalizimin e aktivitetëve reformuese për afrimin drejt Bashkimit Evropian konfirmoi se Suedia është mbështetës i kamotshëm i perspektivës evropiane të Maqedonisë. "Integrimi evropian është proces kyç që krijon rrethana afatgjate që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve jetësore për gjithë qytetarët e Maqedonisë. Ne jemi të përgatitur ta mbështesim Maqedoninë në sfidat e rrugës së saj në këtë bashkëpunim zhvillimor. Me këto marrëveshje sigurohet qasje për Republikën e Maqedonisë për mjete zhvillimore nga Suedia në shumë indikative rreth 9 milionë euro për periudhën prej 2018 deri në vitin 2020. Këto mjete do të implementohen përmes financimit të projekteve në tre sfera prioritare, ngushtë lidhur me procesin e aderimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian edhe atë: avancim i integritimit ekonomik me Bashkimin Evropian dhe zhvillim i ekonomisë së tregut; përforsim i demokracisë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit dhe mbrojtja mjedisit jetësor dhe ulja e ndikimit dhe përgjigje më të mirë për ndryshime klimatike", tha Jetmin.

"Ndryshimi i Kushtetutës të mikut dhe fqinjit, nënkupton, e para implementimi i erga omnes-it, gjegjësisht përdorim të emrit të ri në të gjitha rastet - në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe për evitimin e mospajtimeve të ardhshme që do të dilnin pa këtë ndryshim...", thotë Kocias

Shkup, 12 mars - Nevojitet ndryshim i Kushtetutës që emri të jetë edhe për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, por edhe të evitohen akuza të ardhshme se janë shkukur dispozitat kushtetuese. Kështu ka thënë ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Kocias në një intervistë për gazetën greke "Dokumento", ndërsa deklaroi se është optimist i matur dhe se të dyja palët ende kanë shumë punë.

Shefi i diplomacisë greke, gjithashtu sqaron pse Greqia insiston që Maqedonia të bëjë ndryshim kushtetues. "Ndryshimi i Kushtetutës të mikut dhe fqinjit, nënkupton, e para implementimi i erga omnes-it, gjegjësisht përdorim të emrit të ri në të gjitha rastet - në nivel të brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe për evitimin e mospajtimeve të ardhshme që do të dilnin pa këtë ndryshim. E dyta, se në të ardhmen do të evitohet një Qeveri tjetër të fqinji të kërkojë sqarim për shkeljen e Kushtetutës, nëse Marrëveshja ndërkombëtare del nga kompetencat", thotë shefi i diplomacisë greke, ndërsa për mospajtimet për të cilat flet, Kocias sqaron se në periudhën e globalizimit kur përdoren dy emra të ndryshëm një për përdorim ndërkombëtar, tjetri për përdorim të brendshëm atëherë mospajtimet janë të pashmangshme. Sipas Kociasit, zgjidhja nuk duhet të jetë "njëri t'ia imponojë mendimin e tij tjetrit", por në pako marrëveshjen që do t'i përmbajë kompromiset e domosdoshme re-

NEGOCIATAT PËR EMRIN

KOCIASI KËRKON

NDRYSHIMIN E KUSHTETUËS, ZAEVI MBRON IDENTITETIN



ciproke.

Marrëveshja, konsideron ai, duhet të jetë pako marrëveshje, t'i përfshijë çështjet për të cilat bisedojmë në KB, eliminimin e irredentizmit dhe parashikimin e masave dhe kushteve që të mos ketë parqitje të sërishme, mbështetje për integritetin e vendit fqinj në organizatat ndërkombëtare dhe aktivitete të përbashkëta dhe shton se nevojitet periudhë kohore që të implementohen këto punë, sepse, siç thotë Kocias, "bota nuk ndryshohet për një ditë, madje edhe Zotit sipas Biblës, i janë nevojitur 6 ditë ta krijojë". "Gjithsesi, ky nuk është implementim i ndonjë metode abstrakte të ndarjes të zgjidhjes në pjesë, por element i pragmatizmit, realizimit, vend-

smërisë dhe ndjenjës së përgjegjësisë", thotë Kocias lidhur me zbatimin e zgjidhjes eventuale. Shefi i diplomacisë greke, në intervistën për gazetën "Dokumento", thotë se dritarja për mundësi për zgjidhje është hapur dhe për shkak të parimeve politike të Qeverisë greke, për shkak të masave për ndërtim të besimit, por edhe për shkak të ndryshimit të pushtetit në Maqedoni. ndërsa, në pyetjen sa afër apo larg jemi deri te marrëveshja deklaroi se është optimist i matur.

Në ndërkohë, kryeministri Zoran Zaev të hënën deklaroi se dëshiron që Maqedonia dhe Greqia në bisedimet për kontestin rreth emrit të gjejnë zgjidhje, e cila do t'i ruajë dinjitetin dhe identitetin e

dy palëve. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve lidhur me nisimat më të shpeshtuara nga pala greke për ndërrim të Kushtetutës së Maqedonisë, Zaev përmendi se dëshiron t'i japë shans procesit negociues. "Sipas meje, bisedimet të cilat zgjasin na afrojnë drejt zgjidhjes. Kuptohet, nuk është e lehtë me mesazhet që dërgohen në opinion, punohet për çështje serioze, e cila 25 vite nuk mund të zgjidhet: Nuk do të jepja komente të hollësishme për shkak se sinqerisht dëshiroj zgjidhje të këtij problemi shumëvjeçar, i cili do t'i ruajë dinjitetin dhe identitetin e dy palëve në bisedimet", tha Zaev. Ai nuk dha përgjigje kur saktë pret në Shkup të arrijë ministri i Punëve të Jashtme i Greqisë, Nikos Kocias.

PËRFAQËSUESI I LARTË I DEPARTAMENTIT TË SHKUP

Emri dhe NATO, top temat e bisedimeve me Miçel

Shkup, 12 mars - Vizita e përfaqësuesit të lartë të Departamentit të Shtetit, Ves Miçell në Shkup është vetëm konfirmim i miqësisë, por edhe mbështetje për proceset euroatlantike integruese të Maqedonisë", deklaroi kryeministri Zoran Zaev në konferencën e së hënës për shtyp në Shkup, me kryesuesin e Këshillit të ministrave të BeH-së, Denis Zvizdiq. Zaev duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve theksoi se Miçell vjen në kohën kur Maqedonia dëshiron ta avancojë bashkëpunimin me partnerët strategjikë.

"Një nga qëllimet kryesore strategjike të RM-së është NATO, ndërsa vendi është tekstualisht në hap nga anëtarësimi në NATO. Kjo mund të jetë në ndihmë të madhe. Do të bisedojmë për bashkëpunimin e dy vendeve, por edhe për perspektivat e NATO-s, do të kemi mbështetje edhe për integritetin tonë në BE, sepse ajo është partner strategjik", tha Zaev duke e komentuar vizitën e Miçellit.

Mbështetja e SHBA-së për aspiratat euroatlantike të Maqedonisë, për bisedimet të cilat vendi i zhvillon me Greqinë për kontestin

rreth emrit, por edhe apel deri te Qeveria e Maqedonisë për zbatimin e reformave për përforsim të demokracisë, sundimit të drejtësisë dhe lirisë së mediave, do të transmetojë ndihmës-sekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Ves Miçell, i cili nesër vjen në Shkup. Miçell në Shkup, siç tashmë publikoi MIA, do të takohet me kryeministrin Zoran Zaev dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov. Për kontestin me emrin pritet të bisedohet edhe në takimet që ndihmësi i sekretarit shtetëror amerikan më 15 mars në

Athinë do t'i ketë me përfaqësuesit e Qeverisë së Greqisë. Sipas paralajmërimit nga Departamenti amerikan i Shtetit, Miçell me autoritetet greke do të bisedojë edhe për thellimin e marrëdhënieve midis SHBA-së dhe Greqisë, përforsim të bashkëpunimit dypalësh, veçanërisht në fushat e mbrojtjes, energjetikës, tregtisë dhe investimeve. Miçell prej dje e fillon turneun e tij në vendet e Ballkanit, e cila do të zgjasë deri më 17 mars. Ai sot mbërrin në Prishtinë, nesër në Shkup, ndërsa pastaj do t'i vizitojë Beogradin, Athinën dhe Nikoznë.

75 VJETORI I INTERNIMIT TË HEBRENJVE NGA SHKUPI

“MARSHI I TË GJALLËVE”, QË HOLOKAUSTI TË MOS HARROHET

Në “Marshin e të gjallëve”, që nisi nga Muzeu i Shkupit deri tek Kombinati i duhanit (ish Monopoli) pjesëmarrësit iu drejtuan përmendores që i kushtohet 7144 hebrejve të deportuar. E kaluara nuk duhet harruar, ndërsa gjenocide të ngjashme nuk duhet lejuar që të përsëriten, ishte mesazhi i marshuesve



që jetonte atëherë në Maqedoni. E kaluara nuk duhet harruar, ndërsa gjenocide të ngjashme nuk duhet lejuar që të përsëriten, ishte mesazhi i marshuesve, mes të cilëve përfaqësues të komunitetit hebre, shoqatave, delegacion nga qeveria kryesuar nga kryeministri Zoran Zaev, si edhe kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, shefi i Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Denis Zvizdiq, e të tjerë. Borisov, zyrtari i parë nga Bullgaria që merr pjesë në një ceremoni përkujtimore në fjalën e tij shprehu keqardhjen për vuajtjet e hebrejve brenda ndërtesës së

monopolit, por edhe respektin për popullin bullgar që shpëtoi 48 mijë hebrej që jetonin në Bullgari.

“Ndodhemi sot këtu të shprehim respektin dhe dhimbjen ndaj të vrarëve, por edhe të nxjerrim mësim dhe të kuptojmë se në Ballkan duhet të ndërtojmë e të punojmë së bashku, të ecim përpara dhe popujt të jetojmë të lumtur dhe e gjithë kjo të mbetet pas, në histori... Nëse sërish lejojmë ngjarje të ngjashme, atëherë jemi budallenj. Dhe ne, politikanët e sotshëm, duhet të mbajmë përgjegjësi. Nuk i kemi harruar, lavdi atyre dhe prandaj jemi sot

këtu që të shprehim keqardhjen së bashku me maqedonasit për të gjithë ata që nuk arritën t'i shpëtojnë makinerisë naziste të vdekjes”, u shpreh Borisov. Në këtë ditë përsëriten leksionet e të kaluarës, për të ndriçuar më shumë rrugën e të ardhmes, u shpreh kryeministri Zaev.

“Nuk duhet asnjëherë të harrojmë se çfarë ka ndodhur këtu 75 vjet më parë. Historia i përsëritet vetëm atyre që janë të verbër ndaj të kaluarës. Dhe ne nuk do të verbohemi, do të vazhdojmë ta kujtojmë, që të mos përsëritet më kurrë”, tha kryeministri Zaev. Ndër-

sa kryetarja e Bashkësisë hebreje, Berta Romano, në fjalën e saj potencoi se pa të kaluar nuk kemi të ardhme, falim, por nuk harrojmë, që kjo të mos përsëritet më kurrë, për askënd dhe askund. Aktivitetet komemorativë vijuan në Parlament, ku në seancën kushtuar kësaj date u dënua holokausti dhe të gjitha format e gjenocidit, cenimit të të drejtave të njeriut, diskriminimi, gjuha e urrejtjes, e të tjera.

Në orët e para të 11 marsit të vitit 1943 u arrestuan thuajse të gjithë hebrejtë në Maqedoni. Grupi i hebrejve mes tyre, 539 fëmijë të moshës deri tre vjeç, 610 fëmijë nga 3 deri në 10 vjeç, 1172 deri të moshës deri 16 vjeç, 865 mbi 60 vjeç, 250 të tjerë në gjendje të rënduar shëndetësore pasi qëndruan disa ditë në ndërtesën e Monopolit, u internuan në kampin e përqendrimit në Treblinkë, të ndarë në tre grupe, gjatë datave 22, 25 dhe 29 mars të vitit 1943. Gjatë qëndrimit të tyre në këtë ndërtesë, ata u trajtuan në format më çnjerëzore. Sipas dokumenteve dhe evidencave të mbajtura nga nazistët atyre iu ndalohej të ndiznin zjarr, të shihnin nga dritarja, të pinin ujë. Ndërsa u lejohej të ushqeheshin 2 herë në ditë me supë të kripur, të mbanin të veshur vetëm një palë rroba dhe vetëm 30 minuta për 3 mijë persona për të kryer nevojat personale, ndërsa flinin mbi dërrasa në dhoma të mbushura ame nga 300–400 vetë.

Koha

Evis HALILI

Shkup, 12 mars - Përvjetori i 75-të i internimit të hebrejve nga Maqedonia drejt kampit të përqendrimit në Treblinkë është shënuar me një sërë ceremonish përkujtimore. Në “Marshin e të gjallëve”, që nisi nga Muzeu i Shkupit deri tek Kombinati i duhanit (ish Monopoli) pjesëmarrësit iu drejtuan përmendores që i kushtohet 7144 hebrejve të deportuar, që përbënin 98 për qind të popullsisë hebreje

Kufijtë e korrumpuar të Ballkanit

Berlin, 12 mars - Mendohej se itinerari i Ballkanit, nga ku në vitin 2015 e në fillim të vitit 2016 erdhën qindra mijëra refugjatë ishte mbyllur. Por media gjermane, duke u bazuar në të dhëna të Shërbimit Informativ Gjerman (BND), thekson se sërish përmes këtij itinerari vijnë mijëra refugjatë nga vende si Siria, Iraku, Somalia etj. Revista e njohur gjermane "Focus" i referohet një analize të brendshme të BND-së, ku thuhet se numri i refugjatëve që vijnë ilegalisht përmes itinerarit të Ballkanit (Greqi-Maqedoni-Serbi) në Gjermani përmes kontrabandistëve ka shënuar rritje të vazhdueshme në gjashtë muajt e fundit. Sipas BND çdo muaj vijnë rreth 15.000 vetë ilegalisht në Gjermani. Arsyeja për këtë rritje të kriminalitetit të kontrabandistëve, BND-ja gjermane e sheh ndër të tjera edhe tek korrupsioni. “Disa vendkalime kufitare kanë krijuar lidhje me kriminelët”, citon revista "Focus" BND-në duke theksuar se “disa pjesë kufitare japin shenja preksshmërie të policisë kufitare nga korrupsioni”. Sekretari i ri i Shtetit në Ministrinë e Brendshme gjermane, Stephan Mayer (CSU) është shprehur se “duhet të reagojmë ndaj këtij zhvillimi me të gjitha mjetet e shtetit ligjor”.

Mbahen Karnavalet Ilire në Bozovcë

Tetovë, 12 mars - Lëkurat e përpunuara të kafshëve, maskat dhe kambanat, këto janë sinonim i karnavalit të përvitshëm Ilir, që mbahet në Bozovcë të Malësisë së Sharrit në Tetovë. Me mëngjes, banorë të veshur me xhup lëkure të përpunuar, maska në fytyrë dhe kambana, dalin rrugëve të fshatit, për, siç thonë ata, frikësuar dhe larguar të keqen nga fshati dhe për t'i uruar mirëseardhje stinës së re. Kjo traditë ka filluar shumë vite më parë, por viteve të 80-ta, u ndërpre, dhe për dy dekada nuk u realizua e njëjta. Nga viti 2008 e njëjta u riaktivizua sërish, kësaj radhe ende më e fuqishme, që ka ndikuar për të sjellë në Bozovcë të malësisë së Sharrit, edhe studiues të albanologjisë dhe etnologjisë nga universiteti i Prishtinës dhe Tiranës. Përveç maskave që trembin, në këtë karnaval Ilir, garojnë edhe nusët. Sipas traditës, zgjidhet nusja që “do iu vë



këmbën gjitha nuseve të fshatit”. Kështu ndodhi edhe dje, njerëz të ardhur nga gjitha trevat shqiptare, nga afër ndoqën jo vetëm karnavalin Ilir të maskave të lëkurës, por edhe programin e pasur kulturor e artistik, të organizuar nga nikoqiri i manifestimit profesor

Neshat Memedi. Manifestimi vite më parë (mbajnë mend më të moshuarit) është realizuar edhe në disa fshatra të tjerë të malësisë së Sharrit, por tradita është harruar dhe zhdukur. E njëjta tanimë realizohet vetëm në Bozovcë. (E.H)

Para fillimit të seancës, dëshmitari Todorovski kërkoi nga gjykatësja përjashtimin e mediave nga seanca, për shkak të angazhimit të tij si nëpunës në Agjencinë për Zbulim, mirëpo e njëjta u refuzua, me arsyetimin se Prokurorët special nuk kanë për qëllim parashtrimin e pyetjeve që prekin karakterin e klasifikuar të të dhënave në këtë lëndë

Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 12 mars - Ish-shefi i kabinetit të Gordana Jankulovskës, Kiro Todorovski, ishte dëshmitari i parë i Prokurorisë Speciale Publike, i cili të hënën para Gjykatës Penale të Shkupit, foli për rolin e tij gjatë blerjes së veturës së blinduar "Mercedes", lëndë kjo e rastit "Tank". Përdërisa jepte deklaratën e tij para gjykatësës Dobrilla Kacaraska, dëshmitari Todorovski, ndryshe i punësuar në Agjencinë për Zbulim, tha se për blerjen e "Mercedesit" deri në ministri ishte dorëzuar vetëm një ofertë. Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për blerjen e veturës shumë të përfolur, dëshmitari Todorovski tha se ky furnizim publik i MPB-ë, është shpallur në opinionin dhe procedura ligjore ka qenë e respektuar në tërësi.

I obliguar për organizimin e punës të ish-ministres për Punë të Brendshme, Gordana Jankulovska, ish-shefi i kabinetit të saj, Kiro Todorovski, të hënën në Gjykatë, theksoi se detyra e tij ka qenë menaxhimi me resurse njerëzore në MPB-ë dhe se për herë të parë nga shefja e tij është caktuar anëtar Komisioni, në këtë rast pjesë e grupit për blerjen e "Mercedesit".

Punonjësi i Agjencisë për Zbulim, Kiro Todorovski, krahas dëshmisë që dha në rastin "Tank", nga

VAZHDON SEANCA GJYQËSORE PËR RASTIN "TANKU"

VETËM NJË OFERTË PËR "MERCEDESIN"



ana e PSP-së, ai llogaritet ndër të akuzuarit kryesor në rastin "Titanik", i cili pritet të filloj me 2 prill. Lidhur me këtë akuzë, vitin e kaluar Gjykata e shkallës së parë dhe shkallës së dytë, vendosi për shqiptimin e masës së kujdesit dhe konfiskimin e pasaportës. Seancën e fundit për rastin "Tank", po ashtu e karakterizuan reagimet dhe kundërshtimet e zakonta dhe të pabaza të palës mbrojtëse, shumica e të cilave u refuzua nga Trupi gjyqësor. Në këtë drejtim, avokatët e të akuzuarve Nikolla Gruevski, Gordana Jankulovska dhe Gjoko Popovski, kërkuan nga Gjykata, që dëshmitari i propozuar nga PSP-ja, të jetë edhe dëshmitar i tyre. Ndaj kësaj kërkesë reagoi Prokurori special, Gavril Bubevski, sipas të cilit, dispozitat e reja të Ligjit për procedurë penale, nuk e lejojnë që një person të jetë dëshmitar nga të dyja palët, nëse paraprakisht avokatët nuk kanë dorëzuar deklaratë me

shkrim, për rrethanat që duhet të fletë dëshmitari.

Kërkesës për të bindur Trupin gjyqësor se dëshmitari Todorovski duhet të jap rrëfimin e tij edhe për palën e akuzuar, e adresoi edhe ish-shefja e tij, Gordana Jankulovska, e cila nënvizoi se me parashtrimin e pyetjeve të drejtpërdrejta, e gjitha ngjarja do të jetë më e qartë për opinionin.

"Dëshmia e tij mund të jetë esenciale për rrënimin e tezës e cila qëndron në aktakuzë. Ai duhet të jap përgjigje për dy rrethana të krijuara, për nevojën e furnizimit me një veturë të asaj natyre dhe mënyrës së shfrytëzimit të këtij automjeti nga MPB. Përgjigja ndaj këtyre pyetjeve është shumë me rëndësi që gjykata të miratojë aktgjykim të duhur", tha Jankulovska. Pjesë e dëshmitarëve të PSP-së lidhur me këtë lëndë janë edhe tre persona tjerë, për të cilët ende nuk dihet se kanë qenë pjesë e Ko-

misionit për blerjen e "Mercedesit" apo bëhet fjalë për persona ekspertë të hetimeve që i kanë kryer deri më tani.

Ndryshe, para fillimit të seancës, dëshmitari Kiro Todorovski kërkoi nga gjykatësja Dobrilla Kacaraska përjashtimin e mediave dhe opinionit nga seanca, për shkak të angazhimit të tij si nëpunës në Agjencinë për Zbulim, kërkesë kjo e mbështetur edhe nga avokatët. Mirëpo, e njëjta u refuzua, me arsyetimin se Prokurorët special nuk kanë për qëllim parashtrimin e pyetjeve që prekin karakterin e klasifikuar të të dhënave në këtë lëndë. Ndryshe, ish-kryeministri Nikolla Gruevski, me dëshirën dhe urdhrin e të cilin u hap procedura për blerjen e "Mercedesit" 600 mijë euro, akuzohet për praninë të dhuratës përmes ndikimit të jashtëligjshëm. Seanca e radhës për "Tankun", vazhdon me datë 14 mars (e mërkurë).

Në BeH vetëm me letërnjoftime

Shkup, 12 mars - Qytetarët e Maqedonisë dhe Bosnjë e Hercegovinës prej dje do të mund të udhëtojnë në të dy vendet vetëm me letërnjoftime. Marrëveshja për këtë mundësi u nënshkrua të hënën nga kryeministri Zoran Zaev dhe kryetari i Këshillit të Ministrave të BeH-së, Denis Zvizdiq. Kryeministri Zaev në një konferencë të përbashkët shtypit theksoi se kjo tashmë është një praktikë që Maqedonia e ka vendosur më parë edhe me Serbinë edhe me Shqipërinë. "Ky është hapi i dytë konkret për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve midis dy vendeve pas marrëveshjes tashmë të nënshkruar për njohjen reciproke të patentave të shoferëve", tha Zaev. Përveç lehtësimit të lëvizjes së qytetarëve, me marrëveshjen e sotme të nënshkruar, lehtësohen kushtet për nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe studentët që do të studiojnë në kushte të barabarta si studentët nga Maqedonia. Tarifa e shkollimit do të jetë e njëjtë me atë të studentëve nga vendi. Zaev theksoi se Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina dërgojnë një mesazh se ata janë të përkushtuar seriozisht për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore me fqinjët dhe një rajon të bashkuar që synon perspektivat evropiane. Zvizdiq vlerësoi se nuk ka çështje të hapura midis dy vendeve.

PROTESTË E GAZETARËVE PARA QEVERISË

"TË GJITHË JEMI NASER SELMANI"

Shkup, 12 mars - Dhuna, kërcënimet dhe presioni ndaj gazetarëve dhe punëtorëve medial, urgjentisht të ndalohej. Kështu të hënën para Qeverisë apeloj kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Naser Selmani, i cili kërkoi nga Qeveria që, siç tha ai, "t'i ndalojë dhunuesit dhe kriminelët që kërcënojnë gazetarët". "Keni për detyrë t'i ndaloni dhunuesit, përndryshe ju do të jeni aleatët e tyre. Një regjim e përcollëm, nuk do të lejojme ngritjen e një tjetri. Nuk

ia kam frikën askujt. Nuk ia kisha frikën Gruevskit dhe bashkëpunëtorëve të tij dhe aq më pak do t'ja kem frikën dhunuesve të BDI-së, dhe atyre që heshtin", tha kryetari i SHGM-së, Naser Selmani.

Pjesë e kësaj proteste e cila u zhvillua të hënën ishte edhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve, kryetaria e së cilës, Tamara Çausidis, tha se sulmi dhe kërcënimet e fundit ndaj Selmani, janë sulm ndaj të gjithë gazetarëve. "Karrotreci e ka dorën e gjatë, por ne nuk

frikësojmë nga karrotrecët. Kështu që kërkujmë mbrojtje policore për Naser Selmanin dhe qasje më serioze nga Prokurori lidhur me procedimin e lëndëve", tha kryetaria e SPG-së, Tamara Çausidis. Rastin në fjalë, para protestuesve e ka dënuar edhe ministri pa resor i angazhuar për komunikime, Robert Popovski, i cili tha se Qeveria e re ka tolerancë zero ndaj të gjitha presioneve dhe kërcënimeve, përfshi edhe censurën e cila është ndaluar me Kushtetutë. Kjo protestë e ga-



zetarëve u realizua pasi Beqir Asani, anëtar i lartë i Kryesisë së BDI-së në Çair, ditë më parë në mënyrë verbale e ka cilësuar Selmanin, si një "fundërrinë", "kopil"... ndërsa mesazh kërcënues ndaj tij kishte

lëshuar edhe vëllai i Asanit. Në protestën para Qeverisë morën pjesë qindra gazetarë, ndërsa dënuan ashpër gjuhën e dhunës dhe kërcënimet ndaj Selmanit dhe gazetarëve në përgjithësi. (O.XH)

PAS LARGIMIT TË EKSTERNES DUHET MENDUAR MEKANIZMA TË TJERA KONTROLLI

NOTIMI I NXËNËSVE PA STANDARDE

Pavarësisht të gjitha argumenteve kundër vlerësimit ekstern të nxënësve (2013-2017) dhe defekteve që kishte gjithë ai proces, shkollat nuk është mirë të mbeten pa një mekanizëm kontrolli në drejtim të përmirësimit të cilësisë së notimit



Duhet të vendosen standarde të reja për mënyrën e vlerësimit të nxënësve", shprehet Miftari.

Në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH) faktikisht nuk kanë një analizë të plotë rreth dobësive dhe pikave pozitive të vlerësimit ekstern (2013-2017) ashtu sikurse nuk e kanë një gjë të tillë as në Qendrën Shtetërore të Privimeve (QSHP) apo në Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA). Këta të fundit, pohojnë se janë duke punuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë së notimit të nxënësve nga ana e mësimdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme. Në drejtim të kësaj thonë se kanë organizuar trajnime, me arsimtarë të matematikës dhe lëndëve tjera të shkencave natyrore. Vitin e kaluar në kuadër të një projekti, të financuar nga programet "Erasmus +", BZHA organizoi dy herë radhazi trajnimin e mësimdhënësve të lëndëve në fjalë, duke sjellë profesorë të dëshmuar nga Universiteti i Kembrixhit (Britani të Madhe) dhe Universiteti Ndërkombëtar i Aflatounit (Mbretëria e Hollandës). Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë të risin cilësinë e notimit të nxënësve dhe krahas kësaj të riteve dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve në këto lëndë, me qëllim të përafrimit me standardet e shteteve të zhvilluara evropiane.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 12 mars - Largimi i eksternes nga shkollat fillore dhe të mesme vërtetë që ka shpëtuar shkollat nga tollovia e padobishme që shkaktonin testimet e qindra mijëra nxënësve në periudhën e përfundimit të vitit shkollor (për nxënësit nga klasa e katërt e arsimit fillor deri vitin e parafundit të arsimit të mesëm) dhe në përfundim të gjysmë vjetorit të parë (për nxënësit maturanët), mirëpo nuk do të thotë se shkollat nuk kanë nevojë për kontroll në mënyrën e vlerësimit (notimit) të nxënësve. Sipas shumë ekspertëve të fushës, shkollat duhet të punojnë në gjetjen e

mekanismave dhe standardeve të tjera të vlerësimit të nxënësve, sidomos për lëndët e matematikës dhe shkencave natyrore.

Mekanismat e rinj mund të mos jenë me kontroll të jashtëm, si në rastin e vlerësimit ekstern të nxënësve, i cili zgjati nga viti 2013 deri në vitin 2017, por është koha që të gjenden forma të tjera më të përshtatshme për të rritur cilësinë e notimit të nxënësve. Kjo, duhet të jetë një imperativ pavarësisht përvojës jo të mirë që kishte Maqedonia me vlerësimin ekstern, i cili dështoi jo sepse sistemi arsimor nuk ka nevojën e mekani-

mave dhe standardeve të kontrollit, por sepse nuk ishin gjetur instrumentet përkatëse për të pasur një kontroll real dhe të përdikueshëm nga faktor të tjerë të jashtëm. Të gjithë janë dakord se për nga forma se si zbatohet vlerësimi ekstern i nxënësve në Maqedoni, i gjithë ai procesi u kthye në një farsë të kontrollit të diturive, vlerëson Merita Arifi, mësimdhënëse në shkollën fillore "Panajot Ginoski" në Shkup. Kështu që, sipas saj, kontrolli për nivelin e njohurive të nxënësve dhe rrjedhimisht edhe për cilësinë e notimit të tyre nga ana e mësimdhënësve, dështoi të jetë një vlerësim kredibil. Sepse,

"ai vlerësim kishte dobësi të thella sa i përket objektivitetit të notave që marrin nxënësit në testimet përkatëse". Përveç kësaj, sikurse pohon Edmonda Miftari, mësimdhënëse në po këtë shkollë, "jo të gjithë nxënësit testoheshin në kushte të barabarta". Për pasojë, vëren më tej ajo, ishte i pa qëndrueshëm edhe parimi i testimit të nxënësve me teste të njëjta për të gjithë. "Argumentet përse duhej ti jepej fund atij eksperimenti janë të shumta. Megjithatë, duhet menduar që edhe kjo mënyrë e notimit të nxënësve, sikurse është tani e vite të tëra të ndryshojë disi.

KËRKESË E ODAVE EKONOMIKE

VMRO TË MOS PENGOJË MIRATIMIN E LIGJIT

Odat ekonomike kërkojnë nga deputetët e shumicës parlamentare që sa ma shpejtë ta miratojnë Ligjin për përkrahje financiare të investimeve, ndërsa i apelojnë edhe VMRO-së të mos e pengojë miratimin e këtij Ligji, por të merr pjesë në seancën plenare kur do të debatohet për ligjin në fjalë



sektori i biznesit privat të tërheqë vlerën prej 50 milionë eurove që parashihen me këtë ligj. Kjo është kërkesa e Odave Ekonomike në Maqedoni deri te deputetët e shumicës parlamentare dhe opozitës, sepse siç thonë odat ekonomike, tërheqja e shpejtë e subvencioneve do të ndikojë dukshëm në lëvizjen e ekonomisë vendore dhe do të kontribuojë në mënyrë direkte në rritjen industriale. Krye-

tari i Odës Ekonomike të Maqedonisë (OEM), Branko Azeski, thotë se kompanitë nga sektori privat në Maqedoni janë të kënaqura me masat që parashihen në planin e Qeverisë për rritje ekonomike dhe mu për këtë - sektori i biznesit privat kërkon nga deputetët e shumicës parlamentare e në veçanti nga deputetët e partive opozitare të mos e pengojnë në asnjë mënyrë miratimin e Ligjit për përkrahje

financiare të investimeve, i cili deri në fund të kësaj jave, duhet të jetë në rend dite në seancë plenare në Parlamentin e Maqedonisë. "Presim që me procedurë të përspejtuar Parlamenti ta miratojë Ligjin për përkrahje financiare të investimeve, si dhe rritjen e punësimeve të reja. Apeloj deri te deputetët e shumicës parlamentare e sidomos deri te deputetët e VMRO-DPMNE-së të ndërpresin me bllokadën e punës Parlamentin dhe të marrin pjesë në seancën kur do të debatohet Ligji për përkrahje financiare të investimeve dhe të votojnë pro këtij Ligji, sepse miratimi i këtij Ligji është treni i fundit për afaristët privat që do t'i çojë drejtë rrugës së vërtetë", tha Azeski. Njëherësh, edhe kryetari i Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore (OEMPV), Nebi Hoxha, Ligjin për përkrahje financiare të investimeve e vlerëson si shumë pozitiv, por se pas miratimit Ligjit, të cilin duhet shumë sh-

pejtë ta miratojë Parlamenti, Hoxha kërkon të kihet kujdes se cilat firma duhet të subvencionohen. Ligji për përkrahje financiare të investimeve parashihet ndarjen e subvencioneve në vlerë prej 50 milionë euro në bazë të tre shtyllave - subvencione në pjesën e konkurrencës për të gjitha subjektet afariste që kanë rritur konkurrencën e tyre që të mund afaristët më lehtë të dalin në tregjet e treta. Përkrahje financiare do të jepen edhe atyre kompanive që do të krijojnë vende të reja pune dhe se rroga mujore që do të japin subjektet afariste të jetë për 50 për qind nga lartësia e rrogës minimale. Gjithashtu, Ligji për përkrahje financiare të investimeve parashihet dhe ndarjen e granteve për të gjitha të rinjtë deri më 29 vjet që dëshirojnë të hapin biznese familjare dhe atë 5000 euro për person apo plus edhe 5000 euro tjera nëse fituesi i grantit punëson edhe një person tjetër.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 12 mars - Sa më shpejtë të votohet Ligji për përkrahje financiare të investimeve, i cili tani më është në procedurë parlamentare, aq më shpejtë do të mundet që

Edhe përkundër sfidave të shumta që po ballafaqohen qytetarët e Maqedonisë nga katastrofat natyrore që po ndodhin këto tre vitet e fundit, nga kompania e sigurimeve "SIGAL Uniqa Austria" thonë banorët ende veprojnë në bazë të mentalitetit se nuk duhet të jepen para kur puna është për sigurimin e pronës ndaj çfarëdo lloji tjetër të fatkeqësive të mundshme

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 12 mars - Dëmet e shkaktuara pas vërshimeve dhe tërmeteve në 3 vitet e fundit në Maqedoni, ende mbeten të pambuluara financiarisht nga kompanive të sigurimeve.

Këtë situatë më së miri e sqaron Saimir Dharmo drejtor i kompanisë së sigurimeve "SIGAL Uniqa Austria", sipas të cilit, edhe përkundër sfidave të shumta që po ballafaqohen qytetarët e Maqedonisë nga katastrofat natyrore që po ndodhin këto tre vitet e fundit, banorët ende veprojnë në bazë të mentalitetit se nuk duhet te jepen para për sigurimin e pronës ndaj çfarëdo lloji tjetër të fatkeqësive të mundshme.

"Nuk është vetëm mentaliteti, arsyeja se pse qytetarët Maqedonisë nuk sigurojnë pronat e tyre. Arsyeja e parë është se shteti gjithmonë pas ndodhjes së këtyre fatkeqësive natyrore i subvencionon qytetarët për dëmet që u shkaktohen nga vërshimet

TREGU I SIGURIMEVE NË MAQEDONI

MENTALITETI I QYTETARËVE DUHET NDRYSHUAR



përmbytjet, djegiet apo tërmetet. Arsyeja e dytë, që ndoshta është edhe kryesorja se pse qytetarët nuk sigurojnë pronat e është numri i madh i banorëve të varfër që ka Maqedonia. Mu këtu është dhe absurdi sepse qytetari i thjeshtë ende nuk e ka të qartë se kompanitë e sigurimeve punojnë pikërisht për njerëzit e varfër e jo për të pasurit. Sepse ai që është i pasur nuk shqetësohet edhe aq shumë nëse i digjet shtëpia apo i ndodhë ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore sepse ai ka para dhe është në gjendje që

individualisht të mbulojë dëmet e shkaktuara ndaj pronës së tij. Mirëpo nëse dëme pëson një qytetarë i varfër atëherë vështirësitë janë të shumta që ai do të mund të mbulon dëmet e shkaktuara nëse nuk e ka siguruar pronën", thotë Dharmo.

Ajo që duhet ndryshuar në tregun e sigurimeve, sipas Dharmos, është ndryshimi i domosdoshëm mentaliteti i rritjes së ndërgjegjes së qytetarëve dhe të kuptojnë se kompanitë e sigurime janë industri e mbrojtjes së interesave të tyre financiare dhe se në këtë drej-

tim rol të madh mund të luaj edhe shteti duke krijuar një skemë të re sigurimesh në bashkëpunim me kompanitë e sigurimeve.

"Shteti duhet të krijojë një skemë të atillë që qytetarët të paguajnë prime të sigurimeve dhe kështu të formon një fond sigurimesh që më pas të mund nga fondi i siguruar të paguhet të gjitha dëmet që do të shkaktohen qofshin përmbytje, djegie, vërshimeve apo tërmeteve. Pra kjo e bën të domosdoshëm zhvillimin e kulturës dhe legjislacionit për sigurimet.

Ndërtimi i një strategjie të saktë për sigurimet nuk duhet të jetë për të rritur formalisht tregun, por një strategjie mbrojtjeje financiare të interesave të qytetarëve. Edukimi i publikut si nga ana e kompanive të sigurimit dhe shtetit është mënyra e vetme për të ndryshuar në vijimësi kulturën e pakët të qytetarëve që kanë ndaj kompanive të sigurimit", thotë Dharmo. Sipas tij, në këtë drejtim kompanitë e sigurimit duhet të jenë më të përgjegjshme për të mbrojtur interesat e tyre financiare të qytetarëve sepse vetëm kështu qytetarët do të bëhen më të pavarur nga shteti dhe strukturat e saj.

"Qytetarët duhet të ndryshojnë mentalitetin se shteti duhet të kujdeset dhe në këtë drejtim individualisht nuk duhet bërë asgjë, edhe për biznesin, edhe për jetën, edhe për shtëpinë, edhe për shkollën, edhe për bukën, edhe për ujin. Është më se e nevojshme të kuptohet se qytetarët e Maqedonisë jetojnë në një sistem ku individ duhet të jetë i pavarur dhe i mbrojtur financiarisht nga çdo gjë, dhe këtë mbrojtje e bëjnë vetëm kompanitë e sigurimeve", thotë Saimir Dharmo, drejtor i kompanisë lider në Maqedoni për sigurime "SIGAL Uniqa Austria".

FORUMI I BIZNESIT NË ODËN EKONOMIKË

DIGJITALIZIMI SIPAS SHEMBULLIT TË ESTONISË

Shkup, 12 mars - Maqedonia do t'i shfrytëzojë përvojat e Estonisë që ta ngritë nivelin e digjitalizimit, por edhe të mësojë nga kjo ekonomi e vogël, si tërhiqen mjetet nga fondet evropiane, u tha në forumin e djeshëm të biznesit në Odën Ekonomike. Forumin e paralajmëroi vendosja e fundit e linjës ajrore e drejtpërdrejtë Ohër - Tallin dhe dërgoi porosi për intensifikim të domosdoshëm të bashkëpunimit afarist midis dy vendeve duke marrë parasysh se për këtë nuk kurrfarë pengesa reale, as nuk ekzistojnë çështje të hapura. Si të parandalohet ikka e të rinjve. Kuadrove të arsimuar, theksuan pjesëmarrësit, duhet të jetë prioritet edhe në Maqedoni edhe në Estoni.

"Estonia ka situatë të ngjashme si ne, ndërsa rezultate shumë më të mira. Me politikën agresive të teknologjive digjitale, u impo-



nua si partner serioz të ekonomisë evropiane. Nëse ne këtu, në këtë segment, nuk bëjmë përpjekje maksimale që të jemi konkurrentë, do ta rrënojmë përparësinë tonë personale lidhur me ekonomitë e

mëdha - të jemi më të mençur, më të mirë dhe më krijues si burim i serviseve. Digjitalizimi, njëherit, është lartë në axhendën e BE-së", deklaroi kryesuesi i Kuvendit të Odës Ekonomike të Maqedonisë

Antonio Peshev i cili është nikoqir i delegacionit të Estonisë. Sipas tij, bashkëpunimi tregtar me Estoninë deri më tani është zhvilluar në mënyrë të rastësishme, të paorganizuar dhe pa strategji. Edhe pse

Maqedonia shënon bilanc dhe sufit tregtar pozitiv prej rreth tre milionë dollarë, shembulli nuk është mjaft i mirë. Se shkëmbimi është i vogël dhe jo përkatës në mundësitë, u pajtua edhe ambasadori i Estonisë Vajno Reinart.

"Deri para tre viteve shkëmbimi ishte i përkufizuar në 400.000 euro. Por, prej atëherë e deri më tani është rritur për 15 herë. Ka arritur gjashtë milionë euro. Ky është një progres i konsiderueshëm, por mundemi edhe më shumë", potencoi ambasadori.

Afaristët nga Estonia vlerësojnë se Maqedonia ka politikë të vulltshme tatimore, ndërsa kërkojnë partnerë për bashkëpunim kryesisht në industrinë ushqimore dhe bujqësi. Lidhur me eksportin dhe importin, Maqedonia në Estoni më shumë plason përçues elektrik, ndërsa importon peshk të konservuar.

HAPËSIRAT PUBLIKE T'U KTHEHEN QYTETARËVE

FILLON BETEJA ME UZURPATORËT E TROTUAREVE

Nga pushteti lokal në Tetovë apelojnë deri te qytetarët që të tregohen të vetëdijshëm dhe ushtrimin e aktiviteteve ekonomike ta bëjnë në tregjet dhe vendet e parapara për këtë veprimtari, e jo në hapësirat ku vënë në rrezik jetën e këmbësorëve dhe qytetarëve

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 12 mars - Uzurpuesit e pronave publike në Tetovë gati se njëzet vjet po i zënë frymën qytetit dhe pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve. Që ironia të jetë më e madhe, bëhet fjalë për prona përgjatë trotuareve dhe vendeve publike ku pamundësohet qarkullimi i lirë edhe i qytetarëve, por edhe i automjeteve. Inspektorati komunal i Komunës së Tetovës filloi të hënën aksionin e paralajmëruar me të cilin do të kthejnë trotuaret, shtigjet për këmbësorë dhe hapësirat e gjelbërta në shërbim të qarkullimit të lirshëm të qytetarëve. "Gjatë ditës së hënë aksioni filloi përgjatë bulevardit të Ilindenit, dhe është për tu përshëndetur fakti që të gjithë pronarët e lokaleve ishin mjaft kooperativ dhe vepruan në mënyrë të menjëhershme konform kërkesës së inspektorëve komunal, duke mënjeluar mallin, materialin dhe karriget që ishin të vendosura përgjatë trotuareve. Gjithashtu, informojmë dhe inkurajojmë afaristët që të veprojnë dhe në kontinuitet të respektojnë Ligjin për pastërti publike, në të kundërtën - Inspektorati komunal, SPB Tetovë dhe Inspektorati shtetëror i tregut do të shqiptojnë dënime dhe gjoba për të gjithë subjektet dhe afaristët të cilët do të refuzojnë



dhe do të veprojnë në kundërshtim me urdhëresën e Inspektoratit komunal", njoftuan nga Komuna e Tetovës. Ky aksion do të vazhdojë në të gjitha rrugët dhe hapësirat e qytetit, dhe i njëjti do të zgjasë për aq kohë sa do të jetë e nevojshme, deri sa të kthejmë të gjitha hapësirat publike në shfrytëzim publik për të gjithë qytetarët. Përndryshe, të hënën ka përfunduar afati ligjor prej 8 ditësh, me të cilin u informuan të gjithë pronarët e lokaleve afariste për të liruar hapësirën publike përpara lokaleve të tyre. Komuna e Tetovës paralajmëron të gjithë shitësit ambulant që kryejnë veprimtari në hapësira publike, se ky aksion nuk do të jetë i natyrës ekspeditive, dhe i njëjti do të implementohet në vazhdimësi, deri në vendosjen definitive të rendit publik, kurse për personat të cilët nuk do ta respektojnë këtë vendim, nuk do të ketë aspak tole-

rancë dhe për të njëjtit do të pasojnë sanksione dhe gjoba rigoroze. Nga pushteti lokal në Tetovë apelojnë deri te qytetarët që të tregohen të vetëdijshëm dhe ushtrimin e aktiviteteve ekonomike ta bëjnë në tregjet dhe vendet e parapara për këtë veprimtari, e jo në hapësirat ku me aktivitetin e tyre, vënë në rrezik jetën e këmbësorëve dhe qytetarëve, të cilët në mungesë të hapësirës adekuate, janë të obliguar të qarkullojnë në anësh rrugëve ku qarkullojnë automjetet. Në ndërkohë, në shumë lagje dhe rrugë të Tetovës vërehen vetura dhe automjete të tjera si kamion dhe furgonë, të cilët me vite të tëra qëndrojnë në hapësira publike. Në disa vende është e pamundur të qarkullohet pikërisht nga këta automjete të cilët janë lënë në trotuare dhe vende të papërshtatshme me vite të tëra. "Aksioni për largimin e automjeteve të havarisura do të vazhdojë

edhe në të ardhmen, nga ku do të bëhet detektimi i tyre nëpër qytet dhe më pastaj do të vazhdohet me zbatueshmërinë e masës për largimin e tyre nga ana e autoriteteve komunale", theksojnë nga shërbimi për informim i Komunës së Tetovës. Më vështirë janë rrugët që çojnë për dalje nga qyteti ku janë edhe të vendosura shumica e marketeve. Trotuare dhe rrugë të pakalueshme, vetura të parkuara gjithandej, ngarkim-shkarkim i mallit pa respektuar orarin prej orës 19 në mbrëmje deri ora 7 në mëngjes. Mallrat nëpër markete të ndryshme zbarkohen edhe në mes të ditës, ndërsa transportuesit e bllokojnë rrugën dhe më pas krijohet tollovia në rrugët e Tetovës edhe pse ekziston një vendim i sjellë nga përbërja e kaluar e Këshillit të Tetovës që ngarkim-shkarkimi i mallit në disa rrugë të qytetit të bëhet me orar të caktuar.

Ceremoni mërgimtarësh në Cyrih

Cyrih, 12 mars - Dhjetëra mërgimtarë, profilesh të ndryshme, në mesin e tyre edhe Islam Spahiu, Udhëheqës i konsullatës së Republikës së Kosovës në Cyrih, ishin tubuar të dielën pasdite për të shënuar solemnisht zgjedhjen e Perparim Avdilit (me prejardhje nga Llojani i Kumanovës), asamblist të parë në Qytetin e Cyrihut nga radhët e partisë liberale FDP. Ndonëse të dielat i ka ditë pushimi restoranti Schwarzer Bären, me pronar shqiptar u hap, në shenjë të këtij tubimi të përbashkët festiv, të bashkëkombëseve tanë në me-



sin e të cilëve edhe arbëresh por edhe miq nga radhët e zvicranëve, ku nuk munguan as pijet e ndryshme e as flija e picat, por

edhe as muzika. Nga viti në vit shqiptarët në këtë vend si edhe gjetiu në mërgatë, që po arrijnë suksese të vazhdueshme në të

gjitha fushat, e tash edhe në politikë, çdo arritje po e përjetojnë e shënojnë si gëzim të përbashkët. Ndaj edhe kësaj radhe këshilltari i parë shqiptar i qytetit të Cyrihut falënderoi në dy gjuhët, duke theksuar edhe kontributin e një numri të shqiptarëve me shtetësi zvicerane nga një-sia e tij zgjedhore në Altstetten, ku triumfoi me gjithsej 1777 vota. Në këtë mbrëmje nuk mungoi pra, as kënga e muzika nga radhët e të pranishmëve, në mesin e të cilëve edhe studentët e të diplomuarë në Universitetin e Cyrihut. (R.RIFATI)

KRONIKË

Dy vjedhje në rajonin e Gostivarit

58 vjeçari me iniciale N.A nga fshati Çegran i Gostivarit ka denoncuar një vjedhje e cila në periudhën kohore me datës 8 deri më 10 mars ka ndodhur në shtëpinë e tij me iniciale B.A, përkohësisht i punësuar në Gjermani. Pasi me forcë kanë hapur dritaren e katit përdhës, hajnat kanë hyrë brenda dhe nga njëra prej dhomave të katit kanë marrë gjësende të ndryshme me vlerw si një gjerdan ari, hallka, unaza dhe të ndryshme, duke përfutur kështu në mënyrë të paligjshme rreth 430 mijë denarë. Pas ekspertizës së kryer në vendin e ngjarjes po punohet në zbardhjen e rastit të denoncuar si dhe zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje. Në periudhën kohore mes datës 8 dhe 11 mars, deri më tani persona të panjohur kanë kryer një tjetër vjedhje në shtëpinë e 82-vjeçarit me iniciale D.S nga fshatin Vvrbjan i Rekës së Poshtme. Pa kërkuar shumë nëpër shtëpi, nga një kuti druri kanë marrë rreth 450 euro, 20 franga një shumë të konsiderueshme lekësh shqiptarë, si dhe gjësende të ndryshme nga ari. Vjedhjen e ka denoncuar djali i pronarit të shtëpisë. Në ndërkohë po ndërmerren masa dhe aktivitete për zbardhjen e plotë të rastit si dhe zbulimin e autorëve të vjedhjes në fjalë.

Aksident afër Debërcës

Në rrugën regjionale Tetovë-Shkup, në afërsi mbikalimit të Dëbërcës të dielën rreth orës 19.30 minuta ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy vetura, një veturë e tipit "Opel Tigra", të cilën e ka drejtuar 21-vjeçari me iniciale H.K nga fshati Llërcë, si dhe një Volksfagen Kedi e drejtuar nga 36-vjeçari me iniciale R.V nga Zhelina. Në këtë aksident, dy vozitës si dhe një 17-vjeçar, bashkudhëtarë i veturës së tipit Opel, kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në Spitalin e Tetovës nga ku pas marrjes së ndihmës mjekësore, janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas të dhënave fillestare që bazohen në ekspertizën e kryer në vendin e ngjarjes, shkak për këtë aksident është mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet të jetë rreth 100 mijë denarë.

Cigarja epike...!

Nga

Adelina MARKU



Unë fillova të pi cigaren diku ne vitin '98-'99 dhe ia bënja vetëm paf puf (thoshte gyshja ime lu-neshë), se aspak nuk ia dinja lezetin! Do kisha harru se e kam pirë biles pafpufshëm sikur mos ndodhte Darka e Madhe (...e quaj unë). Hmmm, kam memorje selektive për më keq, prandaj dhe nuk i rrendis dot kronologjikisht datat e ndodhive kyçe të saj, as mund' nuk i jap t'a kujdesi historinë e datave në jetën time. Është një trajtë as mish as peshk kjo lloj ikje e vazh-dushme imja, kujtesës. Me gjasë hazdisshëm më pëlqen t'a vazhdoj rrugëtimin ashtu siç më vjen ...pa pik mëshire ndaj ditëve e viteve që ikin, prandaj dhe Darkën e Madhe po e zhvendos të ketë ndodhur në vitin 2000, po po, 2000-ta ishte. Dhe u ndodhëm të ulur të katërt në një sallë të veçantë darkimi të hotelit Aleksandar Palace në Shkup. Disa herë më pat pyetur Z. Arbën (Xhaferi) nëse ishte darkë në vedi ose nëse na kishin ftuar bashkë me të tjerët në pritje diplomatike për hir të ardhjes së George Soros në Shkup dhe si sot e mbaj mend ankthin tim të madh, ah të stërmadh Mal, sepse nuk isha vëmendur mjaftueshëm në llojin e ftesës që na kishin bërë. Z. Arbën ishte nga ata meshkujt me shije tejfine dhe durim të stërhollum! Pothujse perla i vareshin indeve skofiare të shijes së tij plot durim. Vazhdimisht art; vazhdimisht paqë! Çfar' Njeriu kish bo Perëndia me të! Çudi! Ai rrallë, rrallë tregonte nervozizëm, o nuk t'a kap truni sa rrallë tregonte nervozizmin de- por asaj dite dukshëm ma shpulli në fytyrë hidhërimin që ia kisha shkaktu me pakujdesinë time! Ai nuk ma toleronte hazdisjen a, jo për diçka tjetër, por vetëmse kishte frikë se nuk e vlerësoja mjaftueshëm Përgjegjësinë që ushtronte funksioni im në atë kohë që gjëmonte politikë, e... lufta më vonë! Hej, Arbni kishte të drejtë, unë isha e Hazdisura e Madhe! Meritoja dru shpinës, t'lagt bile! - do thoshte im atë tuj qesh këndeve të buzëve!

Bekimi, truproja i Arbni pothujse na fluturoi rrugës Tetovë-Shkup, në ndërkohë unë e kisha qartësuar ftesën, na kishin ftuar në darkë tet' a tet' me George Soros, ndërsa darkës do ishte dhe Vladimir Milçin – ish drejtori i Fondacionit Soros në Maqedoni, një intelektual socialdemokrat. Arbni,

thellë thellë ia donte goxha social-demokracisë, tuj ec madje edhe gjilpanave të paqëndrushme të liberalizmit! Nejshe! Ishin këto ditët kur themelohej UEJL dhe lobonim për fonde! Asaj, Darkës s'Madhe (për mu ...) Arbni foli për fatkeqësitë që i sjell (sillte) Cinizmi aktual opinionit në ndërkohë që pionershëm ushtrohej pozitivisht narrativi politik i politikëbërjes funksionale multikulturore; ai e tipizoi këtë lloj Cinizmi që buronte nga pala maqedonase si një vetëdije të rrejshme të arsimit që sjell vetëmse letargji në shoqni, krizë një pas nja - ciklike, që krijon ndërgjegje të rrejshme mbi Sovranin, e përsëriti tezën e përsesë së arsimit të lartë në gjuhën shqipe e si rrjedhojë zyrtarizimin e gjuhës shqipe pararelisht tuj fol për konceptin e Kushtetutës së Gjallë që vetëmse e ngazëllen për së mbari një shoqni kaq të ndarë si kjo e Maqedonisë. Masnej shpalosi të dytën, rrandësinë e prodhimit kulturor e garrës kulturore në një shoqni të trashëgume si kjo e Maqedonisë. Hyni në të tretën, stabilitetin që buronte jo nga syni GeorgeOrwellian mbi 1984, por atë që e prodhoni vetëm institucionet shtetërore

transparente dhe inkluzive, e preku edhe ngërçin e ngrirë politikisht mbi emrin e shtetit e tuj citu Gëten, ia qartësonte Sorrosit (të shndrum sy e vesh tanimë ...) se të greqizosh ekskluzivisht antikën do thotë të përjashtosh shtrembrum shikimin historik të rrethanave të kohës ndër shekuj, pra antika degëzohej rregjionit ballkanik tuj e rrumbullakësu kërthizën bukur mirë...! Ojjjjj siklet, oj Perëndi, unë duhesha t'a përkthej! Ia dija përmendësh të gjitha tezat, të gjitha pa diskutim! Kisha gjithvulvu vëmendjen time ndaj çdo teze të Arbni asajkohe! Isha bo e gjitha vulvë (shprehje kjo e nje mikut tim të shtrenjtë sa Bota!) por mbeta e shtangun! Isha ftof në djersët e mia që më rrëshqisnin lugut t'shpinës e haj! Për më shumë, asaj darke dhoza cigaren mbrapsht! Pothujse u dogja me flok e me gjith'!!!! Hapu varr të futem Brenda! Mbarrova, sosa nga turpi! Hahaha, cigarja epike!

E si mund të harroj Darkën e Madhe! Pothujse u vetëdogja! ...Por ia vlejti (gjoja trimnohen nga kjo prespektivë tani...), Universiteti i Evropës Juglindore ku do mësohej në gjuhën shqipe, maqedo-

Interesinyë është të krijojmë shqiptarë të kënaqur e jo shqiptarë të pakënaqur! Dhe jo vetëm shqiptarë, padyshim! Qytetarë të kënaqur, si i thonë violinës sot! Dëgjo, interesinyë është që të dijmë të mbindërtojmë atë që e fituam ndihmuar Darkave të Mëdha



nase dhe angleze pikërisht nëpër ato darka (vetë)djegëse, Lindi!

Unë si një elektron që lëviz lirshëm e që vetëshkëputet orbitës periferike, fët e fët u vendosa në Gjithdimenzionin e Lirisë Akademike! Në UEJL! Botë oj botë, ujë o ujë! Si në "The shape of water" aty do gjëmonte liria e të mënduarit, konkurrenca e ideve, aty do debatohej për çështjet e Mëdha të Kohës që Transformohej, aty do merte kuptim dashnia për progres, do botoheshin revista shkencore, gazeta studentësh, do rrenditeshin gjeneratat që kishin start ku e ku më të lartë se starti i gjeneratës sime, do krijohej ai lloj kontuniteti që do ngriste kurbën e zhvillimit të mëndjes kritike e ekonomisë së larti! Oooo do bënimm...hatanë bre!

Dikur, tek jeta në Universitet ndërtohej mirë, pas ca kohëve unë shkrova një kolumnë! Kritikoja gjuhën e një ambasadori të BE këtu në Maqedoni! Ishte gjuhë subjektive e tij, e politizume fund e krye, aspak dinjitoze (edhe sot i qëndroj besnik mendimit tim të asaj kohe!)...U dynd udhëheqësia e Universitetit! "Ç'ishte ajo kolumnë, si guxon ajo të flasë në atë mënyrë, të

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok. 14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 12 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

vihet në masa dicipline!" - u çjerrën zërrash burrthat aty brenda! Hej, s'bënë burrthat asgjë më shumë përveçse e thyen një zë të lirë! Do gra aty, heshtën dhe miratuan! Kolumna ime u dogj mu si shtrigat në kohën e inkuizicionit! Oj nannnnn, ç'kuptim ka more gjithë kjo llakërdi!

Kolumnat u shpallën armiq të Universitetit!? Pfyyyyy, paj kjo i ngjan paradisë! Që atëherë, shpalla monologun e Madh! Indiferencë – e quajta! Pas largimit tim nga universiteti, dëgjoja një pas një si rrënoheshin kullat, si zbrisnin nga piramida e lirisë së mendimit e krijimit shumë miq (mikesha) të mij(a). U shpërdamë gjithandej! Honi i mjaltës u shpërbë, mjalta u hollu! Dhe kështu një Shoqëri e Hapur në tendencë, u mbyll! U "mbrojt" nga shtrigat!

Mir fort! Te misteri është fuqia, aty, te misteri! Po ç'mister se... , unë gjith mendoj se miti i Kulla e Rozafës asht pjesë e fantazisë së një populli që e ka të vështirë të ndërtojë sistemin, por a e kisha pas gabim? Në esence krizën e prodhojnë ata që dëshirojnë të anashkalojnë realitetin shqiptar në Maqedoni; janë vetëshqiptarët! Ne kemi telashe me projektin tonë për veten! Sepse kemi një temperament epik ndasish! Ashtu edhe në arsim, ashtu edhe në prumje të rreja! Universiteti i Evropës Juglindore është një shembull epik i lënies veten pasdore me vetëdorë!

Dëgjo, interesi ynë është të krijojmë shqiptarë të kënaqur e jo shqiptarë të pakënaqur! Dhe jo vetëm shqiptarë, padyshim! Qytetarë të kënaqur, si i thonë violinës sot! Dëgjo, interesi ynë është që të dijmë të mbindëtojmë atë që e fituam ndihmuar Darkave të Mëdha a! Dëgjo, interesi ynë është të artikulojmë veten përmes vizionit! Dëgjo, interesi ynë është që të pranojmë se i riu që vjen duhet të ketë start shumëfish më të mirë se sa starti yt! Dëgjo, interesi ynë është të themi se jemi të korruptuar fund e krye e se duhemi ç'korruptuar veten, prandaj sistemin! Dëgjo, interesi ynë është të themi se jemi shoqëri seksiste e maçoiste, prandaj s'ka asnjë grua konkurrenente në këtë garë Rektorit të Ri në UEJL!

Dëgjo, interesi ynë është që në këtë garë për Rektor të ri të Universitetit të Evropës Juglindore, të fitojë ai që është më gatshëm të krijojë unitetin akademik si synim dhe mendimin e lirë si atribut synimi, e jo më i miri...sepse s'ka si të kërkosh Më Të Mirin në një sistem që është (ç)ndërtuar nga njerëz me zemër Pule e jo Luani!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)



Politika e prangave

Nga
Enver ROBELLI



Dogan Akhanli është shkrimtar gjerman me origjinë turke. Vitin e kaluar ai udhëtoi nga Gjermania në Spanjë - për pushime. Aterroi në qytetin e Granadës dhe bashkë me partneren e tij, një turke me pasaportë gjermane, vendosën të ecnin gjurmëve të poetit Federico García Lorca, të cilin e vranë falangat fashiste më 19 gusht 1936. Krimi ndodhi jo larg Granadës dhe varri i Lorcës nuk është gjetur ende. Dogan Akhanli u arrestua nga policia spanjolle po ashtu më 19 gusht - në përvjetorin e vrasjes së poetit spanjoll. Akhanli u arrestua me kërkesë të Turqisë, të proceduar përmes Interpolit. Autoritetet turke pretendojnë se Akhanli ka qenë pjesë e një grupi të majtë terrorist, i cili para 27 vjetsh kishte kryer një sulm për grabitje.

Fati i Dogan Akhanli ishte shtetësia e tij gjermane. Pas arrestimit menjëherë u angazhua Ambasada e Gjermanisë dhe autori u lirua nga burgu, por që i detyruar të presë dy muaj në Madrid derisa të merrej vendimi për apo kundër ekstradimit të tij në Turqi. Drejtësia spanjolle vendosi kundër ekstradimit. Koha e kaluar në Spanjë, mes frikës se do t'i dorëzohej autoriteteve turke, shpresës se do të shpëtonte falë angazhimit të Gjermanisë dhe bindjes se drejtësia spanjolle do të injoronte kërkesën turke, i shërbeu Dogan Akhanli për të shkruar një libër, i cili është botuar këto ditë. "Arrestim në Granadë ose a po rrëshqet Turqia në diktaturë?" ("Verhaftung in Granada oder Treibt die Türkei in die Diktatur?", botoi: Kiepenheuer & Witsch).

Libri përshkruan jetën e Dogan Akhanli, e cila është e pashkëputshme me Turqinë e dekadave të fundit. Ai u arrestua për herë të parë në vitin 1975, sepse kishte blerë një gazetë majtiste. Më vonë u arrestua prapë për

shkak se iu bashkua Partisë Revolucionare Komuniste (e cila ishte ilegale). Pas puçit ushtarak në Turqi në vitin 1980 Akhanli kaloi në ilegalitet. Regjimi ushtarak arrestoi mbi 100 mijë turq nën akuzën se janë majtistë. Për të luftuar majtistët ushtria i dha hapësirë më të madhe fesë në jetën publike. Kur thuhet sot se ushtria turke ka qenë përherë mbrojtëse e kemalizmit, i cili si ideologji insistonte në ndarjen e fesë nga shteti, kjo nuk vlen së paku për grushtin e shtetit të vitit 1980. Dogan Akhanli jeton prej vitesh në Gjermani. Si shtetas gjerman ai mund t'i lejojë vetes të ushtrojë kritikë ndaj qeverisë në Ankara dhe presidentit Rexhep Taip Erdoan. Lideri turk është tepër i ndjeshëm ndaj kritikës. Dhe për t'i kapur kritikët e tij nuk zgjedh mjete. Këtu hyn edhe përdorimi dhe keqpërdorimi i fletarresteve të Interpolit. Dogan Akhanli nuk është i vetmi që kërkohet nga Turqia. Nën akuzën shpesh paushalle se janë mëshitetës të Lëvizjes së Fetullah Cylenit e ashtuquajtura drejtësi turke kërkon shumë turq me banim në botën e jashtme - sidomos në Evropën Perëndimore. Por në shënjestër janë edhe politikanë kurdë. Më 25 shkurt në Pragë u arrestua Salih Muslim, politikan i kurdëve të Sirisë. Edhe në rastin e tij bëhet fjalë për keqpërdorim të Interpolit për të prangosur kundërshtarë politikë. Salih Muslim kishte ardhur në Pragë për të marrë pjesë në një konferencë mbi situatën e kurdëve në Siri dhe aksionin e forcave turke kundër qytetit Afrin, i cili kontrollohet nga kryengritësit kurdë. Në vitin 2013 vetë Erdoan e kishte pritur në Ankara Salih Muslimin. Tani, pas ndalimit të tij në Pragë, Erdoan tha: "Shpresa jonë është se Çekia - dhashtë zoti - do t'ia dorëzojë Turqisë". Shumica e shteteve evropiane (sidomos ato anëtare të BE-së) hedhin poshtë ekstradimet në Tur-

qi për shkak të kontrollit politik të drejtësisë. Njëjtë (dhe guximshëm) kanë vepruar edhe qeveritë e Kosovës dhe Shqipërisë ndaj kërkesave turke për ekstradim e shtetasve turq. Kjo ka zemëruar disa diplomatë turq. Në bisedë me gazetarë perëndimorë ata thonë se institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë janë të infilttruara nga "gylenistët". Dëshmi për këtë akuzë diplomatët turq nuk kanë, por në kohën e tensionimit të përhershëm të situatës faktet harrohen nga pala turke.

Me rëndësi është loja me emocione dhe akuzat tërësisht të papranueshme ndaj vendeve që tradicionalisht kanë raporte të mira me Turqinë. Për shembull: Rexhep Taip Erdoani i ka kërcënuar me një "flakësh osman" ushtarët amerikanë nëse ata edhe më tutje i përkrahin luftëtarët kurdë në Siri. Politikanët gjermanë kryetari turk disa herë i ka krahasuar me "nazistët" për shkak se ata kanë propozuar ndërprerjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Holandezët Erdoan i ka akuzuar se kanë "karakter të poshtër", ngase patën ndaluar pjesëmarrjen e ministrave turq në tubime elektorale me komunitetin turk në Holandë. Gjermania dhe Holanda, sipas tij, janë "shtete banditësh". Dogan Akhanli i ka shpëtuar ekstradimit në Turqi. Do të ishte befasi e madhe nëse Çekia do të vepronte ndryshe në rastin e politikanit kurd nga Siria, Salih Muslim. Por në Çeki mund të ndodhin edhe gjëra të papritura, sepse në Pragë nuk është më president një disident si Valcav Haveli, por Milosh Zemani, një urrejts i BE-së, mik i Vladimir Putin dhe përbuzës i drejtësisë. Kryeministër është një i dyshuar për korrupsion. Ndërsa njëri nga liderët e opozitës Tomio Okamura, gjysmë çek, gjysmë japonez, është shquar për deklarata ksenofobe. (koha.net)

Si po e keqpërdor Turqia Interpolin për të ndjekur kritikët e presidentit Erdoan



“TAKIMET POETIKE TË KARADAKUT”

PROMOVIME DHE MIRËNJOHJE

Çmimi “Fadil Bektashi” iu nda tre poetëve më të suksesshëm, konkretisht vendi i parë poetes nga Shqipëria, Majlinda Nana-Rama, poezinë “Vajzës së palindur” vendi i dytë poetit nga Kosova, Fehmi Ajvazi për poezinë “Hiri mbi gjakun e shenjtë”, dhe vendi i tretë poetit nga Kumanova, Nazmi Beqiri për poezinë “Eh Promethe”.

Kumanovë/Likovë - Të dielën më 11 mars 2018, u mbledhën poetë, shkrimtarë, dashamirë të artit e kulturës shqiptare nga të gjitha hapësirat shqiptare, për të marrë pjesë në edicionin e XXVI të manifestimit tradicional “Takimet Poetike të Karadakut”.

Së pari në Qendrën e Kulturës në Kumanovë, u promovuan botimet e fundit të klubit, përkatësisht: monografia: “Klubi i Shkrimtarëve JEHONA KARADAKUT – Një çerekshkull”; Revista “Doruntina” nr.52/53; “Rrethi që pret përjetësinë” - roman i Bejtush Memetit; “Psherëtima të pakënduara” - përmbledhje poetike nga Arben Ibrahim, dhe “Kurorë” nga Fatos Rushiti.

Kryetari i klubit dhe një nga përpiluesit e monografisë, Sevdail Demiri, tha se shpresojmë që me këtë botim kemi hedhur një hap drejt arkivimit të një veprimtarie të rëndësishme çerekshkullore të sferës së kulturës kumanovare dhe mbarëshqiptare. “Tani jemi pak më të qetë, kur e dimë që një pjesë e madhe e kujtesës sonë, ruhet brenda këtyre kopertinave, dhe do t’u mbetet një trashëgimi e pasur gjeneratave të ardhshme”, tha ai. Rreth botimeve tjera, përpos autorëve, folën edhe recensentët Burhanedin Xhemali, Bejtush Memeti, Kalosh Çeliku e Arben Ibrahim, të cilët vlerësuan lartë arritjet



estetike në këto vepra të letërsisë bashkëkohore.

Ndërkohë, karvani i shkrimtarëve vizitoi edhe varrezat e dëshmorëve të kombit në Sllupçan e Hotël, duke marrë impresione nga vepra heroike e luftëtarëve dhe dëshmorëve të përndritjes.

Gjatë mbrëmjes, në Likovë u mbajt Ora e madhe letrare në kuadër të manifestimit “Takimet Poetike të Karadakut - 2018”. Me prezencën e tyre, manifestimin e nderuan kryetari i Komunës së Likovës, Erkan Arifi, sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri dhe shumë veprimtarë tjerë. Kryetari Arifi shprehu mirënjohje për punën e pandalshme të klubit, dhe gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit edhe në aspekt të sigurimit të kushteve më të mira për punë dhe aktivitete, duke ndarë një hapësirë brenda Shtëpisë së Kulturës në Mateç.

Sekretari shtetëror i Ministrisë së Kulturës, Valmir Aziri, tha se duke marrë parasysh traditën e gjatë, punën dhe veprimtarinë se-

riozë të këtij klubi, Ministria sivjet i ka përkrahur katër projekte me të cilët është konkurruar, në mesin e të cilëve edhe ky manifestim. “Shpresojmë dhe besojmë që në të ardhmen edhe më tepër të kontribuojmë bashkë për zhvillimin e artit dhe kulturës shqiptare”, theksoi Aziri. Më tej, nën drejtimin e Fatos Rushitit, rrodhën vargjet poetike të poetëve pjesëmarrës në konkursin e shpallur muaj më parë. Me poezitë e tyre u paraqitën: Agim Bajrami, Fehmi Ajvazi, Agim Xheka, Majlinda Nana-Rama, Ejup Ajdini, Nexhat Rexha, Rozafa Shpuza, Nazmi Beqiri, Daim Iljazi, Faruk Buzhala, Vlladimir Muça, Mirela Papuçiu, Ekrem Ajruli, Arsim Halili, Bilall Maliqi, Rrahim Ganiu, Sinan Sadiku, Adem Abdullahu, Arben Rashkaj, Arlind Farizi, Sejdi Gashi, Kreshnik Sopaj, Nadire Ismaili, Arsim Jonuzi, Nertila Pitarka, Liridon Ademi, Elma Rexhepi, dhe poetë të tjerë që lexuan jashtë konkurrimit.

Në emër të jurisë letrare, Sunaj Raimi, tha se sivjet për herë të

parë është vendosur kriteri i konkurrimit, ku pati afër 100 aplikime, nga të cilët u përzgjedhën 40 poetë. Prej tyre, Çmimi “Fadil Bektashi” iu nda tre poetëve më të suksesshëm, konkretisht Vendi i parë poetes nga Fieri i Shqipërisë Majlinda Nana-Rama, vendi i dytë poetit nga Kosova, Fehmi Ajvazi, dhe vendi i tretë poetit nga Kumanova, Nazmi Beqiri.

Ndryshe, Klubi i Shkrimtarëve “Jehona e Karadakut” nga Kumanova, është nga të parat shoqata joqeveritare shqiptare në Maqedoni, e cila pandërprerë po funksionon tani e 26 vjet me radhë. Kryetari i klubit ishte shkrimtari Fadil Bektashi, për të renditur më pas një varg veprash dhe suksesesh. Që në vitin 1992, u botua edhe revista e parë e pavarur shqiptare në Maqedoni për letërsi, shkencë dhe kulturë “Doruntina”, dhe nisi rrugën manifestimi tradicional letrar “Takimet Poetike të Karadakut”, i cili nga viti në vit po krijon një reputacion të respektuar në komunitetin tonë kulturor.



MALLI PËR VENDLINDJEN !

Vitet kaluan sikur drita shpejtë,
edhe pakë muaj po bëhen tridhjetë!
Nga ajo natë e zezë që kur u
ndamë,
nënëlokja ime kurrë më s'u pamë!
Malli për ty kurrë nuk mështë
shuar,
për të parë në sy për të përqaftuar!
Në ëndërr të erdha e shkela
sokakut,
vetem ta degjoja Jehonën e Kara-
dakut!
Jehonte Jehona në lagjen me trima,
ku leshova shtat me bukë e thërri-
ma!
Kur u rrita unë ti pikoje gjak,
kuçedra e kuqe po leshonte flakë!
Gjuha e bukur shipe daten po i kall-
te,
shkollat tona t'pakta vendosi ti
ndalte!
Me muaj me vite për pushim nuk
dita,
përkrahje pakë pata e tepër shumë
prita*!
Dola në mërgim për tu kthyer sh-
pejtë,
shumë u tmerrova zemra m'u thy
krejtë!
Cilët para kombit nxorrën ide-
logjinë,
shkelën mbi gjak e zgjatën skllavë-
rinë!
Jeho Jehonë Mali nga majë e Lubo-
tenit,
më sjell edhe mua në Log të Kuvendit!
Ti derdhë këto vargje si burim i ma-
lit,
djali yt Kumanovë sa më ka marr
malli!

Ahmet Asani Cyrih, 20.02.2018

(*shumë prita- shumë kurthe)
Poezia e cila është dashur të pre-
zantohet në manifestimin letrar
“TAKIMET POETIKE TË KARA-
DAKUT” në Kumanovë, të mbajtur
më 11 mars 2018

“KARNEVALET ILIRE” NË BOZOVÇËN E SHARRIT

Trashëgimia kulturore shqiptare, qoftë e shkruar apo e përcjellur brez pas brezi, në viset shqiptare po shfaqet në një frymë të re, madje me organizime dinjitoze. Kështu sot, në fshatin Bozovcë të Tetovës, shumë malësorë të zbritur në rrafsh për një jetë më të mirë, madje edhe të shpërndarë rrugëve të mërgimit, u ngjiten shpatijeve të Sharrit, te burimet e tyre. Ata organizuan Karnevalet ilire, festë kjo me traditë tremijë vjeçare, ku bashkë me malësorët ishin edhe shumë mysafirë të trojeve shqiptare. Në mesin e tyre,



si zakonisht ishte edhe filantropi dhe biznesmeni i madh Lazim Destani, i cili ndau gezimin me bashkëfshatarët në një atmosferë

shumë emocionale. Kjo festë shekullore, me originalitetin e saj, me malësorë të veshur me lëkura delesh dhe me instrumen-



te muzikore tradicionale, bëri që sharrin të jehojë fuqishëm, ashtu si në të kaluarën, ku mendohej së kështu largohen të ligat nga fshati dhe fillon mbarë vera e re. Festës ia shtuan madhësinë

shumë pamje interesante, por edhe takimet e bashkëfshatarëve mes vete, duke ia dhënë ngjyrën ashtu si e kishte ndër shekuj, Sharrin shqiptar. (FTASHOLLI)

MIRËNJOHJE PËR DËSHIRA AHMETI KËRLIU



Sopranoja shqiptare me famë ndërkombëtare, Dëshira Ahmeti Kërliu, është vlerësuar me çmimin "Gruaja e Vitit" nga organizata e gruas "Zëri Ynë" me seli në Nju Jork

"GRUAJA E VITIT"

Organizata e gruas shqiptare në Amerikë - "Zëri Ynë" me seli në Nju Jork të Amerikës ka shpallur "Grua e Vitit" soprano shqiptare me famë ndërkombëtare, Dëshira Ahmeti Kërliu. Ceremonia e ndarjes së çmimit prestigjioz u zhvillua në mjediset e Catering Hall "Grand Marquis" në Nju Xhersi, ku qindra gra shqiptare u mbledhën së bashku për të festuar ditën ndërkombëtare të gruas - 8 Marsin.

"Artist nuk bëhesh, por lind dhe këto dhunti nëse i zhvillon me vullnet dhe dëshirë, patjetër që

një ditë do të arrish atje ku duhet. Karriera ime nuk ka qenë e lehtë, ajo ka qenë me mundime, vështirësi, por dhe plot kënaqësi. Jam e nderuar që jam sopranoja e parë shqiptare në teatrin e Shkupit të Maqedonisë dhe kam dhënë koncerte në disa skena në Europë dhe në Amerikë. Në Nju Jork do të vlerësoja koncertin me divën botërore të artit Inva Mula, si dhe me artistë shqiptare, koncert qe e realizuam vitin e kaluar ne Manhattan", është shprehur Dëshira në këtë ceremoni. Ajo ka informuar gjithashtu se së shpej-

ti, në muajin maj, në Manhattan do të realizohet koncerti i radhës me artistin virtuoz botëror Shkelzen Doli, ndërsa ka thënë se kjo e bën të ndjehet krenare.

Në fjalimin e saj, Dëshira me emocione solli dashurinë e ngrohtë të familjes së saj që e rritën dhe e edukuan në Dibër, por veçanërisht ajo falënderoi gjyshen që e mori qysh si fëmijë në gjirin e saj, pasi mamaja i kishte vdekur në moshë shumë të re. Gjyshja e Dëshirës, Nënë Çeka siç e thërrasin të gjithë, ishte një nënë fisnike, flokët e bardha të saj si bora e bje-

shkëve ndrinin ashtu si sytë e saj që shkëlqenin nga gëzimi i madh kur dëgjonte fjalë miradie nga miqësia, shoqëria, por sidomos mirënjohjen që i shprehte mbesa para publikut. Në ndërkohë, organizata e gruas shqiptare "Zëri Ynë" me presidenten znj. Leunora Abdulai, me këtë rast zhvilluan aktivitetin për të festuar këtë ditë të rëndësishme në jetën e gruas. Abdulai uroi të gjitha zonjave dhe zonjushave mirëseardhjen dhe iu uroi atyre gëzuar festat e marsit, ndërsa tha se është bukur që mbledhemi së bashku dhe festojmë festat tona të bukura shqiptare.

Në emër të kryesisë, ajo vlerësoi punën e palodhshme të artistes së shquar të kombit, soprano e mirënjohur Dëshira Ahmeti Kërliu, si dhe disa grave iu dha nga një buqetë me lule në shenjë mirënjohjeje. Znj. Abdulai tha se Dëshira Ahmeti Kërliu "është një artiste e shquar dhe ne ndihemi krenar si organizatë dhe si gra shqiptare".



Koreshi, mjeshtri që e lëmoi dhe estetizoi fjalën

Sadik Bejko

...Rrjedha e meditacionit, toni prej urtaku, strukturat e imta të sekuencave rrëfimore si në teknikën e skenarit, thyerjet e narracionit, ndërthurja e kohëve, iluzionit i një përmase të së lashtës që vjen dhe përthyen të sotmen, duke e bluar atë përbrenda saj, sa të thuash se kohët kanë ngrirë në njëra-tjetrën, për sot dhe në vazhdimësi, e bëjnë disi të veçantë romanin "Një grua me të verdha në pyllin e Budhas". V. Koreshi në vitet e fundit e dominoi prozën me përmasën e stilistit, e sofistikoji atë. Nëse te "Ulku dhe Uili", rrëfimi merret ngjyrat gjuhës së librave e të legjendave biblike, te "Një grua me të verdha..." ndihet shija e urtësive lindore, e transmigrimit budist. Kjo letërsi e ardhur kështu te një shkallë e dytë (term i G. Genete) përforcohej dhe me atë çka thamë më lart: një velaturë lirizmi me të cilën Koreshi i mveshte pamjet e vrazhdëta të jetës. Kjo është një veçori e stilit të tij: estetizimi gjuhësor (Ulku dhe Uili), simbolika dhe meditacioni përmbi narracionin epik (Një grua me të verdha...). Koreshi solli risi në formën dhe në përmbajtjen e romaneve të tij. Nuk e dimë se sa këto prire për universalitet dhe për një gjuhë më të përpunuar përkonin me atë konkretësi të figurës që kërkonte domosdo tekstura e skenareve të tij. Ai nuk i ndau nga dora të dyja: prozën dhe skenarin. Te ne ai ishte profesori i skenaristëve. Do të jemi të dëshiruar, tani që na la, për një prozë të ashpërsisë së shpallur si te novela "Dasma e Sakos". Për një përkorje të fantastikes. Kjo novelë, një nga më të realizuarat e tij, përtej asaj që ka thënë kritika jonë për të, në thellësinë e saj sjell shpërftyrimin njerëzor si prodhim i mërziisë dhe i shterpësisë provinciale (A. Zoto). Në skenarin për film kësaj lënde i dha fekëstima të tjera: në një vend të braktisur nga zoti e nga ligji mbizotërojnë agallarët e vegjël dhe shterpë që shpërftyrojnë e marrin nëpërkëmbë çdo vlerë e shije të jetës. Koreshi vazhdoi të jetë deri në fundin jetës shkrimtari që estetizoi e lëmoi fjalën me merakun e mjeshtrit të lashtë. Ai nuk kishte hije tjetër veç atë të mjeshtrit të urtë. Nuk do t'i uroja asgjë më të mirë një shkrimtari. Deri në fund të jetës u ngjit gjer në arritjet më të mira të fjalës së shkruar.

DITARI INTIM I LASGUSH PORADËCIT



Tiranë, e Djelë 2 Korrik 1939: Ora 8.5', mëngjes u nisa për Durrës, ora 9.30' vajta ne Nafija. Pas drekës ora 2 u shtriva në shtrat (larg dritares), Nafija më ndjenji mbanë shtratit, pastaj ra në shtrat me mua (më të djathtën t'ime) dhe u pushtuam ashtu një hof: unë i-a hodha krahun nënë qafë, ajo e futi kokën në gjirin t'im; kur u sguam e mora në kraha, i-a skuqa faqat së puthuri dhe lëpiri gushën, sytë me 100 përkëdhelje. Më 6-8 baritmë anës detit përkrah.

Në shtrat më lëçiti 3 vjersha të saj, pas darkës fjeti në shtratin t'im, u sguam më 11 para me-

snatës, biseduam pak, pastaj fjetmë. Më 6 korrik, E Enten, më 7.30' të mëngjesit ardhni Nafija në dhomën t'ime. Më shkroi: "shpirtin t'ënd" = "Nafijen", "shpirti im" = "Lasgushi". Më 3 u nismë, më 4.10' harimë në Durrës. Më 5.40' filluam, më 6.10' mbaruam celebrimin e martesës në Bashki. Kur u kthyem në shtëpi të Nafijes i vura në gisht unaskën me brilant prej floriri të bardhë. Natën 6 dyke u gëdhirë më 7 Nafija m'a futi dorën në gjë.

I vura byzylykun prej ari. Dëshira t'i-a fut edhe unë dorën, nuk më la, u zemërova. Passi shkoj të fletë, ardhni 5 herë në dhomën t'i-


me që të më pajtojë, më në fund ardhni fjetmë bashkë, më 3 pas mesnate më tha se kish turp prandaj s'ma dorën. Fjetmë pa bashkim trupor.

Më 7 Korrik, të Premten, ora 1.30'-4.30', u shtrimë në shtrat bashkë, pa bashkim trupor. Ezhveshi gjirin me turp të math. Gjiri i saj një parajsë vajzërore, mezi ka zënë të fryhet, cickat s'kanë maja. U përkëdhelëm me 1000 mënyra: "Puthmë dhe këtu" theshte, "edhe këtu"; "bëmë një vurratë këtu (në llërën lart) dhe këtu, edhe një, edhe një. Ora 5.30. qau, qava. Më 7 Korrik, ora 8.30' baritmë, ndenjmë në lulishte. Më 6

Korrik ora 6.30-9.30 ndenjmë në lulishte.

Më 7 Korrik natën dyke u gdhirë më 8 fjetmë bashkë, me bashkim trupor, pa bashkim virgjëror. Nafija përkëdheltesha shumë, çuditesha për të gjitha, s'dinte, e mora prej shtratit në divan, vura llambën, në këtë natë sbathi me turp të math dhe breçkat: trupi i saj një bukuri për t'u çmëndur, i bie erë shumë të mirë, u puthmë, gojë e trup me 1000 mënyra. Më tre pas mesnate, u sguam dhe u përkëdhelëm (të zhveshur) me 1000 mënyra. Më ora 6 fjetmë pak të lodhur.

Lindi me 2 nëntor 1911, në Iraklio të Kretës. Prindërit e tij nga Mitilini, e transferojnë fabrikën e tyre në Pire dhe banojnë në Athinë. Odisea Elitis, ndjek shkollën e mesme dhe është adhures i Egjeut. Bie në kontakt me poezinë e Kavafisit dhe shfaq preferencat letrare. Zbulon surrealizmin e poezise franceze, lexon Elyarin dhe Lorkën. Në Universitetin filozofik të Athinës shkruan poezitë e para. Më 1935 boton me pseudonimin Elitis, pasi emri i tij i vërtetë është Odiseas Alepudhelis. Njihet me Seferisin, Empirikon, Karandonisin, Gacosin. Përkthen Elyarin. Më 1937 është oficer rezervist në Korfuz. Boton "Klepsidrat e së panjohurës" dhe "Sporades". Më 1938 shkruan "Marina e shkëmbinjëve", "Mosha e kujtimit të kaltërt" dhe "Kthjelltesitë". Më 1939, botohen "Orientimet" dhe njihet me Henri Mylerin. Më 1940, poezitë e tij botohen në frëngjisht. Në luftën Italo-Greke, merr pjesë si nëntoger në luftimet në Sarandë, Delvinë, Kuç, Kallarët, Bolenë, Nivicë, Shën Vasil. Kthehet në spitalin e Athinës pothuaj i vdekur nga tifoja. Më 1943 botohet "Dielli i parë". Më 1945, "Kënga heroike dhe e përzishme për nëntogërin e rënë në Shqipëri. Në Francë botohet vëllimi i tij i zgjedhur poetik. Takohet me Elyarin në vitin 1948, stabilizohet në Paris, ku njihet me personalitete të rëndësishëm si: Pikaso, Terianti, Legeri dhe Shagalli. Udhëton në Spanjë. Në Londër është bashkëpunëtor i BBC-së dhe shkruan versionin e parë të kryeveprës "Aksion Esti". Në Itali njihet me Ungaretin dhe Mario Vitin dhe i përkthejnë poezitë. Në Athinë punon me radiofoninë, por largohet shpejt. Më 1955 shkruan "Gjashtë dhe një goditje për qiellin". Përkthehet në anglisht dhe në gjermanisht, kurse vetë përkthen Brehtin. Versioni i plotë përfundimtar i kryeveprës "Aksion esti" botohet në vitin 1959 dhe më 1960 merr çmimin e parë shtetëror të poezisë. Udhëton në USA, dhe në Bashkimin Sovjetik, ku takohet me Jevtushenkon. Shkruan esse për vëllimi "Letra të hapura". Më 1969, gjatë puçit të kolonelëve largohet prapë për në Paris. Dhe për disa muaj në Qipro. Shkruan "Druri i dritës". Mohon çmimin që i akordojnë kolonelët. Nuk pranon të bëhet akademik. "Aksion esti" qarkullon edhe në USA. Botohet "Maria Nefeli". Në dhjetor të viti 1979, fiton çmimin "Nobel". Vepra e Elitis përkthehet në shumë gjuhë të botës. Mjaft nga poezitë e tij janë kompozuar nga Mikis Teodorakis. Ndërkohë ekspozohet veprimtaria e tij në pikturë dhe shpallet lektor nderi i shumë universiteteve: Athinës, Romës, etje. Përkthen në greqishten e re Safon, "Apokalipsin" Do të vijë njëri pas tjetrit vëllimet poetike: "Monogram", "Retë e dashurisë", "Lundërtari i vogël", "Udhë vetjake", "Elegjitë e Oksopetras", "Perëndimi i pikëllimit". Vëllimi i fundit poetik "Kënga e mjelmës" u botua para vdekjes.



ODISSEAS ELITIS

Monogram

(fragment poeme)

*Jemi ende herët në këtë botë, a më dëgjon
përbindshat ende s'janë zbutur, a më dëgjon
Gjaku im i humbur e i tretur, a më dëgjon
e thika si dashi i sulet qiejve
dhe yjet i këput prej degëve, a më dëgjon
jam unë, a më dëgjon
të dua, a më dëgjon
të marr për dore, të prij me vellon
e bardhë nusërore të Ofelisë e të vesh, a më dëgjon
Pse po më le, ku po shkon, a më dëgjon
kush do të mbajë përdorë atje mes përmbytjesh
lianet gjigande a llava e vullkaneve,
Ka për të ardhur dita, a më dëgjon
që do të na varrosin, e mbas mijra vitesh,
s'do të jemi veç gurë vezullues, a më dëgjon
ku bluhet shpërfillja njerzore, a më dëgjon
dhe ashtu mijra copash do na hedhin, a më dëgjon
ndër ujra një e nga një, a më dëgjon
t'i numëroj zajat e mia të hidhura, a më dëgjon
pse koha është një kishë e madhe, a më dëgjon
ku ikonat e Shenjtorëve, a më dëgjon
nganjëherë
qajnë edhe me lot të vërtetë, a më dëgjon
kambanat përhapin lartësive, a më dëgjon
një shteg të thellë e më lenë të kaloj, a më dëgjon
engjëjt më presin me qirinj e psallme vdekjesh,
po unë s'largohem së këndejmi, a më dëgjon
O të dy bashkë, o asnjëri prej nesh, a më dëgjon
cilën lule stuhish a dashurie, a më dëgjon
njëherë e përgjithmonë do ta këpusim, a më dëgjon
të mos mundet kurrë më ajo të lulëzojë, a më dëgjon*

*mbi të tjera planete o tjera yjësi, a më dëgjon
s'do të jetë më toka e as era s'do të jetë më dëgjon
s'do të jetë më toka, e as era s'do të jetë më
e njejtë që e do ta prekim ne të dy, a më dëgjon
dhe as ai kopshtari që ia doli mbanë, a më dëgjon
prej dimrash e prej ngricash të vështira, a më dëgjon
shpërtheu një lule, dhe jemi veç ne, a më dëgjon
me një vullnet të vetëm: dashurinë, a më dëgjon
krejt një ishull në kambë e çojmë, a më dëgjon
me shpellat, me gjiret dhe shkambinjët
plot lule, a i dëgjon, a i dëgjon
Dikush u flet ujrave e dikush tjetër qan, a e dëgjon
dikush kërkon dikë e dikush ulërin, a e dëgjon
unë jam ai që ulëras, unë jam ai që qaj, a më dëgjon
Të duya, të dua, të duaaaaaaa. A më dëgjon!!!*

Përktheu: Jozef RADI

(Fragment nga Orioni)


*larguen sytë... po shpirtrat tanë
i vazhduen diku në qiell takimet e tyne,
iu ndriste ai çast'i kthjellët
ai vezullim drithërues
pasqyrë besnike e ndjenjave tona,
diku ma nalt
n'at vetmi bashkuese t'yjeve të saj
mbreton Qetsia...
E pse u dashka çlirue prej trupave tonë
pse u dashka boshatisë prej shpresave tona
pse u dashka vù në diskutim lideja jonë
ripërtritje ndjenjash...*

(përktheu nga Jozef Radi – 2012)

Një nga udhëtimet më mbresëlënëse të Floberit ishte ai drejt Egjiptit dhe Orientit që ndërmori bashkë me mikun e tij, shkrimtarin Maxim du Camp. Floberi kishte studiuar për Drejtësi, ndërsa Du Camp për Mjekësi. Ai e çmonte shumë mikun e tij. "Floberi lexonte shumë shkruante ai, – dhe kishte një kujtesë të jashtëzakonshme. I ngjante një fjalori të gjallë".

Ata u nisën në fund të tetorit të vitit 1849, ku në Kajron e Mehmet Aliut qëndruan gjatë tetë muajve. Arnautët e thërrisnin "Abu sherrep", që do të thoshte "babai me mustaqe", pasi Floberi i shëndoshë tregon-te i madh në moshë. Në Kajro vizituan dhe pallatet e vezirit të lavdishëm. Arnautët ishin ngado, pasi ata ishin pjesa më luftarake e gardës së Mehmet Aliut. I gjeje ata në portat e qytetit dhe sheshet kryesore, siç i shohim të pikturuar dhe në shumë nga tablotë e Leon Gerôme, i cili disa herë e vizitoi Kajron në këtë periudhë. Në letrën që i dërgonte doktorit Jules Cloquet nga Kajro, ai shkruante se këtu "njëherësh sheh popin grek, arnautin me një xhakëtë të qëndisur, koptin me një turban të zi apo beduinin e shkretëtirës të veshur me të bardha dhe me fytyrën e tij ngjyrë kafeje që ecën ngadalë"... Por Floberi dhe Du Camp do të zbrisnin drejt Nilit për të parë Karnakun dhe Luksorin; ai e rrojti kokën dhe u vesh si arab. Në jug, ata ndaluan dhe në Esneh, i njohur atëherë për prostitutat e famshme që ishin mbledhur atje, meqë Mehmet Ali Pasha i kishte dëbuar ato nga qytetet e Kajros dhe të Aleksandrisë, që ta ruante kryeqytetin nga shturja. Dihet që një nga imazhet më ekzotike të Egjiptit në atë kohë, veç piramidave dhe tempujve të vjetër të faraonëve, ishin dhe valltaret e kafeneve dhe mejhaneve, të cilat në gjuhën arabe quheshin "almée", pra "a'ualem" që donte të thoshte "e ditur", pasi ato luanin një valle në strip-tiz. Ishin valltare dhe prostituta, të cilat me një dekret të posaçëm, ishin degdisur përgjatë Nilit, drejt Egjiptit të Sipërm, pra drejt qytezave në mes të shkretëtirës, tutje drejt Karnakut, Beni Suef, Esnah etj. Do të ishte vërtet një skenë e mahnitshme filmi përzënia e valltareve të bukura dhe dëbimi nga qytetet e tyre të dashura e plot klientë perëndimorë. E megjithatë, "almée"-të, herë arabe, herë kirkize, armene etj., nuk e kishin humbur gëzimin e jetës dhe nuk kishin rënë në dëshpërimin pa fund. Ato përsëri do të kërcenin dhe shpesh nëpër kafene, spektatorë dhe klientë të tyre do të ishin dhe ata arnautë të ashpër dhe të pafjalë që ishin bërë zotër të Nilit dhe të shkretëtirës.

Më 1 dhjetor 1849, Flober i shkruante mikut të tij, Louis Bouilhet: "Pardje ishim te një grua që na solli dy femra për t'i pasur në shtrat. E bëra atë punë mbi një cohë, ku më parë kishin qenë disa mace, një e bërë e çuditshme, pasi shikonim njëri-tjetrin dhe s'flisnim. Vështrimi dyfishohej nga kureshtja dhe patak-sja. Por nuk bëra dhe aq qejf. Seksi i



FLOBERI

MES SHQIPTARËVE DHE PROSTITUTAVE

tyre ishte i rruar çka të krijonte një efekt të çuditshëm. Por megjithatë, mishin e kishin të fortë, si bronz. Ajo imja kishte vithe të mrekullueshme..." Dy francezët shkruanin çdo ditë në ditarët e tyre përshtypjet e udhëtimit. Du Camp kishte shënuar se «pamja e një shqiptari bënte të zhdrukeshin të gjithë nga Nubia». Në Luksor, Floberi shkruante për arnautët:

"Esneh. E mërkurë 6 mars. Mërrimë në orën 9 të mëngjesit. Qyteti është me shtëpi prej balte, si gjithë qytetet e tjera. Në shesh, një kafene me arnautë... Madje një arnaut përpiket të ngjitet me gjithë kalin në një shkallare". Pikërisht në Esneh, në një han, ata kishin qenë të pranishëm në vallet e këtyre prostitutave që i quanin «almé» apo «ghaëazie», ku mes tyre ishte dhe Safiah, ish e dashura e Abaz Pashës, djalit të Mehmet Aliut, si dhe e famshmja Kuçuk-Hanëmi, (apo ndryshe princesha e vogël), trupat e të cilave ishin me tatuazh dhe duart e krahët plot byzylykë. Vonë në mbrëmje, kur Kuçuk Hanëmi kërcëu "vallen e bletës", e cila përfundonte nudo, atyre që u binin veglave u mbylleshin sytë. Në një tablo të Gérôme, duken arnautët që ndjekin vallen e tyre. Ja si e përshkruan ai skenën kur kishin ndalur në shtëpinë e Kuçuk Hanëmit: "... Bashkë me delen e saj, Bambeh na prin duke shtyrë portën dhe ne hymë në një shtëpi me një oborr të vogël, ku përballë portës shquhen disa shkallë. Ballë nesh, në atë mjedis të rrethuar dhe nën një copë qielli blu, shfaqet një grua, me ca pantallona ngjyrë rozë e cila qëndron në këmbë, me torsin e saj të mbështjellë me një garzë në ngjyrë vjollcë të mbyllët. Sapo ka dalë nga banja dhe nga gusha e saj shpërndahet një aromë terrebentine... Ajo nis të na parfumojë duart me një lloj kolonje. Hyjmë në katin e parë dhe kthejmë në të majtë të shkallares, drejt një dhome katrore, të zbardhur me gëlqere ku

ka një divan, dy dritare, njëra që shikon nga malet dhe tjetra nga qyteti... Kuçuk hanëmi është një krijesë e gjatë, tepër e bukur dhe më e bardhë se arabet. Është nga Damasi dhe lëkura e saj, veçanërisht trupit, ka një ngjyrë të kafentë. Kur ulet, anash, në ije, i duken disa palë lëkurë në ngjyrë bronzi. Sytë i ka të zinj dhe të mëdhenj, qerpikët të zinj, flegrat e hundës të holla, supet të fuqishme dhe gjinjët e bëshme në formë molle. Mban një «tarbush» të gjerë në ngjyrë blu, e cila zbukurohet në majë nga një lloj disku në ngjyrë ari në majë të të cilit dallohet një gur jeshil që i ngjan një emerodi. Topthi i tarbushit të saj blu që është shpalosur si një freskore, zbret duke i përkëdhelur supet... Na pyet nëse duam të kënaqemi. Që në fillim Maksimi kërkon të kënaqet së pari me të dhe bashkë zbriten në sallonin poshtë në të majtë të hyrjes së oborrit. Pas zotit Du Camp ishte radha e zotit Flober. Pastaj erdhën muziktarët. Filluan të luajnë me një lloj violine të rrumbullakët me dy qime kali, e cila përfundon me një shufër hekuri që mbështetet në tokë... Kuçuk hanëmi dhe Bambeh nisën të kërcëjnë. Valja e Kuçukut është brutale dhe me goditje vithesh. Ajo e shtrëngon grykën me veshjen e saj në atë mënyrë që dy gjinjët lakuriq t'i afrohen dhe të ngjiten me njëri-tjetrin. Për të kërcyer, ajo vendos një lloj brezi të lidhur, një shall të errët me vija ngjyrë ari dhe tri xhufka të varura...

Tek Kuçuk hanëmi rivijmë një ditë tjetër. Katër gra të ulura radhazi në divan këndojnë. Zbres poshtë me Sofia Zungarah, një femër qejflie tepër e shkathët, si një tigër i vockël. Por e bëj pis divanin. Pastaj më vonë zbres poshtë edhe me Kuçuk hanëmin. Duke e puthur në shpatull, në dhëmbët e mia ndiej gjerdanin e saj të rrumbullakët. Seksi i saj me lapra në ngjyrë veluri më bëri të shkrihem fare dhe të

përlyhem. E ndjeva veten si një përbindësh. Kuçuku na kërcëu «vallen e bletës». Ajo u zhvesh duke kërcyer dhe ashtu lakuriq mbante veç një copë lecke. Në fakt, kërcëu për pak kohë dhe nuk donte t'i harxhojë forcat në këtë valle. Pastaj me Kuçukun ramë të flinim. Donte të rrinte në cep të shtratit. Trupi i saj ishte me djersë, meqë kishte kërcyer. Kishte ftohtë. Pas një përpëlitje, bëmë dhe një seks tjetër. Pastaj ajo fjeti me dorën e saj në timen, me gishtërinjtë e futur ndër të miat. Gërhi-ste... Në orën 2 e treçerek të natës ajo u zgjua dhe përsëri bëmë seks. Gjithë ngrohtësi shtrëngonim duart. Mendoj se të paktën ne duheshim". Në një letër që Floberi i dërgonte mikut të tij, Louis Bouilhet më 13 mars 1850, nga brigjet e Nilit, për Kuçuk hanëmin ai shtonte: «E thitha atë gjithë tërbim: trupi i saj ishte me djersë. Ishte e lodhur nga kërcimi i gjatë. Kishte ftohtë. E mbulo-va me peliçen time dhe ajo fjeti me gishtërinjtë në duart e mia. Sa për mua, as që vura gjumë në sy. E kalova natën me ëndrra të pafund...» Por aventura me arnautët nuk do të mbaronte këtu. Floberi do të pikëtahej përsëri me ata në Jerusalem, siç shkruan ai në ditarin e tij, më 11 gusht 1850. "Kohë më kohë ndonjë arnaut i armatosur duket që zbret në rrugët e tatëpjeta dhe bosh". Më pas ata nisen drejt Jeriko-s, siç shkruante Du Camp: "Në një fortesë të hallakatur u pritëm nga Muhamet Aga. Të nesërmen, të shoqëruar nga tre sheikë dhe katër arnautë, të gjithë të armatosur gjer në dhëmbë, u nisëm drejt lumit Jordan dhe ndaluan në një manastir murgjish ortodoksë të quajtur Mar-Sabah, ku në një bodrum ruheshin kokat e priftërinjve të masakruar nga beduinët". Të nesërmen, siç shkruante Du Camp, ata u nisën: "Përpara, konsulli francez, Jozef, pastaj Du Camp, Flober, Muhameti dhe shqiptarët... Dy orë më vonë mbërritëm në brigjet e De-

tit të Vdekur për t'u drejtuar pastaj në malet e luginës Cedron. Pasi ndoqëm shtratin e një lumi të shteruar e me shkëmbinj të thepisur dhe arritëm në këmbët e një forte-se. Një kokë murgu u shfaq dhe pyeti nëse kishim ndonjë letër për patriarkun. Pastaj ai lëshoi një kosh dhe ne futëm letrën. Disa çaste më vonë, porta u hap. Ishte manastiri Mar-Sabah. Ishin murgj grekë dhe në një bodrum ruheshin kokat e priftërinjve të masakruar nga beduinët shekuj më parë». Në kthim nga Jerusalem, në Mandra të Dafni-it të Greqisë, në janar të vitit 1851, Floberi ka shtuar: "Para se të mërrimë, para nesh shtrihet një ullishte dhe përroi i thatë. Në këtë fshat me shtëpi guri flitet shqip..." Edhe kur kalon në fshatin Kryekuq, ai përshkruan shtëpitë dhe thotë se "ky fshat banohet vetëm nga shqiptarët" dhe se "veshja e fëmijëve është tepër e hijshme". Kur mbërrin në Korfuz, në ditarin e tij ai shtonte: "Tutje, retë nderen në tokat shqiptare..."

Floberit i pëlqente shumë Orienti, madje, siç shkruajnë në kujtimet e tyre shkrimtarët Edmond dhe Jules de Goucourt, nganjëherë, atje në Croiset të Normandisë, ai vinte çallmën dhe vishej me rroba orientale, thjesht për t'u argëtuar me ata. Në datën 29 mars të vitit 1861, ata kanë shkruar: "Floberi është ulur në divanin e tij me këmbët e kryqëzuara alla-turke. Ai flet për ëndrrat e tij, për projektet dhe romanet që do të shkruajë. Ai na foli për dëshirën e madhe që kishte pasur, nga e cila nuk kishte hequr dorë, për të shkruar një libër mbi Orientin e sotëm, Orientin me roben e zezë. Dhe ai tregon me entuziazëm skena kontradiktore që ndodhin në Paris, Kostandinopojë apo mbi Nil, për skenat e hipokrizisë europiane dhe skenat të egra që ndodhin atje larg... Flet për koka të prera për një dyshim apo thjesht për një humor të keq..." /shqip/

Floberit i pëlqente shumë Orienti, madje, siç shkruajnë në kujtimet e tyre shkrimtarët Edmond dhe Jules de Goucourt, nganjëherë, atje në Croiset të Normandisë, ai vinte çallmën dhe vishej me rroba orientale, thjesht për t'u argëtuar me ata.



Perëndimi mund t'i aktivizojë konfliktet në Luginë e në Sanxhak

Strategjia e zgjerimit të Bashkimit Europian që vendeve të Ballkanit Perëndimor ua mundëson anëtarësimin në BE deri në vitin 2025, për drejtorin e Fondacionit të Moskës për politikë progresive, Oleg Bondarenko, është një karotë e re e Brukselit. "Serbia në kufijtë ekzistues nuk do të mund të hyjë në BE, ndërsa Brukseli e Berlina Beogradin kurrë nuk do ta pranojnë partner të barabartë", ka thënë ai për gazetën e Beogradit "Politika". Sipas tij, Beogradi duhet ta ruajë paqen me pozicionin e tashëm që atij i mundëson bashkëpunimin edhe me Bashkimin Europian e edhe me Rusinë. Bondarenko, në këtë intervistë, tërheq vërejtjen se Perëndimi po nxiton që ta përfundojë atë që e ka filluar gjë që në Serbi e në rajon mund të sjellë destabilitet të ri. "Ta marrim për shembull situatën se Aleksandar Vuçiq është i shtrënguar ta njohë pavarësinë e Kosovës për t'i ruajtur marrëdhëniet e mira me Brukselin e me Washingtonin. Si politikan racional, nuk besoj se ai do ta bënte këtë, sepse e di se në rrugë do të dilnin qindra mijëra njerëz për të protestuar. Për këtë arsye, Perëndimi, i cili nuk është mësuar të presë, mund të aktivizojë konfliktet e ngrira në jug të Serbisë, në Luginë e Sanxhak", thotë Bondarenko. Në vërejtjen se Sergei Lavrov kohë më parë në Beograd ka thënë se Serbia nuk kërcënohet nga skenari ukrainas, ai thekson se kjo gjë nuk përjashtohet dhe se ai skenar është i mundshëm pas dy vjetësh. Në konstatimin se pse të ndodhë ai skenar pasi Vuçiq po përsërit se do kompromis historik me shqiptarët, transmeton Koha.net, Bondarenko thotë se kryetari serb do kompromis, porse për këtë nuk ka gatishmëri në Prishtinë. "Shqiptarët veten e shohin fitues dhe nuk janë të gatshëm për kompromis sepse mendojnë ta kenë fituar luftën", tha ai.

Korridori ballkanik dominon drogën që hyn në Evropë nga Lindja dhe shqiptarët janë pjesë e bandave kriminale të trafikimit të drogës në shumë pjesë të Evropës

Shqipëria njihet si vend i prodhimit të hashashit. Ky nuk është lajm i ri. Lajm i ri nuk është po ashtu as që Shqipëria është pjesë e korridorit ballkanik të trafikimit të drogës, që vjen nga vendet e Lindjes. Megjithatë Shqipëria përmendet gjithnjë kur flitet për drogën në Evropë. "Kjo më shumë sepse shqiptarët janë pjesë e bandave kriminale të trafikimit të drogës në shumë pjesë të Evropës," - thotë për Deutsche Wellen David Johnson, ekspert në Qendrën e Kontrollit Ndërkombëtar të Narkotikëve. Grupet kriminale shqiptare bashkëpunojnë me grupet kriminale nga Greqia, Italia, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia dhe Turqia.

Korridori ballkanik dominon drogën që hyn në Evropë nga Lindja. Drogat opioide trafikohen nga vendet prodhuese Afganistani, Pakistani dhe Irani duke kaluar tranzit në Turqi dhe Ballkan për të shkuar në Evropën Qendrore dhe Perëndimore. Rruga ballkanike ka disa linja që ndryshojnë vazhdimisht, por linja kryesore e trafikut kalon nga Bullgaria, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Sllovenia dhe Austria, ndërkohë që një linjë më e vogël kalon nga Maqedonia dhe Kosova dhe përdoret kryesisht për magazinimin dhe ripaketimin. "Shqipëria përdoret për të transportuar drogat me rrugë detare në drejtim të vendeve të Evropës Veriore, si Britania e Madhe dhe Estonia," sqaron David Johnson. Ndërkohë që në



SHQIPËRIA,

EVROPA DHE DROGA

drejtimin e kundërt, nga Evropa në Shqipëri hyjnë drogat sintetike.

RRUGËT DETARE DHE AJRORE

Në Shqipëri është rritur numri i qendrave të kultivimit të hashashit, që njihet edhe si marijuan apo kanabis, shoqëruar nga ekspansioni i rrugëve detare të trafikimit dhe përpjekjeve për trafikime me rrugët ajrore, thuhet në raportin e Agjencisë së OKB për Kontrollin e Drogave. Për shkak të rritjes së ofertës çmimi i shitjes së marijuanës ka rënë në 100 deri 400 euro për kilogram. Kurse në vitin 2015 çmimi ka qenë 600 deri 1300 euro për kilogram. Shqipëria mbetet burimi kryesor i marijuanës që hyn në Evropë. Por prodhime shtëpiake të hashashit futen në Evropë edhe nga Islanda, Lituania, Letonia, Holanda, Polonia, Rumania dhe Sllovakia. Ndërsa vendin e parë për hashashin e mban Maroku, por edhe Libia.

Tregu i drogës ilegale në Evropë furnizohet me drogat e prodhuara

në shtëpi, të prodhuara në punishte si dhe nga droga që vjen nga pjesë të tjera të botës. Tregu i drogës ilegale në Evropë vlerësohet të sjellë 24 miliardë euro fitim në vit, thuhet në raport. Më shumë se një e treta e grupeve kriminale që operojnë në BE merren me prodhimin, trafikimin dhe shitjen e drogës ilegale, kurse dy të tretat ushtrojnë edhe aktivitete të tjera kriminale. Këto grupe ilegale përdorin teknologji të reja, përfshirë përdorimin e tregjeve online dhe të krypto-valutave, thuhet në raportin e OKB-së.

Numri i konfiskimeve në Evropë vlerësohet të jetë rreth 1 milionë raste në vit, ku pjesa më e madhe është kanabis. Abuzimi me kanabisin në Evropë është pesë herë më i madh se me substancat e tjera ilegale.

ITINERARI I HEROINËS

Pjesa më e madhe e heroinës të sekuestruar në Evropë e ka origjinën nga Afganistani, Irani dhe

Pakistani. Ka dy rrugë trafikimi heroine në Evropë, korridori ballkanik dhe korridori jugor. Rreth 40 për qind e heroinës globale dhe morfinës të kapur në Evropë ka kaluar nga korridori ballkanik, një prej korridoreve kryesorë për trafikimin e opiateve në botë. E ashtuquajtura pjesa rrugore e korridorit ballkanik të trafikimit përfshin Sirinë dhe Irakun. Kjo linjë është përdorur kryesisht për kontrabandën e heroinës nga Irani dhe Pakistani për në Evropë, ose direkt ose nga kontinenti afrikan. Përveç këtij korridori trafikantët përdorin edhe të ashtuquajturën linjë të veriut që kalon nga jugu i Kaukazit mepërmes Detit të Zi. Kokaina që gjendet në tregun evropian e ka origjinën në Bolivi, Kolumbi dhe Peru. Trafikantët përdorin rrugë të ndryshme për futjen e kokainës në Evropë përfshirë kontejnerë transporti detar, jahte, transportin ajror, avionë privatë, dërgesa me postë, pasagjerë që fluturojnë me avion.

Demarkacioni apo zgjedhje të reja?

Ratifikimi i Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit me Malin e Zi nga analistë të çështjeve politike vlerësohet të jetë jetik për Qeverinë Haradinaj. Kjo çështje, thonë ata, duhet të përmbyllet sa më shpejt, në të kundërtën të shkohet në zgjedhje të reja. Analisti i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, thotë për Radion Evropa e Lirë se nuk ka as edhe një kuptim që kjo çështje të shtyhet më shumë.

"Në fakt, prej deklaratave të politikanëve vendimmarrës në Kosovë, si të kryeministrit Ramush Haradinaj dhe kryeparlamentarit Kadri Veseli, krijohet përshtypja se tani ekziston një marrëveshje me Listën Serbe për votat e munguara, prandaj nuk ka asnjë kuptim që ky proces të vazhdojë përtej javës së ardhshme". "Nëse, eventualisht, nuk miratohet demarkacioni, nuk ka asnjë kuptim që kjo Qeveri të qëndrojë dhe duhet të shkohet në zgjedhje të reja. Çështja është jetike për qeverisjen Haradinaj, që të ratifikohet ky demarkacion dhe të procedohet me agjendën evropia-



Shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se derisa seancat e Kuvendit të Kosovës nuk po zhvillohen normalisht dhe në të shumtën e rasteve shumica parlamentare nuk po merr fare pjesë në votime, vendi duhet të shkojë në zgjedhje

ne", thotë Muhaxhiri. Zgjedhje të reja ka paralajmëruara edhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Shefi i Gru-

pit Parlamentar të LDK-së, Avdullah Hoti, në një konferencë për media të mbajtur gjatë kësaj jave, ka thënë se derisa seancat e Kuvendit të Kosovës nuk po zhvillohen normalisht dhe në të shumtën e rasteve shumica parlamentare nuk po merr fare pjesë në votime, vendi duhet të shkojë në zgjedhje. "Katër seanca parlamentare janë të hapura në pamundësi për t'i përmbyllur për shkak se koalicioni qeverisës është i shpërbërë. Në këtë situatë kur shumica parlamentare braktis Kuvendin, zgjedhjet e reja janë zgjidhje e vetme për të dalë nga kjo

situatë. Pas votimit të demarkacionit, Qeveria duhet të japë dorëheqje, Parlamenti duhet të shpërndahet dhe ne duhet të shkojmë në zgjedhje të reja dhe të formohet një shumicë e re parlamentare që udhëheq Kosovën në integrimin euroatlantike", ka thënë Hoti. Ratifikimi i marrëveshjes për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi, që nuk arriti të përmbyllet gjatë kësaj jave, ashtu siç ishte paralajmëruar nga liderët politikë të vendit, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, po pritët të marrë një epilog në javën që po hyjmë. Liderët politikë tashmë janë deklaruar se gjatë javës së ardhshme do të arrihet të ratifikohet kjo marrëveshje. Koalicioni qeverisës në tri seanca parlamentare nuk kishte arritur të sigurojë shumicën e nevojshme të votave për ta ratifikuar Marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi Për ratifikimin e kësaj marrëveshje nevojiten së paku 80 vota të deputetëve nga 120 sa ka Kuvendi i Kosovës.

SI MUND T'I HAKMERRET BRITANIA RUSISË?

Sekretari i Jashtëm britanik, Boris Johnson, ka thënë se Britania mund të rrisë sanksionet kundër Rusisë, nëse gjen se Moska ka qenë e përfshirë. Kremlini ka kundërshtuar çdo përfshirje duke i cilësuar raportimet e mediave britanike si histeri anti-ruse



Zyrtarët britanikë janë duke biseduar me aleatët amerikanë dhe ata evropianë për t'u koordinuar lidhur me masat hakmarrëse të cilat mund të zbatohen nëse vërtetohet se Moska është mbra pa helmimit të ish-spiunit rus, Sergei Skripal dhe vajzës së tij, Yulia, në Salisbury, kanë raportuar mediat britanike. Gazeta The Times, ka thënë se kundërmassat mund të përfshijnë gjithçka, duke nisur nga bojkotimi i kampionatit të futbollit për Kupën e Botës që do të mbahet në Rusi, deri të rritja e numrit të trupave të NATO-s, të vendosur në krahun lindor të aleancës ushtarake. "Mundësi të shumta janë duke u diskutuar",

është cituar të ketë thënë një zyrtar britanik. Hetimi lidhur me tentim-vrasjen e Skripal dhe vajzës së tij tani janë në ditën e shtatë. Zyrtarët kanë thënë se të dy janë "në gjendje kritike, por më stabile", në një spital në Salisbury, pasi i janë ekspozuar një agjenti nervor. The Times ka thënë se hakmarrja mund të përfshijë anulimin e pjesëmarrjes së politikanëve në organizmin për Kupën e Botës, të planifikuar për 14 qershor deri më 15 korrik.

Ekipet e shteteve të tjera, që janë të kualifikuar për këtë ngjarje, siç janë Polonia, Australia dhe Japonia, mund të ftohen për t'iu bashkuar këtyre masave, i

kanë thënë zyrtarët gazetës. Ata po ashtu kanë thënë se masa të tjera mund të përfshijnë shtimin e forcave të NATO-s në Evropën Lindore. Rreth 4,000 trupa janë angazhuar në krahun lindor të aleancës, për të siguruar aleatët e rajonit që janë të shqetësuar nga lëvizjet agresive të politikës së Jashtme të Moskës. Në të njëjtën kohë qeveria britanike ka mbajtur më 10 mars një tjetër takim të sigurisë së lartë, për të diskutuar sulmin me agjent nervor.

Sekretarja britanike për Punë të Brendshme, Amber Rudd, ka thënë pas takimit se ende është "shumë herët" për të thënë se kush ka qenë mbra pa sulmit, i cili

po konsiderohet si tentim-vrasje. Sekretari i Jashtëm britanik, Boris Johnson, ka thënë se Britania mund të rrisë sanksionet kundër Rusisë, nëse gjen se Moska ka qenë e përfshirë. Kremlini ka kundërshtuar çdo përfshirje duke i cilësuar raportimet e mediave britanike si histeri anti-ruse.

Më 10 mars, BBC ka raportuar se hetuesit kanë gjetur gjurmë të agjentit nervor në një restorant, ku Skripal dhe vajza e tij kanë ngrënë para se të sëmureshin. Personat e tjerë që kanë qenë duke ngrënë në restorant në po të njëjtën kohë nuk besohet të jenë në rrezik, është thënë ndër të tjera në raportin e BBC-së.

Rusët provokojnë hebrenjtë me... akullore

Komuniteti hebre i rajonit rus të Tatarstanit reagoi ashpër ndaj një kompanie vendase, e cila ka hedhur në treg një akullore të re, emri i të cilës përkthehet "të varfrit hebrenj". Provojeni këtë mrekulli, e reklamon brendi krijimin e vet të fundit në një rrjet social rus; sepse në fund, do ta shihni, na rezultojnë që hebreu nuk është dhe aq i varfër. Edhe ngjyrat e përdorura për ambalazhin e akullores, blu dhe të bardhë kujtojnë ato të flamurit izraelit dhe "Yllit të Davidit"- simboli i identitetit modern hebre dhe judaizmit. Produkti i Slavitsa's mbushi



titujt e gazetave në rusi pasi kryetari i komuniteti hebre të qytetit perëndimor Naberezhnye Chelny dha alarmin duke deklaruar se

"tronditja ishte efekti më i paktë i një veprimi të tillë". Leonid Shteinberg kërcënoi gjatë një interviste televizive ta hedhë në gjyq

fabrikën nëse nuk e ndalon prodhimin e akullores, transmeton tch. Drejtori i Slavitsa's u përgjigj duke i thënë se shitjet po ecin shumë mirë, dhe se njerëzit e adhurojnë këtë produkt. Në fund të ditës, theksoi ai përsëri, është e qartë për të gjithë se hebrenjtë nuk janë aspak të varfër, duke iu referuar këtu suksesit të akullores. Slavitsa tërhoqi vëmendjen edhe në 2016-tën me prodhimin e një akulloreje me çokollate të quajtur "Obamka" apo Obama i vogël, e cila kishte në ambalazh figurën e një djali me lëkurë të errët.



Marine Le Pen kthehet në krye të Frontit Kombëtar

Partia djathtiste e Francës, Fronti Kombëtar (FN) ka rizgjedhur të dielën Marine Le Pen për kryetare të saj. Për rizgjedhjen e Le Pen votuan 79 për qind nga delegatët e pranishëm në kongresin e partisë, në të cilin ajo ishte kandidatë e vetme për postin e kryetarit të partisë. Babait të saj, Jean-Marie Le Pen, sot iu mor titulli i kryetarit të nderit të kësaj partie politike, pasi paraprakisht në vitin 2015 ai u përjashtua nga partia nga shkak i komenteve antisemite, por mbajti titullin e kryetarit të nderit. Votimi i sotëm ishte goditja e fundit ndaj 89 vjeçarit i cili në vitin 1972 formoi partinë, me të cilën në vitin u radhit partia e dytë në zgjedhjet presidenciale, ku fitoi rreth 18 për qind të votave.

Trump beson se Koreja e Veriut do ta mbajë fjalën

Presidenti i SHBA-ve Donald Trump shprehu besimin se Koreja e Veriut do t'i mbetet besnik fjalës së dhënë dhe se do t'i ndalë testimet e raketave. Në një postim nga llogaria e tij në rrjetet sociale, Trump ka nënvizuar se Koreja e Veriut që nga muaji nëntor nuk ka kryer ndonjë testim bërthamor. "Besoj se do ta mbajë fjalën e dhënë", ka thënë Trump duke folur për liderin e Koresë së Veriut Kim Jong-un i cili "ka dhënë fjalën se nuk do të kryejë teste të tilla". Trump tha se lidhur me çështjen e Koresë së Veriut ka zhvilluar bisedë telefonike edhe me kryeministrin e Japonisë Shinzo Abe dhe presidentin e Kinës Xi Jinping dhe se të dyja shtetet kanë vështrim pozitiv për një takim me Korenë e Veriut. Presidenti amerikan gjatë fjalimit të tij në një tubim në Pennsylvania të mbajtur për mbështetje të kandidatit republikan për Kongresin Rick Saccone shprehu besimin se Koreja e Veriut dëshiron paqe. "Mendoj se tanimë ka ardhur koha për këtë", ka thënë ai. "Kush mund ta dijë se çfarë do të ndodhë? Mund të largohem menjëherë nga ai vend ose ulemi dhe mund të arrijmë marrëveshje të mëdha për botën", ka thënë Trump, duke komentuar për atë në rast se mbahet takimi në fjalë. Presidenti kinez tha se e çmon vullnetin e Trumpit për zgjidhjen e çështjes bërthamore të Koresë së Veriut nëpërmjet rrugës politike. Ai shpreson në fillimin e sa më parë të dialogut mes SHBA-ve dhe Koresë së Veriut dhe të dyja shtetet të tregojnë përpjekje për rezultate pozitive.



This project is funded
by the European Union



Empowered lives.
Resilient nations.

**KOMUNA E GOSTIVARIT NË PARTNERITET ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP) SHPALL:
THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATA CIVILE PËR PARASHTRIMIN E PROPOZIM PROJEKTEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT RAJONAL PËR DEMOKRACI LOKALE NË
BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)**

Programi rajonal për demokraci lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) është i financuar nga Unioni Evropian dhe e zbaton Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në gjashtë vende/teritore nga Ballkani Perëndimor. Projekti do të zgjasë deri në janar të vitit 2020 dhe do ta ketë për qëllim fuqizimin e demokracisë participative (pjesëmarrëse) dhe proceset për integrim të vendeve nga Ballkani Perëndimor në Unionin Evropian përmes fuqizimit të shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive të tij në procesin e vendimmarrjes.

Me projektin ReLOaD është paraparë që të përfshihen 5 komuna në vendin tonë: Strumicë, Resnjë, Kavadar, Gostivar dhe Kumanovë.

Komuna e Gostivarit dhe projekti ReLOaD i ftojnë të gjitha organizatat civile në vendin tonë të parashtrorinë propozim projekte të cilat janë konsekuente për qëllimet zhvillimore të komunës së Gostivarit dhe me të cilat janë përfshirë fushat vijuese prioritare:

1. Arsim
2. Ambient jetësor
3. Liritë dhe të drejtat e njeriut, jodiskriminim dhe inkluzion social
4. Zhvillim ekonomik lokal
5. Art dhe kulturë, të rinj dhe sport

Shuma e mjeteve për projektet e miratuara do të lëviz prej 307.000,00 MKD deri 1.845.000,00 MKD .

Organizatave të shoqërisë civile u lejohet të parashtrorinë më shumë se një propozim projekt nëse shumata totale e alokuar nuk kalon 3.690.000,00 MKD për tërë kohëzgjatjen e projektit ReLOaD (deri në janar të vitit 2020).

Komuna e Gostivarit dhe UNDP e rezervojnë të drejtën të mos i ndajnë fondet në dispozicion nëse projekt propozimet nuk i

plotësojnë kriteret e specifikuar. Projektet mund të jenë për një kohëzgjatje prej 6 deri në 8 muaj. Projektet e përzgjedhura duhet të zbatohen në periudhën nga maji 2018 deri në dhjetor 2018.

PËRSHTATSHMËRI:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha organizatat të shoqërisë civile të regjistruara formalisht (shoqata/organizata ose fondacione) në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Të gjitha organizatat e interesuara të shoqërisë civile mund të gjejnë informacione të hollësishme rreth kushteve të aplikimit dhe kriterëve për financimin e projekteve në Udhëzimet për aplikuesit, të cilat janë pjesë përbërëse e dokumentacionit për thirrjen publike.

DOKUMENTACION:

Dokumentacioni për aplikim për thirrjen publike në komunën e Gostivarit do të jetë në dispozicion nga data 13.03.2018, përmes dërgimit të një kërkesë në adresën vijuese Bulevardi Vëllezërit Gjinovski nr.61, Gostivar dhe/ose në email: info@gostivari.gov.mk, në të cilën është theksuar emri i organizatës së interesuar, ose personalisht në komunën e Gostivarit, rruga: Bulevardi Vëllezërit Gjinovski nr.61, Gostivar. Të gjitha informacionet e nevojshme dhe versioni elektronik nga e gjithë pakoja e aplikacionit mund gjithashtu të shkarkohen edhe nga faqja zyrtare e internetit e komunës (www.gostivari.gov.mk), si dhe në faqen e internetit të UNDP-së (www.mk.undp.org).

Sesioni informues (dita e hapur) për thirrjen me parashtruesit e interesuar përkatësisht organizata të shoqërisë civile do të mbahet në komunën e Gostivarit më datën 20.03.2018, me fillim në orën 11:00 në lokalit të komunës.

Pyetje në lidhje me thirrjen publike mund të parashtrorinë përmes adresës registry.mk@undp.org, me shenjë për thirrjen publike. Pyetjet mund të dorëzohen deri më 28.03.2018 dhe përgjigjet do të jepen në formë të shkruar në afat prej 3 ditë pune nga data e pranimit të pyetjeve. Për të siguruar transparencë, pyetjet do të publikohen në faqen e internetit të UNDP-së.

PARASHTRIMI I APLIKACIONEVE:

Aplikacionet e plotësuar (me dokumentacion të plotë) duhet të dorëzohen në tri (3) kopje të shtypura dhe një version elektronik (në CD ose USB), në një zarf të mbyllur me një njoftim se është për thirrjen publike, me rekomandë përmes postës ose personalisht, në ditë pune (premtë-e hënë) nga ora 09:00 deri në orën 15:00 në adresën vijuese:

Komuna e Gostivarit
Rruga: Bulevardi Vëllezërit Gjinovski 61
Numri postar: 1230

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 09.04.2018, deri në orën 15:00. Aplikimet që do të dorëzohen pas këtij afati përfundimtar do të merren parasysh vetëm nëse në vullën postare qëndron data dhe koha e dërgimit përpara afatit përfundimtar. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jetë emri i thirrjes për dorëzimin e propozim projekteve, emri i plotë dhe adresa e aplikuesit, emri i plotë i projektit dhe shënimi "Të mos hapen para hapjes zyrtare". Nëpunësi komunal do të lëshojë një vërtetim për marrjen e dokumenteve të parashtruar. Të gjithë parashtruesit e propozim projekteve, pa marrë parasysh nëse propozim projektet pranohen ose refuzohen, do të njoftohen në formë të shkruar për vendimin në lidhje me propozimin e tyre në afat prej 30 ditëve pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të komunës (www.gostivari.gov.mk) dhe/ose në tabelën komunale dhe në faqen e internetit të UNDP (www.mk.undp.org)



This project is funded
by the European Union



Empowered lives.
Resilient nations.

**KOMUNA E KUMANOVËS NË PARTNERITET ME PROGRAMIN PËR ZHVILLIM TË KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP) SHPALL:
THIRRJE PUBLIKE PËR OGRANIZATAT E QYTETARËVE PËR PARASHTRIM TË PROPOZIM - PROJEKTEVE NË KUADËR TË PROGRAMIT RAJONAL PËR DEMOKRACI
LOKALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (ReLOaD)**

Programi rajonal për demokraci lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) financohet nga Bashkimi Evropian, kurse e zbaton Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në gjashtë vende/teritore të Ballkanit Perëndimor. Projekti do të zgjasë deri në Janar të vitit 2020 dhe ka për qëllim përforcimin e demokracisë participative dhe proceseve të integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, përmes përforcimit të shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive në procesin e vendimmarrjes.

Me projektin ReLOaD është paraparë të kyçen pesë komuna nga vendi ynë: Strumica, Resnja, Kavadar, Gostivari dhe Kumanova.

Komuna e Kumanovës dhe projekti ReLOaD i ftojnë të gjitha organizatat civile në vend që të parashtrorinë propozim - projekte që janë konsekuente me qëllimet zhvillimore të Komunës së Kumanovës dhe me të cilat janë përfshirë këto fusha:

1. Mbrojtja e mjedisit jetësor
2. Mbrojtja e të drejtave të njeriut
3. Kohezioni social dhe zvogëlimi i varfërisë
4. Turizmi dhe kultura
5. Nismat rinore

Shuma e mjeteve për projektet e miratuar do të lëviz prej 307.000,00 MKD deri në 1.845.000,00 MKD.

Organizatave civile u lejohet që të parashtrorinë më shumë se një propozim - projekt, nëse vlera e përgjithshme e ndarë nuk e tejkalon shumën 3.690.000,00 MKD, gjatë gjithë kohës sa zgjatë projekti ReLOaD (deri në Janar 2020).

Komuna e Kumanovës dhe UNDP e mbajnë të drejtën që mos t'i ndajnë mjetet në dispozicion, nëse propozim - projektet nuk i plotësojnë kriteret e dhëna. Projektet mund të jenë me

kohëzgjatje prej 6 deri në 8 muaj. Projektet e zgjedhur patjetër duhet të implementohen brenda periudhës maj - dhjetor 2018.

FRYTSHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha organizatat e regjistruara civile (asociacione/organizata ose fondacione) në harmoni me ligjet dhe dispozitat në fuqi. Të gjitha organizatat civile të interesuara, informata më në detaje për kushtet e aplikimit dhe për kriteret e financimit të projekteve mund të gjejnë në Udhëzuesit për parashtruesit, që janë pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

DOKUMENTACIONI:

Dokumentacioni për aplikim në këtë thirrje publike në Komunën e Kumanovës do të jetë i qasshëm prej datës 13.03.2018, përmes parashtrimit të kërkesës në këtë adresë: 11 Tetori pn, 1300 Kumanovë ose/dhe në e-mail: info@kumanovo.gov.mk, ku është dhënë emri i organizatës së interesuar, ose në Komunën e Kumanovës, rruga: 11 Tetori pn. Të gjitha informatat e domosdoshme dhe versionin elektronik të gjithë paketës për aplikim mund ta marrin në faqe zyrtare elektronike të Komunës së Kumanovës (www.kumanovo.gov.mk) si dhe në faqen elektronike të UNDP - së (www.mk.undp.org).

Sesioni informativ (dita e hapur) për këtë thirrje me organizatat civile që kanë parashtruar aplikacion do të mbahet në Komunën e Kumanovës më datë 19.03.2018, duke filluar prej orës 10:00, në hapësirat e Komunës.

Pyetje në lidhje me thirrjen publike mund të parashtrorinë përmes adresës registry.mk@undp.org, me shenjë për thirrjen publike.

Pyetjet mund të parashtrorinë deri më 27.03.2018, kurse përgjigjet do të sigurohen në afat për tri ditë pune nga data e marrjes së pyetjeve. Për të siguruar transparencë, pyetjet do të shpallen në faqen elektronike të UNDP - së.

PARASHTRIMI I APLIKACIONEVE:

Aplikacionet e plotësuar (me dokumentacionin komplet) patjetër duhet të parashtrorinë në tri (3) kopje të shtypura dhe një në version elektronik (në CD ose USB), në zarf të mbyllur me shenjë për thirrjen publike, me postë rekomanduese ose personalisht, gjatë ditëve të punës (e hënë - e premte), prej orës 09:00 deri në ora 15:00, në këtë adresë:

Komuna e Kumanovës
Rruga: 11 Tetori pn
Numri i postës: 1300 Kumanovë

Afati i fundit për parashtrim të aplikacioneve është 09.04.2018, deri në ora 15:00. Aplikacionet që do të parashtrorinë pas afatit përfundimtar do të shqyrtohen vetëm nëse në markën postare qëndron data dhe koha e parashtrimit para afatit përfundimtar zyrtar. Në faqen e jashtme të zarfit patjetër duhet të qëndrojë emri i thirrjes për parashtrim të propozim - projekteve, emri dhe adresa e plotë e parashtruesit, titulli i plotë i projektet dhe shenja "Të mos hapet para hapjes zyrtare." Nëpunësi komunal do të jep vërtetim për pranimit të dokumenteve të parashtruar. Të gjithë parashtruesit e propozim - projekteve, pavarësisht se të njëjtët janë pranuar apo refuzuar, do të njoftohen me shkrim për vendimin në lidhje me propozim - projektin e tyre në afat prej 30 ditë pune nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të shpallen në faqen elektronike të komunës (www.kumanovo.gov.mk) ose/dhe në tabelën e shpalljeve të komunës, dhe në faqen elektronike të UNDP - së (www.mk.undp.org)

VITI I VALON BERISHËS

Valon Berisha është futbollisti kryesor i Përfaqësueses së Kosovës qyshkur i ishte bashkuar Verdhekalterve duke hequr dorë nga Përfaqësuesja e Norvegjisë

Madje, mesfushori kreativ ishte zgjedhur në dy vjetët e fundit futbollisti i vitit në Kosovë. Krahas Përfaqësueses, Berishës po ia do edhe me ekipin e tij Red Bull Salzburg. Futbollisti i lindur në Suedi dhe i rritur në Norvegji e ka marrë në dorë skuadrën austriake, të cilën po e udhëheq drejt sukseseve.

SHKËLQEN NË LIGA EVROPË

Berisha konsiderohet njëra prej befasive më të mëdha të "Europa Leagues" këtë edicion. Prishtinasi e ka vendosur fitoren e Salzburgut ndaj Borussia Dortmundit duke realizuar dy gola në ndeshjen e parë çerekfinale, duke shënuar në minutat 49 e 56, për t'ia siguruar



ekipit të tij fitoren 2:1 ndaj gjigantit gjerman. Këtë edicion Berisha ka realizuar 4 gola në 8 ndeshje me Salzburgun në "Europa League".

I DOBISHËM EDHE NË AUSTRI

Berisha po tregon formë të jashtëzakonshme edhe në kampionatin austriak. Këtë sezon ai ka realizuar 3 gola në 23 ndeshje, derisa shquhet më shumë për asistime, duke i dhuruar 7 sosh për shokët. Madje, pas golit të shënuar pak

ditë më parë në derbin austriak Berisha filloi të qante pasi atë ia kushtoi gjyshes, që i kishte vdekur ato ditë. Deri vitin e kaluar ai kishte realizuar 29 gola në 168 ndeshje me ekipin austriak. Një statistikë jo e keqe për një lojtar që vetëm viteve të fundit i është afruar portës. Ai ka aftësi të shkëlqyeshme dhe shquhet edhe në aspektin defenzivë dhe në atë ofenzivë. Një lojtar jo më i ri, por që e ka zgjuar interesimin e skuadrave të njohura evropiane.

MOMENTI I HAPIT TË RADHËS

Berisha e kishte nisur karrierën në Norvegji, në ekipin e të rinjve të Egersundit, ku kishte debutuar edhe për të mëdhenjtë, ndërsa më pas ka luajtur dy sezona me Vikingun. Në vitin 2012 i kishte arritur ftesa nga Austria, ku e pëlqente Salzburgu dhe nga ajo kohë luan atje. Ky mund të jetë sezoni i fundit i Berishës në futbollin austriak pasi flitet se ai gjatë verës mund të transferohet në ndonjë skuadër të Premier ligës. Për të interesim ka shfaqur Njukasëll.



Kastrati shkakton "tërmet" në futbollin kroat

Në vetëm ndeshjen e dytë kampionale, Lirim Kastrati ka shkakuar "tërmet" në futbollin kroat. Ai të shtunën udhëhoqi Lokomotivën e Zagrebit drejt fitores së parë kampionale në histori ndaj Dinamos së Zagrebit. Futbollisti i ri Kastrati shënoi dy gola dhe siguroi një penallti në fitoren 4:1 të Lokomotivës, që në Kroaci njihet si filial i Dinamos. Në fakt bëhet fjalë thajse për një klub të njëjtë, Dinamo i dërgon te Lokomotiva lojtarët e rinj për të marrë përvojë, dhe ndeshjet e deritashme mes dy skuadrave ishin si stërvitje për Dinamon. Fitorja e gjigantit kroat as që vihej në dyshim. Por kështu nuk ndodhi të shtunën. Lojtarët e rinj të Lokomotivës, të prirë nga 19-vjeçari Kastrati, përmes kundërsulmeve efektive arritën të fitorja e thellë dhe e papritur. Humbja ishte goditje e rëndë për Dinamon. Trajneri Mario Cvitanović menjëherë dha dorëheqje, ndërsa rezultati u vlerësua turpërues.

OSMANI FLET PËR TRE PIKËT E MARRA NDAJ RABOTNIÇKIT

Penalltia dhe kartoni i kuq, vendimtare për fitoren

Shkup, 12 mars - Skuadra e Shëndijës të dielën në "Filipi i dytë" mundi Rabotniçkin dhe vazhdoi serinë e fitoreve, e katërta nga pesë ndeshjet e sezonit pranveror. Ndaj "romantikëve", kuqezinjët arritën fitore me rezultatin 2-0, ndërsa sipas trajnerit të kësaj skuadre Qatip Osmani, vendimtare ka qenë penalltia për 0-2 në fillim të pjesës së dytë dhe kartoni i kuq për lojtarin kundërshtar. Gjithashtu për Osmanin është me rëndësi që djemtë e tij menaxhuan

me sukses përballjen, duke i dhënë mundësi që të pushojë një pjesë të lojtarëve për sfidat e ardhshme kampionale dhe në gjysmëfinale së Kupës të mërkurës me Renovën. "Qëllimi i ekipit ishte të vazhdojë me fitore dhe rritmi i lojës mbase na u imponua edhe nga kundërshtari. Shënuam në kohë, ndërsa penalltia dhe kartoni i kuq për vendasit na lehtësoi të menaxhojmë lojën dhe të ruajmë forcat për takimin e Kupës në mesjavë", shprehet trajne-

ri Qatip Osmani. Ai pranoi epërsia prej 16-të pikëve që ka ekipi i tij kundrejt Vardarit po japin një qetësi për të menaxhuar lojën. "Sigurisht që po. fakti se kemi një epërsi të mirë kundrejt Vardarit, ia lehtëson ekipit një lojë më të sigurt dhe stabile, ku ke hapësirë edhe të kombinosh", përfundoi Osmani. Ndërkohë, ndeshjen e ardhshme skuadra e Shëndijës në kampionat do ta zhvillojë kundër Sileksit në stadiumin e qytetit në Tetovë.



Publicitet

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit për dizajn dhe teknologji të mobileve dhe enterierit në Shkup, publikon

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:

- *Ekonomika dhe organizimi i industrisë së drurit*, nën numër 41102 sipas Klasifikimit të sferave shkencore, fushave dhe degëve të hulumtimit, të harmonizuar me standardet e OECD dhe UNESCO,

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin për dizajn dhe teknologji të mobileve dhe enterierit në Shkup, bul. "16-ta Makedonska Brigada" nr. 3, fahu postal 8, 1130 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup

Në përputhje me Rregulloren për mënyrën e realizimit të ekskursioneve me nxënës për nxënësit e shkollave të mesme, SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë shpall:

FTESË PËR DORËZIMIN E OFERTAVE

Për organizimin e ekskursionit përfundimtar për vitin shkollor 2017/2018 për:

- Përshkrimi i shërbimit
 - Organizimi i ekskursionit përfundimtar për nxënësit e viteve të treta në vendet e Evropës sipas programit për një periudhë 6 (gjashtë) ditë në muajin maj të v. 2018 me 4 (katër) net në hotel me 3 * dhe 4 * me mëngjes dhe darkë. Përshkrimi në detaje është dhënë në dokumentacionet me udhëzime për ofertuesit dhe Programi për ekskursionin përfundimtar, i cili mund të merret nga arkivi i shkollës çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 14:00.
- Kushtet minimale që duhet t'i plotësojnë ofertuesit janë:
 - Të jetë i regjistruar sipas rregulloreve pozitive të Republikës së Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë përkatëse turistike.
 - Të ketë të realizuar me sukses së paku 3 ekskursione me nxënës dhe aktivitete tjera në tre vitet e fundit.
 - T'i plotësojë kushtet për transport grupor të nxënësve sipas Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe Rregulloren për kërkesa të veçanta teknike të automjeteve që transportojnë grupe fëmijësh.
- Oferta duhet të përmbajë këto dokumente
 - Dokumente si dëshmi për përmbushje të kushteve minimale.
 - Programin për realizimin e ekskursionit.
 - Formularin plotësues të ofertës.
 - Deklaratë e seriozitetit të ofertës.
- Ofertuesi i cili do të zgjidhet si më i favorshmi në ditën e nënshkrimit të kontratës me shkollën duhet të dorëzojë një garanci bankare për cilësinë e zbatimit të kontratës në vlerë prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës
- Oferta zgjatë pesë ditë pune nga dita e publikimit.
- Ofertat të dorëzohen në arkivin e SHMTK "Nace Bugjoni" Kumanovë apo në adresën rr. Bajram Shabani pn 1300 Kumanovë me shenjë "Për Komisionin për mbledhjen e ofertave për ekskursion"

SHMTK "NACE BUGJONI"
Kumanovë



Në bazë të Programit për financim të institucioneve publike dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2018 ("Lajmëtarit zyrtar i Qytetit të Shkupit" numër 1/2018),

QYTETI I SHKUPIT

Shpall

Thirrje publike për financim të projekteve dhe aktiviteteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit në suaza të projektit "NGA QENDRA DREJTË PERIFERISË: KULTURA SI VEGËL PËR ZHVILLIM SOCIAL"

I
Me qëllim që të sigurohet dekoncentrimi i kulturës nga qendra e qytetit të Shkupit drejt pjesëve periferike të qytetit, dhe me këtë të përhapet, fisnikërohet dhe të futet në lëvizje oferta kulturore në qytetin e Shkupit, Qyteti i Shkupit shpall "Thirrje publike për financim të programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës në suaza të aktivitetit programor "Nga qendra drejtë periferisë: Kultura si vegël për zhvillim social" për vitin 2018.

II
Në thirrjen publike të drejtën e pjesëmarrjes e kanë të gjithë personat juridikë me sa vijon: institucionet nga fusha e kulturës, shoqatat civile dhe fondacionet, si dhe personat tjerë juridikë që kryejnë veprimtari nga fusha e kulturës në pajtim me Ligjin për kulturë dhe dispozitat tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë.

III
Qëllimet e thirrjes:

- Decentralizim i kulturës dhe i resurseve kulturore në ato pjesë të Qytetit të Shkupit në të cilët nuk kemi zhvillim të mjaftueshëm të jetës kulturore, për shkak të mos ekzistimit të infrastrukturës ose të veprimtarive aktive kulturore dhe të subjekteve që merren me kulturë;
- Lokalizimi dhe animimi i hapësirave dhe sipërfaqeve të pa shfrytëzuara publike dhe i infrastrukturës publike, që janë me rëndësi lokale, por shfrytëzimi i të cilëve mund të ndikojë në drejtim të përmirësimit të jetës sociale dhe kulturore për banorët e Qytetit të Shkupit, në veçanti në pjesët e qytetit që karakterizohen me zhvillim të pamjaftueshëm;
- Përcaktimi i nevojave kulturore të banorëve në pjesët e pa animuara dhe të pazhvilluara për nga aspekti kulturorë në Qytetin e Shkupit dhe në Komunat në suaza të Qytetit të Shkupit.
- Përfshirja e përkatësve të grupeve të rrezikuara sociale dhe të pakicave, përkatësve të bashkësive etnike, fëmijëve dhe të nxënësve që jetojnë në rrethin e afërt, me përfshirjen e komponentit gjinorë dhe të aktiviteteve të balancuara gjinore.

IV
Parashtruesit e aplikacionit duhet të deponojë propozim aktiviteti projektuese që do të zgjasin më së paku dy (2) muaj dhe do të zgjasin më së shumti deri më 1 dhjetor 2018 dhe, të cilat duhet të përmbajnë:

- Aktivitete të ofruara nga fusha e kulturës me pjesëmarrjen e artistëve dhe autorëve, teoricienëve nga fusha e kulturës dhe arteve, sociologë të kulturës, arkitektë, urbanistë etj. Krijimet artistike të ofruara mund të jenë multi-disiplinore ose të përmbajnë ndonjë nga degët e veçanta të arteve (arte vizuale dhe art i medimeve të reja, dizajn, industri kreative, arte muzikore, arte performuese, projeksione filmash, letërsi etj);
- Seri punëtorish, debate, biseda, intervenime artistike dhe vende të ngjashme multi-disiplinore me përfshirjen aktive të banorëve lokal nga lokacioni zgjedhur;
- Hulmtime interaktive për historinë e lokacionit të parashkuar, për historinë ose zakonit e banorëve lokal nga vendbanimi i parashkuar;
- Është e dëshirueshme përfshirja e grupeve sociale në rrezik dhe pakicave, fëmijëve dhe nxënësve që jetojnë në zonën përreth, përfaqësuesve të bashkësive etnike, si dhe realizimi i aktiviteteve gjinore të balancuara;

- Parashtruesi i aplikacionit mund të ofrojë edhe zhvillim të modeleve dhe strategji për menaxhimin e ambientet publike dhe resurset publike, që mund të shfrytëzohen për zhvillimin e kulturës të lokacionit të zgjedhur.

- Parashtruesi i aplikacionit mund të propozojë edhe aktivitete dhe masa tjera, që nuk janë përfshirë me thirrjen publike, dhe që kanë si qëllim zgjerimin e ofertës kulturore në Qytetin e Shkupit dhe pasurimin e jetës kulturore në territorin e Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit në të cilat nuk ekziston ofertë kulturore aktive dhe infrastrukturë.

V
Vërejtje: Pas përfundimit të aktiviteteve aplikuesi i zgjedhur është i obliguar të deponojë raport financiar të përfunduar dhe narrativë në të cilin do të përfshihen edhe konkluzionet nga aktivitetet dhe hulumtimet e realizuara.

VI
Thirrja publike ka të bëjë me aktivitetet që do të realizohen gjatë vitit 2018, por jo më vonë se 1 dhjetor 2018.

Shfrytëzimi i mjeteve do të specifikohet në kontratën ndërmjet subjektit juridik-aplikuesit dhe Qytetit të Shkupit.

Paraqitja në Konkurs kryhet me deponimin e fletëparaqitjes së plotësuar (aplikacionit).

Aplikantët, përkajshëm formulat të plotësuar në mënyrë elektronike, për paraqitje detyruesisht duhet të dorëzojnë këto dokumente vijuese:

- Dokumentin për regjistrimin e veprimtarisë të dhënë nga Regjistri Qendrorë i Republikës së Maqedonisë, jo më i vjetër se 6 muaj;
- Vërtetim për gjiro logari të hapur dhe aktive.

Aplikantët si shtojcë duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin përcjellës që ka të bëjë me realizimin e aktivitetit:

- Biografi profesionale të profesionistëve që do të angazhohen në realizimin e projektit, kontratat autoriale me pjesëmarrësit;
- Listën referuese ose dëshmi (për shembull: kontrata e nënshkruar për së paku 2 projekte të realizuara nga fusha për të cilën aplikohet;
- Hapësirë të siguruar ose partneritet me ndonjë institucion / organizatë, për të cilët është planifikuar që të marrin pjesë në realizimin e projektit;
- Mjete plotësuese financiare, të siguruar nga mjetet pronësore dhe nga burimet tjera.

VI
Evalvimi i projekteve do të realizohet nga Komisioni i formuar nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit, sipas këtyre pikëve të vlerësimit:

Kritere të vlerësimit	Pikat maksimale
1. Struktura organizative dhe resurset	50
1.1. Kapaciteti i Organizatës krahas resurseve njerëzore për realizim të projektit (të punësuarit, vullnetarët aktiv, persona të angazhuar me honorarë, përfaqësimi i balancuar i femrave dhe meshkujve në suaza të organizatës).	10
2. Profesionaliteti dhe përvoja e personave që marrin pjesë në organizimin e projektit.	10

3. Përvoja e Organizatës në drejtim të realizimit të projekteve të përmasave të tilla në fushën përkatëse.	10
1.4. Kapacitetet teknike të domosdoshme për realizim të projektit.	10
1.5. Partneritete të themeluara dhe përfshirja e institucioneve tjera, relevante për temën përkatëse.	10
Cilësitë e projektit	50
2.1. Harmonizimi i aktiviteteve të propozuara / evenimente përcjellëse me qëllimet e thirrjes.	10
2.2. Ofrimi i zgjidhjeve të ofruara cilësore dhe inovative për realizim të detyrave të punës.	10
2.3. Aktiviteteve të shtjelluara në mënyrë të detajuar.	10
2.4. Arsyetimi i shpenzimeve në lidhje me planin e propozuar financiar (buxhet real krahas aktiviteteve dhe numrit të personave të angazhuar, përfshirja e shpenzimeve sipas pozitave dhe se sa të njëjtit janë në pajtim me çmimet e tregut).	10
2.5. Pjesëmarrja me mjetet pronësore financiare dhe me mjetet e siguruar nga burimet tjera.	10
Numri i përgjithshëm i pikave maksimale	100

Çdo fushë nga kriteret e posaçme programore do të vlerësohet me 1 pikë, 5 pika ose me 10 pika, me kuptimin vijues: 1 – jo, 5 – pjesërisht dhe 10 – po. Fletëparaqitjet (fletë aplikimet) mund të merren në Portalin zyrtarë të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

Thirrja publike shpallet më datën 13.03.2018 dhe zgjatë deri më datën 11.04.2018, përkatësisht 30 ditë nga dita e shpalljes në mjetet për informim publik. Fletëparaqitjet, në trajtë të shkruar dhe të incizuar në CD, duhet të dorëzohen deri të Qyteti i Shkupit përmes postës në adresën: Bul. "Ilinden" nr. 82, 1000 Shkup, ose në arkivin e Qytetit të Shkupit, më vonë deri në ora 18:00 në ditën e fundit të përfundimit të Thirrjes publike (11.04.2018), me shenjë "Thirrje publike për financim të projekteve dhe të aktiviteteve nga fusha e kulturës, me interes për Qytetin e Shkupit, në suaza të projektit "Nga Qendra drejtë periferisë: Kultura si vegël për zhvillim social".

Vërejtje: Fletëparaqitjet me të dhëna të mangëta dhe me dokumentacione të pa kompletuara, fletëparaqitjet e plotësuar në formularë jo përkatës, si dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të dorëzohen në afatin e përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Parashtruesit e aplikimeve – pjesëmarrësit në thirrjen publike do të njoftohen për rezultatet në afatin prej 10 ditëve nga dita e miratimit të Vendimit për përcaktim të mjeteve. Rezultatet e Thirrjes publike do të shpallen në Ueb portalin zyrtarë të Qytetit të Shkupit, www.skopje.gov.mk.

Për informacione plotësuese, mund të parashtroni pyetje me shkrim ose përmes trajtës elektronike deri të Seksioni për kulturë, tel: 02/ 3297 289, adresa elektronike: kultura@skopje.gov.mk.

QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të nenit 37 të Ligjit për arsim profesional dhe trajnim (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 71/06, 117/08, 148/09, 17/11, 24/13, 137/13, 41/14, 145/15 dhe 55/16) dhe neni 18 dhe 33 nga Rregullorja mbi llojet e veprave të autorit dhe të shërbimeve tjera intelektuale dhe kriterëve, mënyrën e përzgjedhjes, niveli i kompensimit dhe numri i anëtarëve të ekipeve të ekspertëve të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim nr.01- 401/10, Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup, shpall:

KONKURS për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm për punë profesionale të Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup

1. Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup, shpall konkurs për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm, edhe atë nga një (1) mësimdhënës nga shkolla e mesme profesionale nga drejtimi përkatës dhe një (1) profesor universitar nga drejtimi përkatës për korrigjimin dhe harmonizimin e programeve mësimore për vitin I dhe II në pajtim me planet mësimore për arsim të mesëm profesional me kohëzgjatje dyvjeçare dhe trevjeçare, edhe atë:

A) Drejtimi: Makineri, profili arsimore:

- Automekanik, Përpunues i metalit, Mekanik i karrocisës, Saldator, Instalues për ngrohje dhe klimatizim, Instalues i linjave gypor, Mekanik i konstruksionit, Makinist për stabilimente energjetike, Mekanik i makinerisë.

B) Drejtimi: Ndërtimtari – Gjeodezi, profili arsimor:

- Montues për ndërtime të thata.

C) Drejtimi: Grafiki, profile arsimore:

- Shtypës dhe Përpunues i aplikacioneve vizuale.

Ç) Drejtimi: Hoteleri – Turizëm, profilet arsimore:

- Kamerier, Kuzhinier, Pastičier.

D) Drejtimi: Bujqësi – Veterinari, profilet arsimore:

- Kopshtar – Lulëtar.

Dh) Drejtimi: Pylltari – Përpunimi i drurit, profilet arsimore:

- Pylltar, Tapicier, Zdrukthëtar.

E) Drejtimi: Shërbime personale, profilet arsimore:

- Parukier, Estet për përkujdesjen e duarve dhe këmbëve.

Ë) Drejtimi: Gjeologji – Miniera, profili arsimor:

- Drejtues i makinave të minierave

F) Drejtimi: Elektroteknikë, profilet arsimore:

- Autoelektronik, Elektromekanik për teknikë kompjuterike dhe teknologji, Elektricitist, Elektromekanik, Autoelektricitist.

2. Të drejtë konkurrimi kanë:

mësimdhënës nga shkollat e mesme të cilët i plotësojnë këto kushte:

-të kenë së paku tre vjet përvojë pune në arsimin profesional nga drejtimi përkatës, dhe profesorët universitar të cilët i plotësojnë këto kushte:

-të kenë mbaruar së paku studimet për master dhe të kenë përvojë në veprimtarinë edukativo-arsimore ose shkencore për drejtimin përkatës, të kenë publikuar artikuj shkencor, respektivisht kontribute shkencore të cilat janë të rëndësishme për drejtimin përkatës dhe për përpunimin e arsimit dhe edukimit. Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në përpilimin e plan-programeve mësimore.

Me kandidatët i cili i plotëson kushtet dhe do të përzgjedhet si bashkëpunëtor i jashtëm do të nënshkruhet kontratë.

Kandidati duhet të paraqes fletëparaqitje ku qartë duhet të shkruajë pozitën për të cilën paraqitet, gjithashtu duhet të dorëzojë dokumentacionin për plotësimin e kushteve të cilat janë përmendur në këtë konkurs (vërtetim që është në marrëdhënie pune) dhe biografi të shkurtë.

Nuk do të shqyrtohen fletëparaqitjet të cilat nuk janë të kompletuara dhe nuk janë të dorëzuara me kohë.

Plan-programet mësimore mbi të cilët do të bëhet korrigjimi dhe harmonizimi i të njëjtave do të publikohen në ueb faqe e Qendrës: www.csoo.edu.mk

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e shpalljes.

Fletëparaqitjet me dokumentacionin e duhur dorëzohen në arkivin e Qendrës për Arsim Profesional dhe Trajnim, ose nëpërmjet postës në adresën Bul. Goce Dellçev nr:18 – Shkup, p. fax 290.

Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim – Shkup

Në bazë të nenit 20 g paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005.....27/2016), nenit 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/82013.....21/18), Lajmërimin nga Ministria e financave për mjetet e siguruar financiare numër 18-2384/2 të datës 22.02.2018 dhe Vendimit për punësim numër 04-39/1 të datës 12.03.2018, u. d Drejtori i IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 1/2018

Për punësim të dy realizuesve për kohë të pacaktuar të punës në Institucionin publik komunal për fëmijë – Çerdha për fëmijë "Gonça Tufa" – Krushevë

1. Emri i vendit të punës: Rregullues të kotlave të ngrohjes – (1) realizues

-Numri rendor i vendit të punës në aktin për sistematizim të vendeve të punës: 2
-Shifra e vendit të punës: DE3 04 01 A01 003

1.1. Kushtet e përgjithshme:

-Dëshmi për shtetësi (jo më të vjetër se 6 muaj);

-Vërtetim mjekësor se personi është i shëndoshë psiko-fizikisht;

-Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;

-Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj)

-Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese (jo më të vjetër se 6 muaj);

1.2. Kushtet e posaçme:

-Lloji i arsimit: Arsim të mesëm – menaxhues me kotle për ngrohje ose arsim profesional – menaxhues me kotle për ngrohje pas përfundimit të arsimit fillor;

-Përvoja e punës: pa përvojë pune

1.3 Orari i punës

-Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënës deri ditën e premte);

-Orari ditor i punës: 8 orë, prej ora 8.30 deri në ora 16.30;

1.4 Neto pagesa fillestare: 12.646,00 denarë

Vërejtje: Në pajtim me planin vjetor për punësim të IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë për vitin 2018, për këtë vend pune është paraparë punësim për (1) person nga përfaqësuesi i bashkësisë etnike shqiptare.

2. Emri i vendit të punës: Mirëmbajtës të higjienës (1) realizues

- Numri rendor i vendit të punës në aktin për sistematizim të vendeve të punës: 3

- Shifra e vendit të punës: DE3 04 01 A01 004

2.1. Kushtet e përgjithshme:

-Dëshmi për shtetësi (jo më të vjetër se 6 muaj);

-Vërtetim mjekësor se personi është i shëndoshë psiko-fizikisht;

-Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;

-Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj)

-Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese (jo më të vjetër se 6 muaj);

2.2. Kushtet e përgjithshme:

-Lloji i arsimit: Arsim fillor;

-Përvoja e punës: pa përvojë pune

1.3 Orari i punës

-Orari javor i punës: 40 orë (prej ditës së hënës deri ditën e premte);

-Orari ditor i punës: 8 orë, prej ora 4.30 deri në ora 12.30;

2.4 Neto pagesa fillestare: 12.013,00 denarë

Vërejtje: Në pajtim me planin vjetor për punësim të IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë për vitin 2018, për këtë vend pune është paraparë punësim për (1) person nga përfaqësuesi i bashkësisë etnike maqedonase.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme për përmbushje të kushteve të kërkuara në original ose kopje të vërtetuara në noter, të parashtrohen përmes postës ose personalisht në arkivin e IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë në rrugën "8 Shtetmври" pn – Krushevë. Telefoni për kontakt: 048/477-805.

Procedura për përzgjedhje të kandidatëve do të realizohet nga ana e komisionit tre anëtarësh për përzgjedhje në dy faza edhe atë:

-faza e parë: kontrollim të fletëparaqitjeve dhe dëshmi;

-faza e dytë: intervistë.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve: 5 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor;

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes;

IPKÇF "Gonça Tufa" – Krushevë

KATËR SULMUES "BIG" NË AGJENDËN E PEREZIT



Të gjithë mendojnë se Karim Benzema po luan sezonin e tij të fundit me Realin e Madridit. Presidenti Florentina Perez, pas konsultës me Zinedin Zidane (i ka dalë gjithmonë në mbrojtje sulmuesit francez) ka vendosur ta shesë gjatë merkatos së verës, për të siguruar paratë që do të afronin në "Santiago Bernabeu" emër të ri, "vrasës" para portës. Sigurisht kjo lëvizje kushtëzohet edhe nga ecuria e Realit në Çampions

apo një shpërthim i mundshëm i 29-vjeçarit. Katër janë sulmuesit, për të cilët kupola drejtuese e Realit beson se do ta zëvendësonin në mënyrën me të mirë të mundshme Benzemanë.

1. Harry Kin

I pari, për të cilin po diskutohet në vazhdimësi nga mediat, është Harry Kin, edhe pse sulmuesi anglez, sipas "The Sun" ka vendosur të qëndrojë të paktën edhe për një sezon te Tottenhami. Presidenti i klubit londinez, Daniel Levy, e ka përsëritur në disa raste që nuk ka ndërmend të shesë "yjet" e skuadrës së tij. Realit i ka të qartë se çmimi i Kane është 200 milionë sterlina ose 224,5 milionë euro.

I pari, për të cilin po diskutohet në vazhdimësi nga mediat, është Harry Kin, edhe pse sulmuesi anglez, sipas "The Sun" ka vendosur të qëndrojë të paktën edhe për një sezon te Tottenhami

2. Mauro Icardi

Emri i dytë në listën e Perez është Mauro Icardi. Argjentinasi i Interit ishte objektiv i "Los Blancos" edhe në merkaton e janarit, por operacioni nuk u konkretizua. Në fund të sezonin klubi "merengues" mund të hidhet sëri në sulm për Mauriton, sigurisht nëse Tottenhami refuzon të hyjë në bisedime për Kin.

3. Mohamed Salah

I treti është Mohamed Salah. 25-vjeçari egjiptian ka shpërthyer në këtë sezon dhe pëlqehet shumë nga Zidane. Pak ditë më parë, presidenti Federatës Egjiptiane të Futbollit, Hany Abo Rida, deklaroi se Florentino Perez ka programuar blerjen e sulmuesit në verë.

4. Robert Lewandovski

I fundit, por jo për nga rëndësia, është Robert Lewandovski. Polaku gjithmonë e ka lënë të hapur mundësinë e transferimit në Madrid dhe tani që marrëdhëniet e tij me drejtuesit e kampionëve të Bundesligës nuk janë më të mirat, në verë mund ta bëjë realitet ëndrrën për të veshur fanellën e bardhë të Realit.

De Gea në PSZH?

De Gea është objektiv kryesor i Paris Sen Zhermenit për merkaton e verës. Klubi francez nuk i beson Areolas dhe mendon se me spanjollin në portë dhe disa përf forcime tjera, mund të luftojnë për Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm, që është dëshira e zjarrtë e Nasser Al-Khelaifit. Klubi nga Ligue 1 ka vendosur ta shesë për ta larguar nga porta numrin një aktualisht, Alfons Areola dhe gjatë verës do të tentojë ta rrëmbejë De Gean. Portieri i Çellsit, Thibaut Courtois dhe i riu i Milanit, Gjanluigi Donnarumma – janë gjithashtu opsione nëse PSZH-ja humb betejën me Real Madridin për spanjollin. Kujtojmë, PSZH u eliminua këtë edicion nga Real Madridi nga Liga e Kampionëve dhe kjo e ka shtyrë Nasser Al-Khelaifi që të bëjë revolucion ku përveç portës, ndryshime pritet të ketë edhe në mbrojtje, mesfushë dhe sulm – Neymari mund të largohet, ndërsa Paulo Paulo Dybala i Juventusit është një tjetër objektiv që mund të zbarkojë në "Parc des Princes".



Publicitet

Komisioni për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve për nxënës nga SHMK Gjinnazi "Dragi Daskalov" Kavadar në vijim publikon

FTESË

Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve për nxënësit e SHMK Gjinnazi "Dragi Daskalov" Kavadar

1. Organizim të ekskursionit dyditor Kavadar-Strugë-Ohër-Manastir-Kavadar
2. Organizim të ekskursionit përfundimtar Kavadar-Budapest-Pragë-Karlovi Vari-Vjenë-Kavadar me kohëzgjatje prej 6 ditë me 4 bujtje edhe atë: 1 në Budapest, 2 në Pragë dhe 1 në Vjenë. Periudha e realizimit gjysma e parë e muajit maj të vitit 2018.

Në pajtim me programin e shkollës për realizim të ekskursioneve për vitin 2017/18

(www.dobri daskalov.edu.mk/nastava/dokument)

3. Oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta për

- akomodim në hotele me 3*/3*+(dëshmi: pararezervim të hoteleve ose turoperator) transport (autobusë të klazit të lartë turistik), ushqimi (gjysmëpansion mëngjes dhe darkë) për pikat 1 dhe 2, sigurim rrugor dhe shëndetësor të nxënësve pa franshizë, shoqëruar i licencuar turistik për secilin autobus, guid lokal sipas programit (dëshmi kopje nga licenca dhe legjitimacioni për minimum 4 guidë ose rezervim për turoperatorë), kushtet për akomodim, mënyra e pagesës, dëshmia konkrete për angazhim të mjekut (marrëveshje, diplomë dhe licencë)

4. Kriteret për paraqitje në kërkesën për parashtrimin e ofertave

-Ofertuesit të jenë të regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R. Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë turistike: Dëshmi – licenca A për kryerje të veprimtarisë turistike, gjendja aktuale (jo më të vjetër se 6 muaj)

-së paku 3 rekomandime për realizim të suksesshëm të ekskursioneve në shkolla të mesme të RM në 3 vitet e fundit dëshmi – vërtetime të dhëna nga shkollat me marrëveshje të parashtruara;

-të përbushin kushtet për transport të grupeve të fëmijëve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknik për makinat që bëjnë transportin e grupeve të fëmijëve: dëshmi – Deklaratë dhe marrëveshje për ekskursionin konkret me transportues të bashkëngjitur certifikatat nga licencat për transport të lirë të udhëtarëve në komunikacionin rrugor ndërkombëtar për minimum 4 autobusë;

-të përbushen të gjitha kushtet në pajtim me rregulloren e MASH për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënësit e shkollave të mesme.

Oferta është e ndashme, ndërsa ofertuesit mund të parashtrorin ofertë për të gjitha relacionet e ofruara për pjesën e saj.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Ofertat me të gjitha dokumentet e nevojshme të parashtrorin deri te Komisioni për grumbullim të ofertave në arkivin e shkollës ose përmes postës në adresën SHMK Gjinnazi "Dragi Daskalov" Kavadar rr. "Mito Haxhivasilev" nr. 68, 1430 Kavadar, R. Maqedonisë, me shenjë për Komisionin për grumbullim të ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënës.

Ofertat e pakompletuara, jo të plota, të pakrahueshme dhe të vonuara nuk do të merren aspak parasysh.

Komisioni për grumbullimin e ofertave

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gaz. zyrtare e R.M. nr. 167/2015), Shkolla fillore „Vrapçishti“, f. Vrapçisht, e shpall këtë:

Shpallje publike

Për krijimin e një marrëdhënie pune

Për punësim të një mirëmbajtësi pastërtie me orar të plotë pune, në kohë të pacaktuar.

Përveç kushteve të përgjithshme të caktuara me Ligj, kandidati duhet të ketë të kryer

Kandidati duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

- Kërkesë, dëftesa e arsimit fillor të kryer,
- Vërtetim nga Gjykata, se ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë penale,
- Certifikatë të nënshtetësisë,
- Certifikatë të lindjes,
- Karton personal,
- Kopje të letërnjoftimit,
- Certifikatë mjekësore, pas pranimit të kandidatit.

Shpallja publike është e hapur 5 ditë nga dita e shpalljes.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në sh.f., Vrapçishti, në f. Vrapçishti.

Nr. 0401-38/1

13.03.2018

Vrapçishti

Sh.f., Vrapçishti, f. Vrapçishti

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 62/05) dhe me datë 05.01.2017, bazuar në pëlqimin e MASH me datë 02.03.2018 me nr 12-12099/3 Sh.F.K. "Ibe Palikuqa" f. Bojanë - Shkup, solli vendim për publikim të:

SHPALLJES

Për plotësimin e vendit të punës në vijim për kohë të caktuar pune për vitin shkollor 2017/2018 me mësim në gjuhën shqipe deri 31.08.2018

1. Një arsimtar për matematikë me fond të plotë (21 orë, troga 20.620)

Mësimi zhvillohet në një ndërrim. Koha e punës prej 07³⁰ deri më 13³⁰,

Vendi i lirë i punës është në kohë të caktuar, deri më 31.08.2018

Me kërkesën, kandidati duhet të dorëzojë edhe dokumentet në vijim:

- certifikatë për arsim të kryer përkatës
- certifikatë të shtetësisë
- certifikatë nga libri amzë i të lindurve dhe
- certifikatë mjekësore

Fletëparaqitjet me të dhënat për plotësimin e kushteve sipas shpalljes, duhet të dorëzohen në afat prej 5 ditësh pune nga dita e publikimit deri te: ShFK. "Ibe Palikuqa" f. Bojanë

13.03.2018, Shkup

ShFK. "Ibe Palikuqa" f. Bojanë

Publicitet

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08.....127/16); nenit 46 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe të punës së Fakultetit Pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 287/2014), dhe nenit 34 paragrafi 1 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare 274/2013), dekani i Fakultetit pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, më datë 12.03.2018 ka sjell Vendim për publikimin e:

K O N K U R S

Për zgjedhje të një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor:

- Të bëhet zgjedhje e një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sfera Informatika, për lëndët:
 - Teknologjitë informatike dhe të informacionit në mësim (lëndë obligative për grupin studimor Mësim klasor për mësimin në gjuhën maqedonase);
 - Teknologjia informatike dhe e informacionit në punën edukativo-arsimor (lëndë obligative për grupin studimor Edukimi parashkollor për mësimin në gjuhën maqedonase);
 - Softueri edukativo-arsimor (lëndë zgjedhore për grupet studimore Edukimi parashkollor dhe Mësimi klasor për mësimin në gjuhën maqedonase);
 - Edukimi informatikë (lëndë obligative për grupin studimor Bibliotekari) dhe
 - Kërkim në të dhënat (lëndë zgjedhore për grupin studimor Bibliotekari).

Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim sipëror, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të parashtrorin:


- fletëparaqitje;
- biografi të shkurtë;
- diplomë për arritje të shkallës shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet;
- formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues, që mund të merren në arkivin e Fakultetit
- Deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe
- certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve parashtrorin përmes postës në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune për kohën që do të zgjidhet.

Dekan

Prof. d-r Emil Sulejmani



Urdhër arresti për presidentin e PAOK-ut

Skenat e turpshme të ndeshjes PAOK-AEK luajtur dje në Selanik kanë bërë xhiron e botës. Vetëm pak javë pas ndërprerjes së sfidës mes PAOK-ut dhe Olimpiakos. Coli i PAOK-ut, shënuar në minutën e fundit, anuluar më vonë dhe që nuk dihet si do konsiderohet, bëri që në fushë të kishte kaos dhe ndeshja të ndërpritej. Arbitri i ndeshjes Komninis u largua për në dhomat e zhvishjes, pasi presidenti i PAOK-ut Ivan Savidis u fut në fushë, e kërcënoi hapur me fjalët "Ke marrë fund" dhe ndërkohë kamerat e fokusuan duke mbajtur një armë në brez. Diçka e tillë ndalohej rreptësisht në ambiente ku zhvillohen evenimente sportive, ndaj i plotfuqishmi greko-rus rrezikon shumë, duke qenë se policia greke ka nxjerrë urdhër arresti për të.

"Fitorja ndaj Liverpoolit ishte e rëndësishme, por kjo me Seviljën është edhe më shumë. Kjo është një ndeshje jetë a vdekje", u shpreh portugezi

Hoze Murinjo fokusohet tërësisht te ndeshja e së martës, kundër Seviljës, në kuadrin e 1/8 finale të Ligës së Kampionëve. Të tijtë do të luajnë në "Old Trafford", me synimin për të superuar barazimin pa gola në "Nervion" dhe kualifikuar në çerekfinale. Portugezi flet qartë se çfarë do të thotë ky ballafaqim. "Fitorja ndaj Liverpoolit ishte e rëndësishme, por kjo me Seviljën është edhe më shumë. Kjo është një ndeshje jetë a vdekje", u shpreh portugezi. Murinjo synon të përdorë një modul 4-3-3, me Rashford, autor i dopietës ndaj "reds", në njërin nga krahët dhe Lukakun në majë të ofensivës. Pol Pogba, me probleme fizike, është dyshimi i madh i trajnerit portugez në vrojtimin e kësaj ndeshjeje të Ligës së Kampionëve, e cila vlen kalimin në mes të të mirëve në Evropë. Andaj, opsionet e rikthimit të tij janë në dispozicion të Junajtedit. Gjithashtu Fellaini, i cili luajti ndaj Liverpoolit mund të jetë titullar ndaj Seviljës në "Old Trafford", derisa Herrera, Markus Roho dhe Fil Xhons mbeten jashtë përkrah suedzit Zllatan Ibrahimoviç dhe Dalej Blind. Cekim, në përballjen e parë, tek Junajted shkëlqeu portieri David De Gea, i cili të paktën kishte tre pritje vendimtare. Në prag të kësaj përballje ka folur edhe serbi në radhët e Junajted Nemanja Matić. "Ne duhet të shohim se çfarë kemi bërë mirë të vazhduar kështu, duhet të dimë se ku kemi bërë gabime për ti përmirësuar ato. Ndeshja me Seviljën është shumë e rëndësishme për ne, ndo-

LIGA E KAMPIONËVE, 1/8 E FINALES NDESHJET KTHYESE PËR JUNAJTEDIN KTHIMI ME SEVILJËN ËSHTË NDESHJE PËR JETË A VDEKJE



DYSHET:
MANÇESTER J. - SEVILJA
ROMA - SHAKTAR D.

shta ndeshja më e rëndësishme e sezonit. Ne duhet ti mposhtim ata për të kaluar tutje, kështu që të gjithë duhet të japim më të mirën", deklaroi Matić.

Në përballjen tjetër, Roma do të pret Shaktarin, ku do të kërkojë të përmbys negativin nga ndeshja e parë kur skuadra ukrainase triumfoi me rezultatin 2-1. Pra sonetë në "Olimpico" gjithçka do të jetë e hapur, por verdhekuqtë njëherë duhet të përmbysin negativin prej 2-1 dhe më pas të kërkojë golin e

radhës për tu plasuar në çerekfinale. Nëse e arrijnë këtë, skuadra italiane do të plasohet në çerekfinale pas një dekade. Për ekipin italian do të mungojë Rik Karsdrop, i cili prej më herët po vuan lëndimin e gjurit, francezi Defrel është duke u rikuperuar nga lëndimi, por mund të ndodh të humb ndeshjen e tretë të njëpasnjëshme, derisa Daniele De Rosi po vuan gjithashtu nga një lëndim i kyçit të këmbës dhe mund jetë gjithashtu jashtë kombinimit për përballjen e sotme. Sa i përket

skuadrës ukrainase, ata kanë një seri prej gjashtë fitoreve me radhë në kampionatin ukrainas, që dëshmon formën e mirë që po e gëzojnë para përballjes me Romën dhe ku do të duhet të dëshmojnë se janë një forcë për tu llogaritur në Evropë. Ndërkaq, me dy humbje nga tre ndeshjet e fundit të Ligës së Kampionëve, Shaktar do të duhet të jetë në mënyrën më të mirë absolute për të ndalur Romën dhe për të mos lejuar që ata të kalojnë në garë.

TRI TË DHËNA, 101 GOLA DHE 3 OBJEKTIVA

Paulo Dybala është i frikshëm

Tri të dhëna përbëjnë një provë në librat dhe filmat policesk. Rregulli i pashkruar dhe që mund të transferohet me lehtësi në universin e futbollit, veçanërisht nëse ia përshtat Paulo Dybalas. Tri të dhënat janë Lacio, Tottenham dhe Udinese. Tri ndeshje që kanë treguar akoma më shumë se "Joya" është njeriu kyç i kësaj faze finale të sezonit për Juventusin. Në futboll, gjithmonë, ndeshja e parë pas një mungese të gjatë është shumë e mirë, madje, në disa raste, e shkëlqyer. Por ndiqet nga një rënie të formës. Ndoshta për ata normalët është kështu, por nëse quhesh Paulo Dybala gjërat shkojnë pak ndryshe. "Joya" është kthyer në

fushë në ndeshjen e "Olimpico"-s kundër Lacio-s dhe pas 92 minutash e gjysmë jo shumë të mirë ka shpikur atë që mund të jetë goli i titullit. Dhe e ka bërë këtë nga asgjëja Rezultati: dy pikë më shumë për Juventusin dhe një goditje për Napolin, që është mundur 4-2 në shtëpi kundër Romas. Më pas bardhezinjtë janë transferuar në "Wembley" dhe Dybala ka ndëshkuar Hugo Lloris dhe ka shënuar golin që i ka dhuruar kualifikimin në çerekfinale ekipit të tij. E fundit në radhë ka qenë Udinese, kundërshtari më i lehtë në letër. Dhe në këtë sfidë kemi parë një Dybala spektakolar. Prekje magjike, vertikalizime dhe një formë fizike e përmirësuar deri në atë sa e ka lejuar të rikuperojë me kokë një top në mbrojtje. Përveç kësaj, nuk mund të mos përmendet edhe dygolëshi që gjunjëzoi Udinesen, me një magji nga goditja e dënimit dhe një gol të realizuar me të djathtën falë "dhu-

ratës" së Higuain. Pikërisht, Higuain. Njeriu të cilit Paulo i besoi penalltinë kur ndeshja ishte 1-0 duke shkaktuar zemërimin e Alegrit që kishte zgjedhur "Joya"-n. "Kështu bëjmë me Higuain, kur shënon njëri, godet tjetri dhe në të kundërt. Por një penallti e humbur nuk ndryshon asgjë". Ajo që ka ndryshuar janë golat e realizuar nga argjentinasit: dygolëshi, i pari për 2018-ën, ka çuar në 101 totalin e golave të tij në karrierë (17 me Instituto de Cordoba, 21 me Palermo dhe 62 me Juve) në 260 ndeshje. Në këtë sezon janë 21, 17 prej të cilave kanë ardhur në Serie A, 2 në Superkupën e Italisë, 1 në Çampionin dhe Kupën e Italisë. "Jam i kënaqur se kam ndihmuar skuadrën. Pavarësisht 180 minutave në pak ditë i kam thënë Alegrit se isha mirë. Të tre objektivat e sezoni varen nga ne", deklaroi Dybala. Nëse ky është Dybala i vërtetë, Juventus mund të shkojë në çdo fushë dhe të mposhtë këdo.



"Jam i kënaqur se kam ndihmuar skuadrën. Pavarësisht 180 minutave në pak ditë i kam thënë Alegrit se isha mirë. Të tre objektivat e sezoni varen nga ne"





DASHI 21. mars - 20. prill

Pavarësisht se kjo fillim jave nuk do të jetë fushë me lule, yjet do të jenë në favorin tuaj duke ju lejuar që të shijoni çdo moment në sektorin e dashurisë. Ata që janë vetëm, do të bëjnë mirë të reflektojnë për emocionet e tyre. Në sferën profesionale, ju presin të reja të rëndësishme, por para se të pranoni, analizoni çdo detaj.



DEMI 21. prill - 21. maj

Gjatë kësaj dite, disa nga të lindurit e kësaj shenje do të jetojnë pasione të veçanta dhe energji unike, në gjendje që ta bëjnë këtë të hënë vërtetë të shkëlqyer. Mbajini hapur dyert e zemrës, nëse jeni në çift. Ata që janë vetëm, duhet të mundohen që të rimarrin kontrollin e jetës së tyre. Sa i takon punës, do të vini nën kontroll një situatë që po ju rreshqet nga duart. Duhet të jeni më se të aftë për të drejtuar.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Në sajë të ndikimit të Hënës, raporti juaj në çift do të jetë i shkëlqyer. Mundohuni që të dialogoni, për të forcuar më shumë raportin tuaj. Ky është moment shumë i mirë për ata që janë vetëm, ku parashikohen takime mbresëlënëse. Pikëpamjet tuaja, nuk do jenë gjithmonë të njëjtat me ato të personave me të cilët bashkëpunoni. Bëni durim!



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Hëna e pranishme në shenjën tuaj, do të turbullojë ëndrrat, shpresat dhe pasionin. Gjatë kësaj dite sfera e dashurisë do të jetë shumë e mirë. Edhe për ata që janë vetëm, kjo e hënë do të jetë e shkëlqyer, ku nuk përjashtohet mundësia që të gjeni shpirtin tuaj binjak. Nëse në punë jeni në një fazë të komplikuar ndryshimi, roli që do të merrni do ju mbushë me kënaqësi.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Mos u tensiononi përballë situatave që nuk janë ideale. Në dashuri duhet të ruani gjithmonë ekuilibrin. Ata që janë vetëm, mund të përjetojnë momente të çuditshme pasioni. Kujdes të mos e ekzagjeroni. Në sferën profesionale, durimi do të jetë pika juaj e fortë.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Dëshira për të arritur një intensitet perfekt me personin që dashuron, rrezikon që t'iu çojë drejt hapave të gabuar. Veproni me maturi, në mënyrë që të mos dëmtoheni. Ata që janë vetëm do të kenë një dëshirë të shfrenuar për të flirtuar me një person që sapo e kanë njohur. Ndërsa në punë, mos u mbingarkoni me përgjegjësi, pasi nuk do mund të arrini të çoni asgjë deri në fund. Kërkoni ndihmë nga të tjerët.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Duhet ti kushtoni më shumë kohë personit që doni, pasi angazhimet e kohëve të fundit nuk iu kanë lejuar. Herë pas here, keni nevojë për një pushim. Ata që janë vetëm, do të bëjnë miqësi të reja. Mund të jetë një e hënë shumë impenjative, ku do të testohen aftësitë tuaja dhe mënyra se si do të përballoi disa situata.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Gjatë kësaj dite do të keni pasiguri lidhur me një lidhje dashurie të cilën vijoni ta zvarrisni. Reflektoni lidhur me situatën tuaj dhe merrni vendimet e duhura. Ata që janë vetëm, duhet të kontrollojnë xhelozinë e tyre. Në punë, lini mënjanë ambiciet dhe nxitimin, duke u përballur realisht me këtë moment të vështirë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Yjet ju këshillojnë që ta nisni javën, pa u përfshirë nga ankthi lidhur me çështjet e dashurisë. Përqendrohuni vetëm tek gjërat praktike. Ata që janë vetëm, duhet të mundohen të menaxhojnë një njohje të re me sens të mirë humorit dhe me masë. Sa i takon punës do të jetë një ditë pozitive dhe nëse jeni të përfshirë në fushën e biznesit, do të mbyllni çështje të rëndësishme.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Keni nevojë për të besuar në diçka të re, për të mposhtur pasiguritë dhe frikën që ju ka pushtuar. Fatmirësisht, momentalisht fusha e ndjenjave ju buzëqesh. Ata që janë vetëm duhet ti hedhin hapat me radhë, duke lënë mënjanë dhimbjen e një dashurie të përfunduar. Një person do të mbështesë nismat tuaja në punë dhe më në fund do të keni hapësirën aq shumë të kërkuar.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Diçka ju pengon të veproni me spontanitet. Lërnini thashethemet e njerëzve ziliqarë dhe shijojeni maksimalisht jetën tuaj private. Do të jetë një e hënë shumë e qetë për ata që janë vetëm, ku dikush do të ketë dëshirë të zbulojë gjëra të reja. Në punë, dita do të nisë me këmbë të mbarë. Tregohuni të durueshëm, dhe do ia dilni më së miri.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mos u nxitoni në marrjen e vendimeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me dashurinë. Reflektoni lidhur me gabimet tuaja dhe mos ua hidhni fajin të tjerëve, nëse gjërat në jetën tuaj private nuk shkojnë mirë. Ata që janë vetëm do të ndiejnë një dëshirë të fortë, për të jetuar situata të pazakonta. Sa i takon sferës profesionale lidhur me të ardhmen tuaj, do të shfaqen shumë mundësi para jush.



NE KETE DATE

KOHA	INSTITUCIONET SHENDETESORE	SËPATË E VOGËL, ÇAKORRË, SAKICE	GABIM (LAT)	PËREMËR VETOR	RELIGJION KËNGË E KËNGËTARIT NË FOTO	SELENI SHKRONJA E 33-TE		
EMRI SKENIK I KËNGËTARIT NË FOTO								
PERIUDHAT						HEKURI		
POET KINEZ (EMRI DHE MBIEMRI)						SQUFURI		
L				GJINIA TETOVA				VEPRIMTARI I LEVIZJES KOMBËTARE, KOLEA
DHUNA E RENDE, MUNDIMI						KAMPION		
						TITULL KISHTAR		
FLORI			KËNGËTARJA JONË, TARIFA					OZONI
			SHKËMB I MADH					SHKOI
MONEDHA SHQIPTARE				VJEDH				
				MELIHATE AJETI				
ENERGJIA		STRUC AUSTRALIAN				PJUE ALKOOIKE		
		ZANORJA E TRETË				RUMANIA		
QË NUK JANË TRETUR, TË PASHKRIRË								

ZGJIDHJET: VELA, ILAR, EMRI, TOKA, NIN, ETNA, LE, R, FE, SE, SKETMEN XHON, PERIODA, FE, LIPO, SEKSI, TORTURA, AS, AR, ENEDA, O, LEK, GRABIT, E, EMU, RAKI, TË PATRETUR.

Sudoku

shumë i lehtë mesatar

9			1					7	9			9	5	3		
		6			7	1						8	7	4		1
7				2	5			4	9				3			
		7		5		6			5	2		4			7	9
			8		4					9	6	7		3	8	1
	1			6			4		1	7			9			5
4			5	7				3					2			4
		8	2			5			3			4	1	6		
2					3			8			4	5		9		

Shumë i lehtë: 954186327, 326497185, 781325964, 847951632, 692834751, 513762849, 469578213, 138249576, 275613498. Mesatar: 841965327, 235874961, 967231548, 523148679, 496753812, 178692453, 659327184, 382416795, 714589236.

NJËRI I BARDHË, TJETRI ME NGJYRË, JA BINJAKËT LUCAS E LEVI

"Nuk është e këndshme t'i kërkohej një nënë: a je e sigurt që janë binjakë?", tregon 30-vjeçarja Teegan Wardill nga Townsville, në Australi. Ajo që ka shkaktuar dyshimin tek njerëzit e zakonshëm, është ngjyra e lëkurës së djemve të saj: Lucas, me sy të kaltër dhe lëkurë të çelur dhe Levi, sy dhe flokë ngjyrë gështenj në të errët. "Unë dhe Justin, bashkëshorti im, vazhdon ajo, e kemi



zbuluar ndryshimin e tij në gjatë ekografisë 3D". Pas javën 1 9-të të shtatzënisë, lindjes dhe pastaj rritjes, kanë



nisur të shfaqen ndryshimet gjenetike tek dy vëllezërit: Lucas ka marrë gjithçka nga nëna, ndërsa Levi ka trashëguar gjenet e të atit, i cili ka origjinë indiane. "Por janë të veçantë, nuk janë të ndryshëm", saktëson nëna e binjakëve.



Të mirat e një filxhan çaji në ditë

Kjo ndoshta do të thotë që britanikët janë njerëzit më krijues në botë. Po, një studim ka zbuluar se konsumimi i çajit e bën trurin më krijues, si dhe ndihmon gjendjen emocionale të njerëzve. Studiuesit në Universitetin e Pekinit ndanë një grup prej 50 nxënësish në gjysmë, duke iu dhënë 25 prej tyre të pinin çaj dhe pjesa tjetër një gotë ujë para se të hynin në një testim. Në testimin e parë atyre iu kërkuar të përgatisnin diçka krijuese dhe tërheqëse, duke përdorur blloqe ndërtimi. Ndërsa në të dytin të gjenin një emër interesant për një restorant. Nga testimi i parë, ata të cilët kishin konsumuar çaj morën 6.54 pikë në krahasim me 6.03 pikë që morën nxënësit që kishin pirë ujë. Ndërsa në testimin për emrin e restorantit, konsumuesit e çajit morën 4.11 kundrejt 3.78 të pjesës tjetër. Në revistën Food Quality and Preference, studiuesit e konsideruan këtë zbulim si një mënyrë e re për të kuptuar raportin mes konsumimit të pijeve dhe përmirësimit të kreativitetit të njerëzve.

Tokio, vitin e kaluar në rrugë janë gjetur mbi 35 milionë dollarë

Shuma e parave të gjetura në rrugët e Tokios në Japoni dhe të dorëzuara në polici ka kaluar shifrën prej 35 milionë dollarësh. Sipas lajmit të publikuar nga Kyodo, policia e Tokios ka njoftuar se në vitin e kaluar, banorët e qytetit kanë gjetur afro 3.75 miliardë jenë (35.3 milionë dollarë) të cilat i kanë dorëzuar në polici. Sipas njoftimit të policisë, 25 milionë dollarë nga kjo shumë iu është rikthyer pronarëve, ndërkohë që 4.77 milionë dollarë iu janë dhënë atyre që i kanë sjellë paratë. Nga ana tjetër, afro

4.5 milionë dollarë kanë hyrë në kassafortën e Menaxhmentit të Qytetit të Tokios. Atyre të cilët rrugëve të Tokios kanë gjetur para dhe i kanë dorëzuar në polici u takon 20 për qind e shumës si shpërblim nga pronari. Nëse brenda 3 muajve nga dorëzimi i parave, nuk paraqitet pronari, atëherë paratë i takojnë personit që i ka gjetur ato. Nëse nuk paraqitet as pronari e as personi që ka gjetur nuk dëshiron t'i marrë paratë e gjetura, atëherë këto para përfshihen në të ardhurat publike lokale.



Gjashtë vjeçari i lindur pa sy



Një djalë gjashtë vjeçar i lindur pa sy, është vetëm një nga 60 raste në botë që janë të prekura nga kjo gjendje e rrallë. Sipas Daily Mail, Christian Buchanan nga Tennes-



see, SHBA, vuan nga një plasaritje e fytyrës, e cila ka

vetëm 60 raste të njohura në historinë mjekësore. Që kur

u lind me plasaritje të mëdha në fytyrë, Christianit i është dashur të ushqehet me një tub duke qenë se ka kaluar shtatë operacione për rikonstruktimin e fytyrës. Pavarësisht nga kjo gjendje, e cila e ka lënë 6 vjeçarin të paafte për të parë, nëna e tij Lacey është kujdesur që ky çrregullim të mos e pengojë të miturin për të jetuar jetën. Ajo është angazhuar për të rritur ndërgjegjësimin mbi aftësitë e kufizuara me shpresën për t'i bërë njerëzit të pranojnë ata që janë ndryshe.

KALENDARI HISTORIK 13 MARS

1519 - Kortezi ka zbarkuar në Meksikë.

1634 - Hapet Akademia Franceze.

1656 - Hebrenjve ju mohohet e drejta për të ndërtuar një Sinagogë në Nju Amsterdam. 1897 - Themelohet Universiteti shtetëror i San Diegos

1921 - Mongolia shpall pavarësinë nga Kina.

1957 - Beteja të përgjakshme pas demonstratave kundër Batistës në Havana të Kubës.

1961 - Pablo Picasso (79) martohet me modelen e tij Jacqueline Rocque (37)

1962 - Jugosllavia amnistion 1,000 të burgosur.

1964 - Turqia kërcënon Qipron me sulm të armatosur.

1981 - Tentimi për vrasje ndaj Papa Xhon Palit të II nga ana e Mehmet Ali Agxha.

Një vezë ka vetëm 70 kalori dhe plot 14 ushqyes esenciale dhe përveç kësaj, konsumi i vezës është si të merrni një tabletë multivitamine natyrale!



Toka pa lumenj, Tingëllon pak e çuditshme apo jo? Për një vend aq të madh sa Arabia Saudite duhet të ketë të paktën një lloj uji që rrjedh. Por në fakt nuk ka, shumica e ujit të tyre vjen nga shkripëzimi ose rezervuarët nëntokësorë.



Macet mesatarisht jetojnë nga 12 deri 15 vjet. Ekzistojnë më shumë se 500 milionë mace të buta (që mbahen në shtëpi) në botë.



SYZAT E TË FEJUARËS

Pse u ndave me të fejuarën tënde? Mos të pengoi ajo se filloi të bart syze? - e pyeti shoku shokun. - Jo bre - ia kthen ky, - nuk e braktisa unë, por ajo u largua kur për herë të parë i vendosi syzet në sy!



Unë nuk kam dështuar, por thjesht i kam zbuluar 10.000 mënyra të cilat nuk funksionojnë.
(Thomas Edison)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS